

RAPORTI VJETOR

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN

E TË DHËNAVE PERSONALE



2 0 1 2



100 Vjet Pavarësi

P Ë R M B A J T J A***Fjala përshëndetëse e Komisionerit.*****KAPITULLI I****VEPRIMTARIA E KMDP GJATË VIITIT 2012.****KAPITULLI II****SENSIBILIZIMI DHE RREGJISTRIMI I KONTROLLUESVE.****II.I** Aktivitete sensibilizuese dhe seminare ndërgjegjësuere.

- ~ Aktivitete të organizuara në kuadër të javës së ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave.
- ~ Seminare me kontrollues të ndryshëm.
- ~ Me të rinjtë.
- ~ Komunikimi me Medien.
- ~ Të tjera.

II.II Zhvillimet e njoftimit të subjekteve kontrollues.**II.III** Menaxhimi i njoftimeve dhe regjistrimi i subjekteve kontrollues.**II.IV** Evidentimi dhe informimi mbi rastet që përbëjnë cënim të privatësisë dhe të dhënave personale**KAPITULLI III****ECURIA E KUADRIT LIGJOR.****III.I** Miratimi i ligjit Nr. 48/2012 gjatë vitit 2012.**III.II** Miratimi i udhëzimeve për fusha të ndryshme.

- ~ Vendime.
- ~ Udhëzime.

III.III Opinionet dhe mendimet ligjore.

- ~ Dhënie mendimi për p/aktet ligjore dhe nënligjore.
- ~ Opinione dhe mendime ligjore të ndryshme për kontrolluesit dhe subjektet.

III.IV Dhënie informacioni dhe raporte**III.V** Transferimi ndërkombëtar dhe hartimi i Manualit.**III.VI** Bashkëpunimi me kontrolluesit e Republikës së Shqipërisë dhe me Autoritete Ndërkombëtare.**III.VII** Botime.

KAPITULLI IV

HETIM-INSPEKTIMI.

IV.I Ankesat e paraqitura pranë KMDP.

- ~ Rastet Konkrete.

IV.II Kontrolli dhe Inspektimi Administrativ.

- ~ Kontrolli Kryesisht mbi bazën e Planit.
- ~ Rastet konkrete.
- ~ Inspektimi mbi zbatueshmërinë e Rekomandimeve, Urdhërave dhe Vendimeve të Komisionerit.
- ~ Rastet konkrete.
- ~ Inspektime për verifikimin e plotësimit të detyrimit për njoftim.
- ~ Rastet konkrete.

IV.III Masat Administrative. Gjobat.

- ~ Vendimi me Gjobë.
- ~ Lëshimi i Titujve Ekzekutive nga Gjykata
- ~ Konkluzione

KAPITULLI V

PROJEKTI EU IPA-2009, KONTRIBUTI GJATË VITIT 2012.

KAPITULLI VI

AKTIVITETE TË TJERA TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

VI.I Menaxhimi i burimeve njerëzore, Performanca Financiare.

VI.II Sektori i Teknologjisë së Informacionit.

VI.III Pjesëmarrja në trajnimet e ITAP.

KAPITULLI VII

PËRMBAJTJA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE SKICAVE

Fjala përshëndetëse e Komisionerit.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Viti që lamë pas përfshiu një sërë aktiviteteve dhe projekteve që institucioni ynë ndërmori në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në vendin tonë. Gjate këtij viti, mund të shprehemi se institucioni ynë ofroi një kontribut të vazhdueshëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të kuadrit rregullator të tij në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në vend.

Objekti ynë është konsolidimi i institucionit dhe praktikave me të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke u përpjekur që përmes aktiviteteve të ndryshme të ketë një ndikim të prekshëm në shoqërinë dhe institucionet e ndryshme në vend në drejtim të mbrojtjes së këtyre të dhënave.

Ndër aktivitetet kryesore të ndërmarra i është kushtuar një kujdes i veçantë ndërgjegjësimi të qytetarëve në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre mbi të dhënat personale, përcaktimit të përgjegjësi dhe detyrimeve që kanë kontrolluesit, në evidentimin e rasteve specifike si dhe trajtimin të ankesave përmes inspektimeve të vazhdueshme. Vlen të theksojmë se gjatë këtij viti janë miratuar akte të ndryshme rregullative të cilat kanë shërbyer në realizimin efektiv të detyrave institucionale si dhe qartësimin të objektivave të institucionit.

Shpeshherë, këto akte rregullative kanë qenë fryt i një bashkëpunimi të ngushtë me institucione publike, brenda e jashtë vendit, me qëllim që të arrihen standardet më të mira në këtë fushë. Gjithashtu, në aktivitetin e tij, stafi i institucionit ka treguar gjithmonë kujdes në aplikimin e parimeve, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e privatësisë për të gjithë shoqërinë dhe në përcjelljen sa më mirë në publik të rëndësisë së këtij institucioni.

Institucioni ynë gjithashtu ka synuar të nxisë bashkëpunimin, edhe me institucione homologe jashtë vendit, duke vendosur një bashkëpunim të përhershëm midis tyre, por dhe duke promovuar aktivitete e programe të rëndësishme ndërgjegjësimi në vendin tonë.

Ndër to vëmë theksin në bashkëpunimin e suksesshëm me projektin EU IPA – 2009, i cili ka asistuar përgjatë këtij viti institucionin tonë dhe ka mundësuar zhvillime të rëndësishme në kuadrin ligjor por edhe përmes trajnimeve të ndryshme për stafin si dhe përfaqësues nga sektorë të ndryshëm në vend, parë si të rëndësishëm në këndvështrimin e fushës sonë.

Veprimtaritë institucionale kanë pasur në objektiv edhe implementimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe, përmes të cilave kemi shkëmbyer eksperiencë por edhe kemi avancuar në drejtime të tjera për të arritur nivele dhe standarde Evropiane në legjislacionin përkatës si dhe në zhvillimin e ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të qytetarëve në përputhje me përpjekjet e ngjashme në vendet e BE-së.

Duke vështruar prapa në kohë mund të themi se viti i kaluar konkretizoi një sërë objektivash dhe projektesh, e kjo na bën të ndërgjegjshëm se e ardhmja do të kërkojë më shumë performancë, më shumë bashkëpunim, më shumë dëshirë dhe këmbëngulje për të mbrojtur e lartësuar një të drejtë themelore të çdo qytetari në vendin tonë, atë të privatësisë.

Ju faleminderit,

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (POGAÇE)

KAPITULLI I.

VEPRIMTARIA E KMDP GJATË VITIT 2012.

Qëllimi i mbikëqyrjes për përpunimin e të dhënave përgjatë vitit 2012, mund të themi është realizuar me sukses nga Autoriteti i Komisionerit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit. Plani për veprim i miratuar është zbatuar dhe ndjekur me synim minimizimin e shkeljeve, trajtimin e ankesave dhe sqarimin e subjekteve të të dhënave, nëpërmjet zbatimit të planit të kontrolleve të planifikuara sipas fushave, inspektimeve pa njoftim në raste të kufizuara më qëllim verifikimin, si dhe në rastet e disa ankesave dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Regjistrimit. Masat për vitin 2012 u ndërmorën duke realizuar një analizë me qëllim organizimin edhe më eficient të mbikëqyrjes.

U hartuan objektivat specifike dhe të strukturuar për çdo fushë, legjislacioni që zbatohet, numër i mirëpërcaktuar i kontrolleve dhe inspektimeve, amendimi i legjislacionit bazë dhe akteve nënligjore, bashkëpunimi më i ngushtë me strukturat e tjera të Autoritetit të Komisionerit, përfitimi maksimal i asistencës së huaj dhe eksperiencës më të mirë evropiane, etj.

Pavarësisht faktit se për vitin 2012 janë dhënë më pak gjopa se viti paraardhës, mendojmë se qëllimi i kompetencës mbikëqyrëse të Komisionerit është realizuar maksimalisht.

Kjo, së pari për shkak të numrit më të lartë të kontrolleve dhe inspektimeve administrative të ushtruara, por edhe në sajë të shtrirjes së gjerë të fushave ku operojnë kontrolluesit.

Së dyti, Komisioneri në sajë të analizave të riskut për fushën përkatëse, pas përmbylljes së procedurave të hetimit administrativ, ka unifikuar qëndrimin e tij duke dhënë rekomandime për të gjithë kontrolluesit e fushës që i përket-te kontrolluesi i hetuar. Kështu përmendim:

- ~ Universitetet,
- ~ Bashkitë,
- ~ Gjykatat,
- ~ Kontrolluesit që ndjekin procedurat e vlerësimit të konfliktit të interesit (ILDKP)

Gjithashtu, arritje tepër pozitive konsiderojmë kontrollet e ushtruara në disa kontrollues të mëdhenj shtetërorë si INSTAT, Policia e Shtetit, Bashkitë, Gjykatat. Ndihma e ekspertëve të Projektit IPA-2009 ka qenë e një niveli të lartë dhe i ka dhënë kurajë dhe profesionalizëm aktivitetit të inspektorëve.

Puna e evidentuar në këtë raport sigurisht ka mbajtur në vëmendje dhe ka synuar përmbylljen e kërkesave të pasqyruara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të datës 14 Qershor 2012, në të cilën kërkohet; Rritja e numrit të inspektimeve; monitorimi në vazhdimësi i veprimtarisë së kontrolluesve; evidentimi i rasteve që çenojnë të dhënat personale, identifikimi i plotë i subjekteve kontrolluese sa i përket regjistrimit të tyre si dhe angazhim në vazhdimësi për dhënien e opinioneve ligjore të Komisionerit në shqyrtimin e p/ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë lidhje me fushën e të dhënave personale.

KAPITULLI II.

SENSIBILIZIMI DHE REGJISTRIMI I KONTROLLUESVE.

II.I Aktivitete sensibilizuese dhe seminare ndërgjegjëse.

- **Aktivitete të organizuara në kuadër të javës së ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave .**
- ~ Në datën 25 Janar 2012, në ambientet e Universitetit Kristal në Tiranë u organizua Paneli me titull “28 Janari, Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave“. Në këtë panel, të ftuar ishin studentë të shkencave sociale si dhe pjesëtarë të stafit akademik të këtij universiteti. Gjithashtu ishte e pranishme edhe Komisionerja Flora Çabej (Pogaçe), e cila në fjalën e saj përshëndetëse theksoi rëndësinë e madhe që ka mbrojtja e të dhënave personale. Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte krijimi i një ambienti të përshtatshëm për të diskutuar mbi mbrojtjen e të dhënave personale e për pasojë influencimin në rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve të të dhënave personale. Pjesëtarë të tjerë të stafit të Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave si dhe pedagogë nga Universiteti Kristal mbajtën referimet e tyre të cilat u ndoqën me tepër interes nga të pranishmit. Në fund të këtij aktiviteti u shpërndanë dhe materiale të ndryshme sensibilizuese si fletëpalosje e broshura si dhe u mundësua plotësimi i një pyetësori nga studentët në lidhje me njohuritë që ata zotëronin mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- ~ Në kuadër të organizimit të javës së aktiviteteve me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, në datën 26 Janar 2012, me asistencën e projektit IPA 2009 "Forcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri për përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian" në ambientet e Tirana International Hotel u organizua Ëorkshopi me titull “Përpunimi i të Dhënave Personale në Sektorin Financiar”. Në këtë ëorkshop, ishin të pranishëm rreth **80 përfaqësues të sektorit financiar shqiptar**, si dhe ekspertë nga Autoriteti Spanjoll për Mbrojtjen e të Dhënave (Dr Luis De Salvador, Dr Pedro Lagunas) si dhe Dhoma Polake e Sigurimeve (Dr Stefan Szyszko), të cilët theksuan rëndësinë e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale gjatë përpunimit të informacionit vetjak në sektorin financiar. Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte krijimi i një ambienti të përshtatshëm për të diskutuar mbi mbrojtjen e të dhënave personale me përfaqësues të bankave të nivelit të dytë dhe me përfaqësues të sektorit të sigurimeve e për pasojë rritjen e ndërgjegjësimit të këtij sektori kontrolluesish të të dhënave personale. Gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë edhe materiale të ndryshme sensibilizuese të përgatitura prej Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- ~ Në vazhden e aktiviteteve të realizuara me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave, në datën 27 Janar, me asistencën e projektit IPA 2009 "Forcimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri për përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian", në

ambientet e Qendrës së Informimit të BE-së në Tiranë, u organizua një aktivitet sensibilizues me qytetarë, subjekte të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të projektit IPA, të cilët ndanë mesazhe kyçe me shtetas të ndryshëm në drejtim të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, u shpërndanë materiale sensibilizuese të cilat përmbanin mesazhe informuese. Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte krijimi i një ambienti të përshtatshëm për të mundësuar marrjen e një informacioni të detajuar mbi mbrojtjen e të dhënave personale e për pasojë të arrihej rritja e ndërgjegjësimit të shtetasve (subjekteve të të dhënave personale) mbi të drejtat që ata kanë. Aktiviteti pati një kohëzgjatje prej rreth 2 orë e gjysmë dhe numri i qytetarëve të ndërgjegjësuar ishte i konsiderueshëm. Nga ana e njërit prej përfaqësuesve të Komisionerit është dhënë një intervistë për të gjithë mediat e pranishme në këtë aktivitet ku është theksuar rëndësia që ka mbrojtja e të dhënave personale për qytetarët si dhe është pasqyruar historiku i datës së 28 Janarit.

- ~ Me qëllim pasqyrimin e aktiviteteve të zhvilluara në të gjitha shtetet anëtare në faqen zyrtare të Këshillit të Evropës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dërguar në një format të përcaktuar më parë nga Këshilli i Evropës të gjitha aktivitetet e zhvilluara prej tij me rastin e kësaj date të shënuar.

● **Seminare me kontrollues të ndryshëm.**

- ~ Organizimi i dy seminareve ndërgjegjëse dhe sensibilizuese me institucionet publike në qytetet e Vlorës dhe Fierit.

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të kontrolluesve në lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datat 27 dhe 28 Mars 2012 ka organizuar dy seminare me institucionet publike të qyteteve të Vlorës dhe të Fierit. Në këto seminare, punonjësit e Komisionerit referuan tema të ndryshme mbi njohjen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, njohjen me autoritetin mbikëqyrës të Komisionerit, detyrimin për njoftim të kontrolluesve si dhe tema mbi sigurinë e informacionit në internet. Qëllimi i organizimit të këtyre aktiviteteve është rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të kontrolluesve mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Të pranishmëve në të dy këto seminare iu shpërnda nga një set me broshura dhe fletëpalosje mbi mbrojtjen e të dhënave.

- ~ Seminar ndërgjegjëses “Përpunimi i të Dhënave Personale në Sektorin Telekomunikacioneve”.

Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Projektin “Forcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri për Harmonizimin me Standardet e Bashkimit Evropian” ka organizuar në datën 11 Prill, në Hotel Tirana International seminarin me temë: “Përpunimi i të Dhënave Personale në Sektorin e Telekomunikacioneve”. Të ftuar të merrnin pjesë në këtë seminar kanë qenë përfaqësues të AKEP, MITIK si dhe të sektorit të telekomunikacioneve, ndërsa qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit të sektorit të telekomunikacioneve në fushën e mbrojtjes

së të dhënave personale. Në kuadrin e bashkëpunimit që Komisioneri shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka me autoritetet mbikëqyrëse të rajonit, ishin të ftuar të merrnin pjesë dhe përfaqësues të institucioneve homologe të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Gjithashtu në këtë aktivitet të rëndësishëm të ftuarit u përshëndetën edhe nga Znj. Flora Çabej (Pogaçe), Komisionere për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Përfaqësuesi i AKEP-it Z. Jetmir Braha si dhe Znj. Dorota Skolimowska, Drejtuese e Ekipit të Projektit të BE-së, “Forcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri për harmonizimin me standardet e BE-së”.

Gjatë këtij seminari u referuan tema të ndryshme nga ekspertë të huaj dhe vendas siç ishin: “Kuatridhjetor i BE-së për mbrojtjen e të dhënave në sektorin e telekomunikacioneve”, referuar nga Z. Joaquín Pérez Catalán. Në këtë aktivitet u arrit gjithashtu të krijohej një ambient i hapur diskutimi mes të ftuarve dhe referuesve mbi çështje të cilat prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e telekomunikacionit. Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësve iu shpërndanë materiale të ndryshme ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese të përgatitura nga ana e projektit si dhe nga vetë Autoriteti i Komisionerit.

~ Seminar ndërgjegjësuere me përfaqësues të kontrolluesve publik dhe privat në Qytetin e Lushnjës, Krujës, dhe Peshkopisë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka organizuar gjatë vitit 2012 seminare ndërgjegjësuere në tre qytete të vendit tonë, në Lushnjë, Krujë dhe Peshkopë. Tema e këtyre seminareve ka qenë “Mbrojtja e të Dhënave Personale dhe detyrimi i kontrolluesit për të njoftuar Autoritetin e Komisionerit”. Të ftuar të merrnin pjesë në këto seminare ishin përfaqësues të institucioneve publike, atyre vendore si dhe kontrollues privat kryesisht nga sektori bankar. Gjatë këtyre aktiviteteve, përfaqësuesit e autoritetit të Komisionerit referuan tema si: Prezantimi i autoritetit mbikëqyrës të KMDP, Detyrimi ligjor i kontrolluesit për të njoftuar KMDP si dhe tema të cilat trajtojnë sigurinë e informacionit si dhe kontrollin e privatësisë gjatë lundrimit në internet. Gjatë seminareve pati edhe diskutime me të ftuarit për çështje specifike të mbrojtjes së të dhënave personale, për çështje që i përkasin më së shumti detyrimit ligjor të njoftimit për përpunimin e të dhënave personale si dhe mbi çështje të tjera të lidhura ngushtë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Po ashtu gjatë këtyre seminareve u shpërndanë edhe dosje të cilat përmbanin fletëpalosje të ndryshme të publikuara nga KMDP me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

~ Seminar mbi “Cloud Computing dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Në datën 7 Qershor 2012, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një seminar i titulluar “Fenomeni Cloud Computing dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale”. Dr. Stefan Szyszko ardhur nga Polonia si ekspert afatshkurtër në kuadër të projektit me titull “Konsolidimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri”, ishte referues në këtë seminar si një nga ekspertët e mirënjohur të fushës. Në hapjen e këtij aktiviteti mbajtën gjithashtu një fjalë përshëndetëse Drejtuesi i Ekipit të Asistencës Dorota Skolimowska, si dhe përfaqësuesi i KMDP-së. Ky seminar synonte në vetvete rritjen e ndërgjegjësimin të subjekteve dhe të përfaqësuesve të kontrolluesve mbi fenomenin Cloud Computing dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin përfaqësues nga sektori i teknologjisë së informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Vodafone, AlfaBank, BKT, ProcreditBank etj. Seminari pati një kohëzgjatje prej rreth 2

orësh dhe mes të pranishmëve pati diskutime konstruktive dhe shkëmbim idesh rreth temës në fjalë. Gjithashtu pjesëmarrësve iu shpërnda një set me materiale sensibilizuese të përgatitura nga Projekti si dhe nga KMDP.

~ Organizimi i seminarit me titull "Mbrojtja e Privatësisë dhe e drejta për akses në dokumentet zyrtare".

Në datën 21 Qershor 2012, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Projektin IPA 2009 me titull: "Konsolidimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri" u organizua seminari me titull " Mbrojtja e Privatësisë dhe e drejta për akses në dokumentet zyrtare: dy të drejta këto në konflikt me njëra tjetrën?". Referues në këtë seminar ishte eksperti i mirënjohur britanik në fushën e mbrojtjes së të dhënave Z.Graham Sutton i cili ka ndihmuar gjithashtu dhe në përgatitjen e ligjit shqiptar të mbrojtjes së të dhënave personale. Të pranishëm në këtë aktivitet të hapur për publikun ishin përfaqësues nga: Këshilli i Ministrave, Prokuroria e Përgjithshme, ILDKP, KLD, EURALIUS, Delegacioni i Bashkimit Evropian, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit etj. Gjatë këtij aktiviteti u arrit të krijohej dhe një debat mes pjesëmarrësve përsa i takon së drejtës së informimit dhe asaj të privatësisë nëpërmjet pyetjeve të ndryshme nga të pranishmit apo ndarjes së eksperiencës së hasur gjatë punës së tyre në këtë fushë. Në këtë aktivitet mbajtën gjithashtu fjalët e tyre përshëndetëse edhe Drejtuesi i Ekipit të Asistencës së Projektit IPA 2009 si dhe përfaqësuesi i Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Të pranishmëve iu shpërnda gjithashtu një set me materiale sensibilizuese mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përgatitura nga Projekti si dhe nga Autoriteti i Komisionerit.

~ Organizimi i Seminarit me temë "Hartimi i akteve ligjore me përmbajtje mbrojtjen e të dhënave personale"

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Projektit IPA 2009 "Konsolidimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri sipas standardeve të BE-së" (Europe Aid/129606/C/SER/AL) dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në dt 20 Shtator në mjediset e "Hotel Tirana International" u organizua seminari me temë "Hartimi i Akteve Ligjore me Përmbajtje Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Në startin e këtij aktiviteti u mbajtën fjalime hapëse nga Komisionerja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Flora Çabej (Pogaçe), nga Z.Gjergj Lezhja, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave si dhe nga Drejtuesja e Projektit IPA 2009 "Konsolidimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri sipas standardeve të BE-së" Znj.Dorota Skolimowska. Në këtë seminar, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të drejtorive ligjore të të gjitha ministrive të linjës dhe institucioneve të vartësisë, prezantimet u mbajtën nga ekspertë në nivel ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe teknikës së hartimit ligjor, si Znj.Waltraut Kotschy, ish-Komisioneri i Këshillit të Evropës dhe ish-Komisioneri Austriak për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe Z.Jose Lopez Calvo, zv. Komisioner i Autoritetit Spanjoll për Mbrojtjen e të Dhënave. Gjithashtu një prezantim u mbajt edhe nga Drejtoresha e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënive me Jashtë pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti, ishte rritja e nivelit të

ndërgjegjësimi të juristëve të përfshirë në hartimin e projekt-akteve me përmbajtje të dhënave personale, si dhe në drejtim të detyrimeve ligjore përpara i përket përfshirjes së KMDP-së në procesin e konsultimit përpara se ato të kalojnë për miratim në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvendin e Shqipërisë.

~ Aktivitetet sensibilizuese me qytetarët e Shkodrës, Vlorës, Fierit dhe Durrësit mbi rritjen e ndërgjegjësimi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjatë vitit 2012, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me asistencën e Projektit IPA 2009 të titulluar "Konsolidimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri", kanë organizuar 4 aktivitete sensibilizuese me qytetarë, subjekte të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale në qytetet e Shkodrës, Vlorës, Fierit dhe Durrësit. Në këto aktivitete sensibilizuese morën pjesë përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të projektit IPA, të cilët ndanë mesazhe kyçe me qytetarë të ndryshëm në drejtim të ruajtjes së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu qytetarëve iu shpërndanë materiale të shumëllojshme sensibilizuese si fletëpalosje, stilolapsa, stema me logo, blloqe shënimesh etj si dhe shumë materiale të tjera promovuese të cilat përmbanin mesazhe informuese për qytetarin si "Mendo përpara se të klikosh", "A dini të matni privatësinë tuaj", "Respekto privatësinë time" etj. Aktivitetet u ndoqën me interes nga qytetarët të cilët u afruan të shumtë në numër në standat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke marrë informacion të gjerë në lidhje me të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Qytetarët pasi u informuan mbi të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, plotësuan një test të shkurtër në lidhje me njohuritë e fituara gjatë aktivitetit. Për ata të cilët plotësuan saktësisht pyetjet e ngritura u shpërndanë dhurata të ndryshme. Gjithashtu këto aktivitete janë ndjekur edhe nga përfaqësues të mediave më kryesore si: TVSH, ATSH, ABC Neës, Alb Screen, UTV, News 24 etj por edhe shumë media lokale nga të gjitha qytetet respektive ku u zhvilluan këto aktivitete. Organizimi i aktiviteteve të tilla sensibilizuese synojnë rritjen e nivelit të ndërgjegjësimi të qytetarëve shqiptarë mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

● **Me të rinjtë.**

~ Seminar ndërgjegjëses me studentë të Universitetit "Marin Barleti".

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Universitetin "Marin Barleti" më datë 7 Mars 2012 në ambientet e këtij universiteti, organizoi seminarin ndërgjegjëses mbi mbrojtjen e të dhënave personale ku të ftuar ishin studentë të fakultetit të Shkencave Sociale të këtij universiteti si dhe pjesëtarë të stafit akademik. Në panel u referuan tema në lidhje me njohjen e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe temat të tjera të cilat kanë të bëjnë me rreziqet e shkeljes së privatësisë nga keqpërdorimi i rrjeteve sociale, privatësia në kohën e internetit dhe siguria e informacionit. Temat e referuara u ndoqën me interes nga studentët dhe stafi pedagogjik i universitetit Marin Barleti të cilët në përfundim të referimeve zhvilluan një sërë pyetjesh si dhe diskutuan në lidhje me çështje të mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë edhe disa lloje të ndryshme fletëpalosjesh të publikuara këto nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për t'i ardhur në ndihmë ndërgjegjësimi të subjekteve të të dhënave personale.

~ Seminar ndërgjegjësues me Psikologët e shkollave publike të qytetit të Tiranës.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të vazhdimit të fushatës ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese mbi mbrojtjen e të dhënave personale në Prill 2012, organizoi në Tiranë një seminar me psikologët e shkollave publike të qytetit të Tiranës. Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të psikologëve në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave në rolin e kontrolluesit. Gjatë këtij aktiviteti u mbajtën referime të ndryshme mbi mbrojtjen e të dhënave nga përfaqësuesit e autoritetit të Komisionerit por në kuadër të Projektit IPA 2009 “Konsolidimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Shqipëri”, ishte gjithashtu e pranishme dhe ekspertja e mirënjohur çeke Hana Stepankova e cila ndau me të pranishmit eksperiencën e Republikës Çeke në mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan edhe rubrikat e faqes zyrtare të autoritetit të Komisionerit në të cilat mund të gjendet informacion i bollshëm dhe i detajuar mbi mbrojtjen e të dhënave personale tek nxënësit dhe tek të rinjtë, informacione të cilat mund të përdoren nga psikologët në punën e tyre të përditshme. Të pranishmëve iu shpërnda gjithashtu edhe një dosje me të gjitha materialet e publikuara nga autoriteti i Komisionerit. Në organizimin e këtij takimi dha ndihmesën e saj të vyer dhe Drejtoria Arsimore Tiranë.

~ Seminar ndërgjegjësues me Studentët e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në datën 18 Prill 2012, organizoi një seminar ndërgjegjësues me studentët e fakultetit të shkencave humane në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Ky aktivitet u ndoq me interes nga rreth 150 studentë të këtij fakulteti si dhe nga përfaqësues të stafit pedagogjik. Gjatë këtij aktiviteti përfaqësuesit e Autoritetit të Komisionerit informuan studentët mbi fushën që mbulon Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një prezantim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe i kushtuan një vëmendje të veçantë prezantimit të temave në lidhje me efektet anësore të përdorimit të rrjeteve sociale, privatësia dhe të dhënat personale në Internet si dhe në lidhje me sigurinë e informacionit në përgjithësi. Seminari nxiti kureshtjen e studentëve të cilët treguan interes në temat mbi privatësinë gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe në përgjithësi gjatë lundrimit në Internet. Seminari u ndoq edhe nga media lokale, pikërisht nga televizioni Skampa i cili zhvilloi një intervistë me një nga përfaqësuesit e Autoritetit të Komisionerit në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale për rëndësinë e aktivitetit të organizuar në qytetin e Elbasanit. Po ashtu gjatë këtij seminari u shpërndanë edhe shumë fletëpalosje të ndryshme të publikuara nga KMDP me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

~ Ndërgjegjësim i të rinjve mbi mbrojtjen e të dhënave personale në ambientin e internetit.

Në Maj 2012, përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale morën pjesë si të ftuar në një konkurs të organizuar nga Drejtoria Arsimore Tiranë me qëllim krijimin e lojrave kompjuterike në grupmoshën 12-18 vjeç. Në aktivitetin e realizuar në ambientet e

Liceut Artistik “Jordan Misja”, kishte rreth 100 të pranishëm, të gjithë përdorues të rregullt të Internetit. Përfaqësuesi i Autoritetit të Komisionerit, përshëndeti pjesëmarrësit në këtë aktivitet dhe pasi bëri një ekspozitë të Institucionit të Komisionerit dhe fushës që ai mbulon, i ftoi të pranishmit që të jenë sa më të ndërgjegjshëm në përhapjen e të dhënave personale, sidomos në ambientin e internetit. Përfaqësuesit e Komisionerit gjithashtu bënë të mundur shpërndarjen tek të rinjtë të kapeleve me logon dhe adresën e faqes zyrtare të institucionit si dhe të fletëpalosjeve në të cilat shpjegohen qartë rreziqet që mund të vijnë nga ekspozimi i tepruar i të dhënave personale.

~ Seminar ndërgjegjësues me mësuesit dhe senatorët e Shkollës 9 vjeçare “Osman Myderizi” Tiranë si dhe me mësuesit dhe senatorët e shkollës 9 vjeçare “Gjon Buzuku” Tiranë.

Në vazhdim të aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u zhvillua një takim ndërgjegjësues në shkollën 9 vjeçare “Osman Myderizi” në Tiranë si dhe një tjetër takim me mësuesit dhe senatorët e shkollës 9 vjeçare “Gjon Buzuku” Tiranë. Këto takime ndërgjegjësues me mësuesit dhe senatorët e klasave të 9-ta kishin në fokusin e tyre trajtimin e rreziqeve të shkeljes së privatësisë gjatë përdorimit të internetit si dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit në përgjithësi. Temat u referuan nga specialistë të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun. Stafi pedagogjik dhe nxënësit treguan interes të veçantë për sa i përket temës së privatësisë gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, duke marrë pjesë aktive me pyetje e diskutime të shumta. Gjatë këtyre aktiviteteve, të pranishmëve iu shpërndanë dhe dosje me fletëpalosje të publikuara nga Autoriteti i Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të cilat bëjnë të mundur njohjen e publikut të gjerë me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

~ Seminar ndërgjegjësues me senatorët e shkollës së mesme të përgjithshme “Çajupi”

Në muajin dhjetor përfaqësues të Autoritetit të Komisionerit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shkollës së mesme “Çajupi” organizuan një takim ndërgjegjësues me senatorët e kësaj shkolle me qëllim sensibilizimin e tyre mbi fushën tepër të rëndësishme të mbrojtjes së të dhënave personale. Specialistët e autoritetit të Komisionerit pasi bënë një ekspozitë të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale u ndalën tek efektet anësore që mund të shkaktohen tek të rinjtë nga përdorimi i rrjeteve sociale. Kjo temë u ndoq me mjaft interes nga nxënësit e pranishëm duke i bërë dhe ata vetë pjesë aktive të këtij debati. Gjithashtu me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përcimit të mesazhit të mbrojtjes së të dhënave, nxënësve të pranishëm iu shpërndanë materiale të ndryshme sensibilizuese si çanta, bluza dhe kapele me logon e KMDP-së si dhe fletëpalosje të ndryshme. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizon aktiviteteve ndërgjegjësuese në mënyrë të vazhdueshme me qëllim shtrirjen e sensibilizimit mbi mbrojtjen e të dhënave tek të gjithë moshat e reja.

● **Komunikimi me Median.**

~ Intervista.

Duke marrë shkas nga aktivitetet e zhvilluara me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave, përfaqësues të Komisionerit u ftuan në Televizionin UTV në emisionin e mëngjesit me qëllim zhvillimin e një bisede me temë mbrojtjen e të dhënave personale dhe shpjegimin e të drejtave të qytetarëve.

Intervista të ndryshme janë dhënë gjatë gjithë vitit 2012 kështu në muajin shkurt, dy televizione private (NTV dhe A1) kanë ftuar drejtues të Komisionerit dhe kanë zhvilluar biseda me gazetarët në lidhje me zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, shpjegimin e të drejtave të qytetarëve si dhe iu është përgjigjur pyetjeve të shumta të drejtuara nga intervistuesit. Gjithashtu gjatë këtij viti, përfaqësues të Komisionerit kanë dhënë intervista me qëllim ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e opinionit publik mbi mbrojtjen e të dhënave personale në disa nga radiot dhe televizionet më të rëndësishme në vend si : Ora NEËS, Top Channel, Vizion Plus, Scan Tv, NRG Radio etj.

~ Seminar me studentë të gazetarisë të Universitetit të Tiranës.

~ Në Shkurt 2012, në ambientet e Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u organizua një seminar me studentët diplomantë të degës së gazetarisë së Universitetit të Tiranës. Ky seminar kishte si qëllim sensibilizimin e gazetarëve të ardhshëm mbi fushën e gjerë të mbrojtjes së të dhënave personale si dhe mbi përpunimin e të dhënave personale në fushën e medias. Nga ana e specialistëve të KMDP-së u mbajtën disa prezantime të cilat synonin rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit tek studentët aktualisht si subjekte të të dhënave personale dhe në të ardhmen, në rolin e kontrolluesit gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarit. Seminari pati një kohëzgjatje të konsiderueshme prej rreth 3 orësh dhe u mundësua krijimi i një ambienti diskutimi me 18 pjesëmarrësit. Një theks i veçantë iu kushtua gjetjes së ekuilibrit në kronikat mediatike mes së drejtës për informim dhe së drejtës së privatësisë. Të pranishmëve gjithashtu iu shpërnda një set me broshura e fletëpalosje sensibilizuese të KMDP-së.

~ Takim informal me gazetarë të medias së shkruar dhe asaj vizive.

Në Prill 2012, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u organizua një takim me gazetarë të medias së shkruar dhe asaj vizive. Qëllimi i këtij takimi ishte krijimi i një ambienti të përshtatshëm komunikimi mes përfaqësuesve të Autoritetit të Komisionerit dhe gazetarëve në kuadër të trajtimit të problematikave të hasura në kronikat e medias në lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Një theks i veçantë iu vu rëndësisë së gjetjes së balancës së duhur mes së drejtës për informim të qytetarëve dhe të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë takim mori pjesë gjithashtu edhe ekspertja çeke Znj.Hana Stepankova, e mirënjohur në fushën e mbrojtjes së të dhënave jo vetëm si një eksperte por dhe si ish-gazetare, e cila iu përgjigj pyetjeve të ndryshme të të pranishmëve. Znj.Stepankova ishte

e ftuar në rolin e ekspertës afatshkurtër në kuadër të Projektit IPA 2009 me qëllim dhënien e eksperiencës së saj. Autoriteti i Komisionerit është i vendosur që edhe në të ardhmen të vazhdojë të ketë bashkëpunim të ngushtë me median duke qenë se e konsideron atë një partner tepër të rëndësishëm në mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë.

~ Konferenca për shtyp.

Në muajin Prill, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një Konferencë për Shtyp me qëllim informimin e opinionit publik mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën Janar – Mars 2012. Kronika e kësaj konference për shtyp, u transmetua në edicionet qendrore të lajmeve të disa prej mediave më të njohura në vend.

~ Artikuj të botuar në shtypin e shkruar.

Komisionerja Çabej ka publikuar në muajin Tetor një artikull në revistën prestigjioze “Privacy Laës & Business International” me titull: “Shqipëria ndryshon Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë që të pasqyrohet Direktiva Evropiane”.

Janë botuar gjithashtu dy artikuj mbi rëndësinë e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale në dy nga të përditshmet kryesore shqiptare siç janë gazetat “Mapo” dhe “Shekulli”. Këto artikuj janë publikuar në kudër të rritjes së ndërgjegjësimit të shtetasve shqiptarë mbi mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë që subjektet e të dhënave personale të njihen me të drejtat e tyre që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

~ Rekomandime dërguar medias së shkruar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i vëmendshëm ndaj rasteve të moszbatimit korrekt të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale në shtypin e shkruar dhe i është drejtuar atij herë pas here me shkresa rekomanduese. Në kuadër të monitorimit të shtypit të shkruar këtë vit janë dërguar disa rekomandime në lidhje me përpunimin jo të drejtë të të dhënave personale në artikujt e disa të përditshmeve. Konkretisht këto rekomandime u janë dërguar redaksive të Gazetave “Panorama” (2 rekomandime) dhe Gazetës “Tirana Observer”. Rekomandimet për Gazetën “Panorama” janë dërguar në mënyrë që kjo e përditshme të tregojë më tepër kujdes në raportimin e fakteve të cilat bëjnë publike të dhëna sensitive të personit siç janë të dhënat shëndetësore si dhe të mos publikojë foto të personave të vdekur. Ndërsa redaksisë së Gazetës “Tirana Observer” i është rekomanduar mospërhapja e të dhënave personale e të miturve në mënyrë që të mos jenë të identifikueshëm në rastet e ushtrimit të dhunës.

● **Të tjera.**

~ Marrja e çmimit nga ana e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit

Në Mars 2012, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Akademisë së Arteve, Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit shpërndau disa çmime në lidhje me performancat e disa institucioneve dhe agjencive në mbrojtje të konsumatorit shqiptar. Gjatë këtij aktiviteti,

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale iu akordua Çmimi Evropian i Konsumatorëve Shqiptarë me motivacionin “ Për rolin institucional ligjor dhe kontributin real në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve nga abuzimet me të dhënat personale on-line ” në periudhën 15 Mars 2011 – 15 Mars 2012.

~ Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ve ne sherbim te **qytetarit** Numrin Jeshil **0800 20 50**.

Komisioneri fton të gjithë qytetarët të denoncojnë të gjitha rastet në të cilat mund të konstatohet shkelje të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale. Për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vë në dispozicion të qytetarëve **Numrin Jeshil 0800 20 50** i cili nuk ka kosto pagese për telefonuesit. Numri është në funksionim gjatë orarit zyrtar të Autoritetit të Komisionerit. Vënia në dispozicion të qytetarëve e këtij Numri Jeshil pa pagesë, ka si qëllim të rrisë numrin e ankesave të subjekteve të të dhënave personale.

~ Biblioteka e Institucionit.

Është pasuruar Biblioteka e institucionit me tituj të rinj të administruar nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun. Biblioteka e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është një bibliotekë e hapur jo vetëm për punonjësit e autoritetit por edhe për publikun e gjerë. Stafi i Komisionerit është angazhuar gjithashtu në kryerjen e përkthimeve nga eksperiencia evropiane e mbrojtjes së të dhënave të cilat janë publikuar gjithashtu dhe në faqen zyrtare të institucionit.

II.II Zhvillimet e njoftimit të subjekteve kontrollues.

Edhe për vitin 2012 prioritet i punës së KMDP-së ishte sensibilizimi i subjekteve kontrolluese, njohja me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe zbatimi i detyrimit të tyre ligjor për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për gjendjen e përpunimit të të dhënave personale. Kjo strategji kërkonte informacionin e duhur për të evidentuar kontrolluesit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për këtë, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 5048 Prot dhe Nr. 100 Prot, Dt. 29.04.2010 të lidhur ndërmjet KMDP-së dhe QKR-së kemi mbajtur komunikim të vazhdueshëm me QKR-në për të bërë të mundur sigurimin e listës me subjektet kontrolluese të reja që regjistrohen. Në fund të muajit Mars 2012 na u dërgua lista me subjekte të reja të regjistruara pranë QKR-së .

Nisur nga problematika e hasur gjatë vitit 2011, lidhur me një numër të konsiderueshëm shkresash sensibilizuese të nisura nga ana jonë në drejtim të subjekteve kontrolluese dhe të kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare për pasaktësi adresash, gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 KMDP ka bashkëpunuar ngushtë me Postën Shqiptare duke dërguar fillimisht pranë tyre listat me emrat e kontrolluesve të cilëve do t’ju dërgoheshin shkresa sensibilizuese dhe vetëm pasi bëhej verifikimi i adresave nga ana e Postës dhe konfirmoheshin nga ana e tyre të sakta, janë nisur nga ana jonë në drejtim të këtyre kontrolluesve. Në këtë mënyrë u arrit që të minimizohen shkresat e kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare.

Gjithashtu, u sigurua lista me të gjitha subjektet kontrolluese “*Shkolla*”, të cilat në shumicën e tyre janë subjekte kontrolluese publike. Kjo listë na u vu në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. 396 Prot, datë 24.01.2011, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Institucionit tonë, por edhe pas kontaktit dhe këmbënguljes tonë për sigurimin e kësaj liste.

Paralelisht sistemit publik, pasi u identifikuan adresat elektronike të shkollave private të licënuara nga Ministria e Arsimit, u dërguan email-e drejtuar këtyre kontakteve me qëllim njohjen me ligjin dhe detyrimin për të njoftuar pranë Autoritetin e Komisionerit.

Duke qenë se, sensibilizimi drejtuar shkollave publike është shtrirë në të gjithë vendin, kemi pasur kërkesa të vazhdueshme nga Drejtoritë Arsimore dhe Zyrat Arsimore të rretheve si dhe nga një numër i konsiderueshëm shkollash, ku na kërkohej asistencë në lidhje me plotësimin e formularit.

Në këtë kuadër, u ndryshua strategjia e punës së Drejtorisë së Regjistrimit duke ulur numrin e shkresave sensibilizuese drejtuar këtyre subjekteve kontrollues pasi u pa e arsyeshme zhvillimi i seminareve sensibilizuese me përfaqësuesit e këtyre institucioneve me qëllim ndërgjegjësimin e këtyre kontrolluesve publikë dhe privatë mbi përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe mbi detyrimin ligjor që parashikon neni 21 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar për përmbushjen e detyrimit për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këtë kuadër, u bashkëpunua me Drejtoritë Arsimore dhe Zyrat Arsimore të disa rretheve dhe u realizuan për rrjedhojë seminare me përfaqësues të arsimit parashkollor, nëntëvjeçar dhe të mesëm në varësi të Drejtorive respektive.

Në këtë mënyrë u arritën rezultate shumë të kënaqshme në Drejtoritë Rajonale Arsimore:

- Drejtoria Arsimore Tiranë
- Drejtoria Arsimore Shkodër
- Drejtoria Arsimore Krujë
- Drejtoria Arsimore Korçë
- Drejtoria Arsimore Dibër
- Drejtoria Arsimore Kukës
- Drejtoria Arsimore Durrës
- Drejtoria Arsimore Vlorë
- Drejtoria Arsimore Fier
- Drejtoria Arsimore Elbasan
- Drejtoria Arsimore Gjirokastrë
- Zyra Arsimore Pogradec
- Zyra Arsimore Sarandë.

Pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve u shfaqën dhe nga televizionet lokale dhe ato kombëtare. Në këto seminare morën pjesë përfaqësues të Drejtorive Arsimore si dhe të gjithë drejtuesit e shkollave të nivelit parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm në varësitë respektive të këtyre

Drejtorive, ku pjesëmarrësit u njohën me Ligjin dhe Autoritetin e Komisionerit, rëndësinë dhe risinë që sjell ky ligj dhe më gjerësisht u trajtua tema kryesore mbi detyrimin që kanë kontrolluesit për të njoftuar. Të gjithë pjesëmarrësve në këto aktivitete iu shpërndanë materiale të ndryshme si fletëpalosje dhe broshura, qëllimi i të cilave është pasqyrimi i veprimtarisë së autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe njohja e subjekteve të të dhënave me ushtrimin e të drejtës së tyre.

Produkti final dhe shumë i rëndësishëm i këtyre seminareve ka qenë formulari i njoftimit, për të cilin subjektet u trajnuan se si ti kuptojnë drejt kërkesat e tij dhe u asistuan se si ta plotësojnë atë në mënyrën më të mirë të mundshme me qëllim dhënien e informacioneve që kërkon ky detyrim ligjor. Pjesëmarrja në këto seminare ka qenë shumë e lartë dhe kjo solli një prurje të konsiderueshme në njoftime por dhe në sensibilizimin me një shpërndarje të gjerë gjeografike.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore iu dërgua nga ana jonë rregullorja tip “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, të cilën këto institucione arsimore mund ta përshtatin sipas nevojave të aktivitetit të tyre.

Prioritet dhe objektivë tjetër e arrirë mund të përmendet edhe asistencë e vazhdueshme që i është ofruar kontrolluesve që njoftojnë, me qëllim plotësimin sa më të saktë të formularit të njoftimit. Kjo asistencë ju është ofruar nëpërmjet komunikimeve telefonike, postës elektronike dhe duke i pritur përfaqësuesit e këtyre kontrolluesve pranë ambienteve të Komisionerit.

Bazuar në praktikën e krijuar në këto vite dhe në problematikat e hasura në lidhje me kuptimin e formularit të njoftimit nga ana e subjekteve por edhe në bazë të informacionit që synohet të mblidhet nëpërmjet tij, duke reflektuar edhe amendimet e fundit të ligjit, është gjykuar i domosdoshëm ndryshimi i renditjes së rubrikave në Formularin e Njoftimit.

Nisur nga eksperiencia e deritanishme dhe nga kontaktet e shumta me përfaqësues të kontrolluesve të ndryshëm në mbarë vendin, kemi parë që subjektet e kanë shumë të vështirë që ta nisin deklarin në njoftimin e tyre pranë KMDP-së, duke plotësuar fillimisht qëllimin e përpunimit, kjo për arsye se nuk e kanë të qartë se çfarë duhet të lidhin me këtë qëllim. Pothuajse gjithmonë gjatë asistencës që kemi dhënë për plotësimin e formularit jemi munduar që të shpjegojmë fillimisht se kush janë kategoritë e subjekteve të cilave u përpunohen të dhëna nga subjekti kontrollues, çfarë të dhënash përpunohen dhe pasi janë sqaruar për kategoritë e subjekteve, për kategoritë e të dhënave e kanë pasur më të thjeshtë të kuptojnë dhe të deklarojnë qëllimin për secilën nga kategoritë të cilave u përpunojnë të dhëna.

Përfundimisht, këto ndryshime konsistojnë që në renditjen e rubrikave ekzistuese të formularit në strukturën e tij ashtu dhe në riformulimin e disa nën/rubrikave, duke qartësuar panoramën e përgjithshme të informacionit të kërkuar nëpërmjet formularit, ndryshime të cilat bënë të mundur ndryshimin e Formularit të Njoftimit si dhe të Udhëzuesit Si plotësohet Formulari i Njoftimit, të cilat u finalizuan me miratimin e urdhrin të Komisionerit Nr. 221 datë 27.12.2012.

Ndër vite, lindi nevoja që Autoriteti i Komisionerit të implementonte një sistem ndërveprues intraneti, ku një pjesë shumë të rëndësishme do të zinte sistemi në funksion të procesit të regjistrimit si dhe manaxhimi i tërë këtij sistemi të dhënash në funksion të gjithë Autoritetit të

Komisionerit në tërësi duke sjellë një feedback pozitiv në përmirësimin e efikasitetit dhe si një mënyrë për të realizuar në kohë më të shpejtë dhe me efikasitet proceset administrative.

Duke pasur parasysh se, suksesi i funksionimit të një sistemi është gjenerimi i raporteve, nisur dhe nga kërkesat e natyrës së raporteve me informacione të nevojshme për t'u paraqitur në vazhdimësi nga ana e specialistëve, lindi domosdoshmëria e një sistemi të aftë për ti gjeneruar ato në mënyrë që rezultati të jetë i shpejtë dhe i saktë. Për krijimin e këtij programi kemi paraqitur kërkesat se si duhet të paraqitet dhe funksionojë ky program në mënyrë që ti shërbejë interesave jo vetëm të Drejtorisë së Regjistrimit në punën e përditshme por edhe që drejtoritë e tjera të institucionit të kenë akses në informacionin e domosdoshëm për vijimin e punës në zbatim të kompetencave të tyre.

II.III Menaxhimi i njoftimeve dhe regjistrimi i subjekteve kontrollues.

Autoritetit i KMDP-së ka qenë pritësi i një sistemi të tërë informacioni që nga njoftimet, kërkesat për informacion plotësues, informacione shtesë të ardhur nga subjektet, deklarata ndryshimi apo kthim përgjigje të shkresave sensibilizuese dhe informacione të ndryshme rast pas rasti, të cilat kemi mundur ti menaxhojmë me efektivitet në sajë të një organizimi të brendshëm dhe pune sistematike.

Gjithashtu, në sajë të politikës dhe strategjisë për të ndihmuar e asistuar subjektet kontrolluese që njoftojnë, janë pritur për sqarim dhe asistencë si dhe është kryer komunikimi telefonik me një numër të konsiderueshëm subjektesh kontrolluese që kanë telefonuar pranë zyrave tona.

Njoftimi pranë Autoritetit të Komisionerit është realizuar sipas “*Formularit të Njoftimit*”, miratuar me Urdhrin e Komisionerit Nr. 66, datë 01.10.2009, i ndryshuar me Urdhrin Nr. 44, datë 07.05.2010. Ky njoftim është realizuar në dy mënyra, nëpërmjet aplikimit duke plotësuar dhe dërguar formularin e njoftimit online ose duke e shkarkuar, plotësuar dhe dërguar dorazi apo me postë pranë institucionit tonë.

Më pas çdo formular është shqyrtuar, duke pasur parasysh kërkesat e nenit 22 të ligjit. Bazuar në nenin 23 të ligjit, kemi trajtuar nëpërmjet kërkesës për informacion plotësues çdo deklaram që ka rezultuar i paplotë, i paqartë, si dhe për të verifikuar më tej ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave nga kontrolluesit, si dhe në kuadrin e kontrollit paraprak në rastet e verifikimit të domosdoshmërisë ligjore për paraqitjen e kërkesave për autorizimin e Komisionerit për përpunimin e të dhënave sensitive dhe transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Në vijim të strategjisë parësore për identifikimin e subjekteve kontrolluese, kemi dërguar rreth **3511 shkresa zyrtare sensibilizuese** drejtuar subjekteve kontrolluese private dhe publike duke i kërkuar plotësimin e detyrimit për njoftim, bazuar në nenet 21-26 të ligjit. Në krahasim më vitet e kaluara kjo shifër është më e ulët për shkak të ndryshimit të strategjisë së punës tonë duke organizuar seminare në rrethe të ndryshme të vendit dhe duke synuar kontakte të drejtëpërdrejta me subjektet kontrollues.

Numri i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë për **vitin 2012 është 1364**, ndërsa në **vitin 2011 ishte 1038**.

Sektori publik për vitin 2012 ka 82% të njoftimeve ndërsa sektori privat ka 18%, ndërsa për vitin 2011 kemi këtë përqindje të njoftimeve:

- ~ 21% nga sektori publik;
- ~ 74 nga sektori privat; dhe
- ~ 5% nga OJF.

Numri total i subjekteve të regjistruara në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese pranë KMDP-së, **për vitin 2012 është 1477**, ndërsa për **vitin 2011 ishte 871**, duke e çuar numrin e përgjithshëm në **3390**.

Produkti final dhe shumë i rëndësishëm është se, tashmë subjektet e të dhënave, individët dhe publiku i gjerë ka informacion mbi gjendjen e përpunimit të të dhënave personale për rreth **3390** subjekte kontrolluese, informacion i cili do të kontribuojë në ezaurimin e të drejtave të tyre pranë kontrolluesve, si dhe për të realizuar ankimimin pranë KMDP-së.

II.IV Evidentimi dhe informimi mbi rastet që përbëjnë cënim të privatësisë dhe i të dhënave personale.

Në kuadrin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Inspektimit, me qëllim rritjen e numrit të njoftimeve, por edhe për zbatimin sa më rigoroz të ligjit kur dispozita të tij shkelen, kemi informuar rregullisht këtë Drejtori për subjektet të cilëve ju është dërguar shkresë zyrtare dhe të cilët nuk kanë njoftuar brenda afateve të vendosura, duke mos plotësuar detyrimin për njoftim, si dhe për subjektet të cilat nuk kanë plotësuar e saktësuar informacionin e deklaruar, çka përbën kundërvajtje administrative.

Gjithashtu, në zbatim të dispozitave mbi “Kontrollin Paraprak” dhe dispozitave të përgjithshme, bazuar mbi deklaratimet e ardhura nëpërmjet formularit të njoftimit, kemi shkëmbyer dhe rakorduar ndërmjet strukturave të KMDP-së informacione me qëllim evidentimin e rasteve që përbëjnë shkelje të privatësisë dhe që mund të jenë objekt i verifikimeve të mëtejshme, hetimeve administrative, inspektimeve, dhënies së rekomandimeve apo që përbëjnë shkelje administrative dhe dënohen më gjobë;

Ndër rastet e trajtuara mund të përmendim:

- ~ Kontrolluesi: **“TALM-ALBANIA”**;
- ~ Kontrolluesi: **SHOQATA GJYSMEHËNA E KUQE E E.B.A**;
- ~ Kontrolluesi **“ESI-ENA”** ;
- ~ Kontrolluesi: **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave**;
- ~ Kontrolluesi: **Tema Retail Al Sh.p.k**;
- ~ Kontrolluesi: **MAI sh.a**;
- ~ Kontrolluesi: **Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”**;

të cilët deklarojnë se transferojnë të dhëna personale jashtë vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe nuk janë përgjigjur informacionit plotësues të kërkuar nga ana jonë ose të kenë paraqitur pranë KMDP-së kërkesën për autorizim. Këto dosje janë të paregjistruara në Regjistrin e Njoftimeve dhe në këtë mënyrë për këta kontrollues njoftimi quhet i pakryer.

Nisur nga fakti i uljes së numrit të kërkesave për autorizim të paraqitur pranë KMDP-së për vitin 2012, në lidhje me transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, kemi përcjellë pranë drejtorisë së Hetim Inspektimit relacione së bashku me praktikat e Formularëve të Njoftimit të subjekteve kontrolluese të regjistruara, të cilat kanë deklaruar se kryejnë transferim ndërkombëtar jashtë vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale por që e kryejnë atë konform dispozitave të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave personale”. Të tilla mund të përmendim:

- ~ **Financial WEB Services**
- ~ **M.R.D.C Fondation**
- ~ **ABB Global Marketing Albania**
- ~ **BEN-AF**

KMDP ka qenë tërësisht e përkushtuar për të realizuar objektivin e përcaktuar në strategjinë e vitit 2012 dhe e ka kryer atë objektiv modest, duke menaxhuar maksimalisht informacionin e ardhur nëpërmjet formularëve të njoftimit, shqyrtimin ligjor të deklarimeve dhe evidentimin e rasteve për verifikim dhe rasteve që përbejnë kundërvajtje administrative.

KAPITULLI III.

ECURIA E KUADRIT LIGJOR.

III.I Miratimi i ligjit Nr. 48/2012 gjatë vitit 2012.

Ndër arritjet më të mëdha për vitin 2012 konsiderojmë miratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Projektligji në fjalë u hartua me ndihmën e Projektit EU-IPA 2009 “Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Komisioneri së bashku me stafin e tij por edhe me Ekspertët e Projektit gjatë muajit Prill 2012 kanë marrë pjesë në diskutimet që u bënë rreth këtij projektligji në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe në Komisionin e Integritimit European. Në këto Komisione projektligji u miratua me unanimitet si në tërësi ashtu edhe nen për nen.

Në seancën parlamentare të mbajtur në datën 26 Prill 2012, Projektligji u miratua në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në drejtim të përgatitjes së projektligjit, projekti, përveçse ka rekomanduar transpozimin e plotë të direktivës 95/46/EC, ka sjellë edhe parashikime nga eksperiencia e gjatë e punës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas zgjidhjeve të ngjashme ligjore që janë dhënë në vendet e Bashkimit Evropian .

Ligji i amenduar ndër të tjera ka parashikuar:

- ~ Përforcimin e rolit vendimmarrës të Komisionerit, si autoritet i pavarur;

- ~ Disiplinimin e punës së kontrolluesit, si dhe të këtij me përpunuesin;
- ~ Sanksione administrative (gjyba)më të larta në rast të konstatimit të shkeljeve të ligjit.

Miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” është reflektuar dhe në ndryshimet përkatëse në aktet nënligjore të miratuara më parë nga Komisioneri, me qëllim përputhjen e plotë me ligjin e miratuar.

Në kuadër të sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve me ndryshimet e ligjit faktor kyç ka qenë dhe organizimi i seminarëve dhe aktiviteteve të tjera me pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë. Në këto aktivitete janë promovuar pikërisht risitë që kanë sjellë amendimet e ligjit dhe ndërgjegjësimi më tej për të dhënat personale si një dimension i rëndësishëm i të drejtave të njeriut.

III.II Miratimi i udhëzimeve për fusha të ndryshme.

Duke pasur një fushë të gjerë të veprimtarisë dhe përgjegjësi të tij, Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar ka hartuar një sërë aktesh nënligjore të cilat janë botuar në Fletore Zyrtare duke sjellë kështu detyrueshmërinë e tyre për t’u zbatuar nga kontrolluesit në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit për të cilin po raportojmë kemi patur një bashkëpunim të ngushtë me Projektin EU-IPA 2009 “Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i cili ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në arritjen e një dimensionit evropian në hartimin e këtyre akteve nënligjore.

Për hartimin e këtyre akteve jemi bazuar edhe në plan veprimin e Strategjisë së vitit 2011-2013. Në të janë parashikuar, hartimi i akteve për fusha ku përpunimi i të dhënave personale përbën pjesë të madhe të veprimtarisë së tyre.

~ Udhëzime :

1. Udhëzimi Nr. 17, datë 11.05.2012 mbi "Përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e policisë së shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale".

Ky udhëzim është përgatitur me mbështetjen e eksperteve të Projektit në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ai synon të përcaktojë rregullat mbi kohën e mbajtjes së të dhënave personale në sistemet elektronike dhe më konkretisht procedurat e administrimit të të dhënave në funksion të respektimit të afatit të rishikimit të kohës së mbajtjes së tyre nga punonjësit e policisë së shtetit, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Udhëzimi Nr. 18, datë 03.07.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadrin e provave klinike të barnave”;

Ky Udhëzim rregullon disa të drejta dhe detyrime të kontrolluesit që lidhen me mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në kuadrin e provave klinike të barnave tek njerëzit. Ai ka parashikuar dhënien e pëlqimit të informuar në të cilin të përcaktohet në mënyrë të qartë qëllimi i përpunimit dhe marrësi i të dhënave personale, cilat të dhëna personale përpunohen dhe sa është periudha e mbajtjes së tyre, bërjen anonime të të dhënave personale, etj.

3. Udhëzimi Nr. 19, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave në lidhje me marrëdhënien mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, si dhe miratimi i një kontrate tip që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi. Fusha e zbatimit të këtij udhëzimi shtrihet për të gjithë kompanitë, organizatat apo institucionet që, me qëllim përmbushjen e funksioneve të tyre të ligjshme, hyjnë në marrëdhënie me kompani të treta dhe nëpërmjet kontratës, bien dakord që këto kompani të kryejnë përpunimin e të dhënave personale për llogari të tyre.

4. Udhëzimi Nr.20, datë 03.08.2012 “Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar”

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve bankë, degë e bankës së huaj si dhe subjekt financiar jobankë në kuadrin e përpunimit të të dhënave personale gjatë aktivitetit të tyre bankar. Ky udhëzim zbatohet nga të gjitha subjektet financiare të cilat gjatë aktivitetit të tyre financiar mbajnë, administrojnë dhe kontrollojnë të dhëna personale për qëllime të aktivitetit bankar dhe financiar. Udhëzimi ka synuar kryerjen e veprimeve me pëlqimin e subjektit të të dhënave personale si dhe mos mbledhjen e të dhënave në tejkalim të qëllimit siç është rasti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore.

5. Udhëzimi Nr. 21, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigorisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”.

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj, ose përpunuesit, që ndryshe quhen subjektet përpunuese të të dhënave personale, si dhe rregullat e bashkëpunimit të tyre me Komisionerin. I rëndësishëm për tu theksuar është fakti se masat e sigorisë të përcaktuara në këtë udhëzim janë të nivelit më të lartë teknik dhe për herë të parë në një akt parashikohet roli i “Personit të Kontaktit/personit të ngarkuar” dhe kompetencat e përgjegjësitë e tij.

6. Udhëzimi Nr. 22, datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigorisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”.

Në këtë udhëzim trajtohen masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël, ose përpunuesit. Parashikohen standartet minimale

dhe bazike për sigurinë e të dhënave personale, kjo në përputhje dhe me masën e përpunimit të të dhënave.

7. Udhëzimi Nr.23, datë 20.11.2012“ “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”

Ky udhëzim parashikon rregulla të qarta të mbrojtjes së të dhënave personale që do të zbatohen për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët veprojnë në sistemin e kujdesit shëndetësor, si dhe organet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen, ose kontrollin e kujdesit shëndetësor, dhe përpunuesit e të dhënave që veprojnë në emër të tyre. Udhëzimi parashikon dispozita lidhur me afatet kohore për ruajtjen e të dhënave shëndetësore, me ruajtjen e privatësisë së pacientëve gjatë trajtimit nga stafi mjekësor dhe aksesin e palëve të treta, me përdorimin e sistemit të video-survejit, rastet kur mund të përdoret ky sistem dhe mënyrën e përdorimit në mënyrë që të mos shkelet privatësia dhe dinjiteti njerëzor, etj.

8. Udhëzimi Nr.24, datë 26.12.2012 për “Detyrimet e Kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”.

Ky udhëzim shfuqizon udhëzimin nr. 2, datë 25.02.2010 për “Detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”. Kjo, pasi synon riformulimin e detyrimeve paraprake të kontrolluesve dhe përpunuesve në përputhje me ndryshimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore të mëvonshme por dhe me përparimin e praktikës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

9. Udhëzimi Nr. 25, datë 27.12.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 06/09/2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere”.

Miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” është reflektuar dhe në ndryshimet përkatëse në Udhëzimin 25, datë 27.12.2012 me qëllim përputhjen e plotë me ligjin e miratuar. Këto ndryshime përveçse kanë synuar përshtatjen me ligjin e ndryshuar si në referencat ligjore të përmendura dhe në terminologjinë e përdorur, ka sjellë si risi edhe formën e shprehjes së pëlqimit. Pëlqim ky, i cili duhet të jetë i shprehur qartë dhe me shkrim i dhënë kundrejt kontrolluesve që ofrojnë shërbime hoteliere për çdo veprim që do të ndërmerret me të dhënat personale.

10. Udhëzimi Nr.26, datë 27.12.2012 ““Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.4, datë 16/03/2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit””.

11. Udhëzimi Nr.27, datë 27.12.2012 ““Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.7, datë 09/06/2010 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit””.

12. Udhëzimi Nr.28, datë 27.12.2012 ““Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.11, datë 08/09/2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat””.

Ky udhëzim parashikon ndryshimet në Udhëzimin nr. 11 në kuadër të trajtimit të të dhënave biometrike të punonjësve dhe përcaktimit të periudhës së mbajtjes së të dhënave të punonjësve në një sistem vëzhgimi me kamera.

13. Udhëzimi Nr.29, datë 27.12.2012 ““Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.16, datë 26/12/2011 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë””.

Me ndryshimet e fundit që pësoi ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” lindi nevoja edhe për miratimin e ndryshimeve të këtij udhëzimi. Këto amendime nuk kanë sjellë ndryshime në thelbin e përmbajtjes së dispozitave por kanë synuar përshtatjen me ligjin e ndryshuar si psh., në referencat ligjore të përmendura, terminologjinë e përdorur etj.

14. Udhëzimi Nr.30, datë 27.12.2012 ““Për një ndryshim në udhëzimin nr.19, datë 03/08/2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi””.

15. Udhëzimi Nr.31, datë 27.12.2012 “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”.

Ky udhëzim është përgatitur me mbështetjen e eksperteve të Projektit EU-IPA 2009 "Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe ajo çka është më e rëndësishme në miratimin e tij, ishte ndryshimi që pësoi neni 11 i ligjit, përmes të cilit, Komisioneri detyrohej të nxirrte udhëzim në sektorin e përpunimit të të dhënave personale për qëllime gazetarie, literature e artistike. Ky udhëzim përcakton kushtet në bazë të të cilave përpunimi i të dhënave personale mund të përjashtohet nga detyrimet që parashikohen në Nenet 5, 6, 7, 8, 18, dhe 21 të Ligjit, me qëllim balancimin e të drejtës së individëve për të mbrojtur të dhënat e tyre personale me rregullat e zbatueshme për të drejtën e lirisë së shprehjes.

16. Udhëzimi Nr.32, datë 27.12.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 9, datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”.

- Është e rëndësishme të theksohet se thuajse në të gjithë rastet p/udhëzimet janë dërguar për mendim pranë kontrolluesve që detyrohen për zbatimin e tyre dhe pasi janë marrë mendimet, janë bërë reflektimet përkatëse (sigurisht kur ka pasur opinione ligjore) dhe është vijuar me miratimin e aktit. Po ashtu për vitin 2012 ishte risi edhe krijimi i një linku të vecantë në faqen tonë zyrtare për të mundësuar dhënien e mendimeve ndaj p/akteve të përgatitura nga Komisioneri të gjithë kontrolluesit por edhe subjektet e të dhënave personale. Megjithatë mendimet kanë qenë shumë të pakta, jemi të bindur se gjithshka e re ka vështirësitë e njohura në fillim por me kalimin e kohës kthehet në preferencë dhe pozitivitet.

Në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale Komisioneri miratoi:

Vendime:

Vendim Nr. 3, datë 20.11.2012 për “Përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Ky akt është përgatitur në kuadër të zbatimit dhe implementimit të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar nëpërmjet të cilës ky detyrim i atribuohet Komisionerit. Ky vendim parashikon “Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes të së dhënave”, në të cilët kontrolluesit mund të kryejnë transferim të të dhënave pa kërkuar autorizim pranë Komisionerit.

Akti njihet kontrolluesit publikë e privatë me vendet në të cilat mund ti transferojnë (Aneksi 1) të dhënat pa bërë kërkesë për autorizim pranë Komisionerit. Vendimi përditësohet në mënyrë të vazhdueshme sa herë që shtetet ratifikojnë konventën 108, kanë të miratuar ligj për mbrojtjen e të dhënave personale, kanë të ngritur autoritete të pavarura për mbrojtjen e privatësisë së individit, etj. Përditësimet publikohen në faqen zyrtare të autoritetit tonë.

Vendimi Nr. 4, datë 27.12.2012 për “Përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale, që përpunohen”.

Ky vendim është hartuar në kuadër të zbatimit dhe implementimit të pikës 4 të nenit 21 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar. Duke qenë se ndryshimet e ligjit këtë vendimarrje ia atribuojnë Komisionerit, kjo solli si rezultat edhe përgatitjen dhe miratimin e tij. Vendimi parashikon Rastet, për të cilat njoftimi pranë Komisionerit nuk është i nevojshëm.

Vendim nr. 5, datë 27.12.2012 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 2, datë 10.3.2010 për “Përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre””.

Ky vendim synon riformulimin e detyrimeve të kontrolluesve dhe përpunuesve në përputhje me ndryshimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore të mëvonshme por dhe me zhvillimin e praktikës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

III.III Mendime ligjore.

● Dhënie mendimi për p/ aktet ligjore dhe nënligjore.

Në kuadër të përgjegjësisë të parashikuara, Komisioneri jep mendime ligjore për p/akte ligjore e nënligjore që prekin fushën e mbrojtjes së të dhënave. Në këtë drejtim eidentojmë sa vijon:

1. Dhënie mendimi për Ligjin nr. 8951, datë 10.10.2002 “Për numrin e identitetit të shtetasve”, hartuar në bashkëpunim me ekspertin e projektit EU- IPA 2009.

Në kuadër të bashkëpunimit me ekspertet e Projektit janë përgatitur amendimet e ligjit nr. 8951, datë 10.10.2002 "Për numrin e identitetit të shtetasve". Objekt i shtesave në Ligjin Nr. 8951, datë 10.10.2002 ka qënë implementimi i klauzolave ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi çdo operacion që kryhet me numrin e identitetit në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është përpunim. Propozimet janë dërguar për të ndjekur procedura të mëtejshme pranë DPGJCivile.

2. Dhënie mendimi për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi i propozimeve për disa shtesa në Kodin Penal është bazuar në aktet ndërkombëtare, më konkretisht propozimet e dhëna i referohen standartit Çek dhe atij Polak. Mendimi ka konsistuar në përfshirjen e dispozitave mbi përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale dhe masat përkatëse të dënimit, etj.

3. Dhënie mendimi për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
4. Dhënie mendimi për projektligjin Nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.

Opinionin ligjor ka konsistuar në sugjerimin për unifikimin e terminologjisë të këtij projektligji me atë të përdorur në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Është sanksionuar që mbledhja e të dhënave personale duhet të bëhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe kemi propozuar dispozita lidhur me masat e sigurisë dhe të konfidencialitetit. Opinionet ligjore janë marrë në konsideratë, evidentuar këto pas miratimit të p/ligjit.

5. Dhënie mendimi për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Në propozimet e dhëna në këtë projektligj kemi synuar të evidentojmë ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërinë nga çdo zyrtar që vihet në dijeni me të dhënat personale. Gjithashtu, është parashikuar detyrimi që çdo veprim që do të ndërmerret për të dhënat personale duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Pas miratimit të p/ligjit është konstatuar se disa prej sugjerime të dhëna janë marrë në konsideratë.

6. Dhënie mendimi për ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar, dhe Rregulloren Nr. 67, datë 13.10.2010 “Për përmbajtjen e Informacionit dhe Funksionimin e Regjistrimit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”.

Në kuadër të bashkëpunimit me ekspertet e Projektit janë përgatitur amendimet e akteve të lartpërmendura. Propozimi i amendimeve të këtyre dy ligjeve së bashku, më konkretisht ligji Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar, është parë si rezultat i transaksioneve që kryhen ndërmjet subjekteve me anë të veprimtarisë bankare, të cilat mund të çojnë në kryerjen e veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi. Fokusi i këtyre propozimeve ka qenë në përpunimin e të dhënave personale të klientëve në aktivitetin bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, mendimet e propozuara në Rregulloren Nr. 67, datë 13.10.2010 “Për përmbajtjen e Informacionit dhe Funksionimin e Regjistrimit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” synojnë parashikimet lidhur me saktësinë e informacionit i cili duhet të jetë i saktë dhe i përditësuar.

- 7.** Dhënie mendimi për projekt marrëveshjen dypalëshe me Hungarinë “Për mbrojtjen e të dhënave”.

Është dhënë opinioni ligjor, për të siguruar përshtatjen e terminologjisë së përdorur në këtë akt dhe janë parashikuar një sërë detyrimesh sa i përket fshirjes dhe korrigjimit të të dhënave, mbajtjes së informacionit në mënyrë të tillë që të identifikohen subjektet e të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Sugjerimet e dhëna për projekt marrëveshjen dypalëshe ndihmojnë në efikasitetin e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë implementimit të Marrëveshjes.

- 8.** Është dhënë mendim për Projekt Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2012-2015 dhe përcaktimin e përgjegjësisë institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të legjislacionit të Bashkimit Evropian”, të dërguar nga Ministria e Integrimit.

Komisioneri ka parashikuar përfshirjen e akteve të përditësuara dhe të miratuara rishtas prej tij dhe aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.

- 9.** Është dhënë mendim për Draft Marrëveshjen për transferimin e të dhënave personale në vendet që kanë nënshkruar Konventën “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrese dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave” dërguar nga Autoritetit i Ukrainës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është dhënë mendim për disa pika të kësaj marrëveshje.

- 10.** Është dhënë mendim mbi Projekt Vendimin e Këshillit të Ministrave për “Propozimin e Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar”, të dërguar nga Ministria e Brendshme.

Komisioneri në opinionin ligjor të dhënë parashikonte rregulla mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, mbi zbatimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Komisioneri sugjeroi që në këtë projektligj të parashikoheshin edhe dispozita mbi përdorimin e sistemit të CCTV-ve (video survejimin e përgjithshëm të hapësirave publike) edhe masa

mbrojtëse të përshtatshme për këtë lloj përpunimi, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” por edhe në zbatim të rekomandimit të dhënë nga Autoriteti i Komisionerit për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pas kryerjes së inspektimit në këtë sektor.

11. Është dhënë mendim mbi Projekt Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për krijimin, regjistrimin, përfundimin e funksionimit, administrimin, ndërveprimin, sigurinë dhe auditimin e bazave të të dhënave shtetërore”, dërguar nga MITIK.
12. Është dhënë mendim “Mbi nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për konsultimin e të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile”, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
13. Është dhënë mendim për “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi njohjen e ndërsjelltë të lejeve të drejtimit”, dërguar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Autoriteti i Komisionerit ka dhënë opinionin ligjor në kuadër të përpunimit dhe administrimit të ligjshëm të të dhënave nga shtetet palë. Gjithashtu ka synuar përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve për mbrojtjen e të dhënave personale.

14. Është dhënë mendim mbi projektvendimin “Për miratimin në parim të Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës “Mbi procedurën e komunikimit”, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
15. Është dhënë mendim për “Rregulloren për standardet e publikimit të të dhënave në formatin *open data*”.
16. Është dhënë mendim për “Rregulloren për përdorimin e postës elektronike në administratën publike”.

Opinionin ligjor i dhënë ka synuar përfshirjen e përkufizimit sa i përket të dhënave personale, riformulimin e disa dispozitave të cilat do të ndihmojnë në kuptimin e drejtë të tyre si dhe përfshirjen e detyrimit për marrjen e masave të sigurisë.

17. Është dhënë mendim mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.664, datë 4.8.2010 “Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunim policor” .
18. Është dhënë mendim për “Projekt marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Gjeorgjisë për bashkëpunim në luftën kundër krimit”, të dërguar nga Ministria e Brendshme.

Autoriteti i komisionerit është shprehur në kuadër të përmirësimit të masave të sigurisë së të dhënave dhe rregullave mbi transferimin e të dhënave personale midis autoriteteve kompetente në shtetet palë.

19. Është dhënë mendim mbi Projekt Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale”, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.

Opinionimi ligjor ka konsistuar në parashikimin e rregullave dhe parimeve mbi ruajtjen e sigurisë së të dhënave, konfidencialitetit dhe mbi transferimin e të dhënave.

20. Është dhënë mendim për Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë të Suedisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë *“Mbi shkëmbimin e informacionit për çështjet e emigracionit dhe Azilit”* dhe Protokollit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të Mbretërisë së Suedisë *“Mbi zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komitetit Evropian për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim”*, të dërguar nga Ministria e Brendshme.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në opinionin e dhënë ka synuar përafrimin e terminologjisë me atë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka përcaktuar rregulla mbi transferimin e të dhënave, sigurinë e të dhënave dhe konfidencialitetin.

21. Është dhënë mendim për projekt/udhëzimet e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, në lidhje me sigurinë e të dhënave dhe sistemin e videosurvejimit, në zbatim të Rekomandimit të dhënë nga Komisioneri.

Komisioneri në Rekomandimin e tij është shprehur për hartimin e Rregullores së Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin nga kjo drejtori. Gjithashtu, kontrolluesi është informuar se Komisioneri ka përgatitur një projekt/rregullore të përgjithshme (tip) për kontrolluesit publik dhe privat ku përfshihen mbrojtja dhe siguria e të dhënave personale e cila mund të përdoret duke e plotësuar sipas specifikave të fushës ku vepron drejtoria. Materiali përkatës i është bashkëlidhur me shkresën.

Sa i përket udhëzimit “Mbi përdorimin e kamerave vëzhguese” jemi shprehur dakort.

22. Është dhënë mendim për tre projekt/vendime të hartuara nga Ministria e Drejtësisë për zbatim të Ligjit nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Më konkretisht për projekt/vendimet, “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, “Për përcaktimin e subjekteve që kanë të drejtën e aksesit në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSREP)”, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”.

Në përgjithësi projekt/vendimet kanë rezultuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

23. Është dhënë mendim për projektligjin e dërguar nga Ministria e Financave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004, “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar.

Opinionimi ligjor ka konsistuar në shtimin e një neni në lidhje me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërisë edhe pas përfundimit të funksionit për personat/kontrolluesit që njihen me të dhënat personale gjatë përpunimit.

24. Është dhënë mendim mbi Projektligjin “Për armët” të dërguar nga Ministria e Brendshme.

25. Është dhënë mendim mbi Projektligjin “Për të huajt”, të dërguar nga Ministria e Brendshme.

Opinionimi ligjor ka konsistuar në përafrimin e terminologjisë me atë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në parashikimin e rregullave dhe parimeve mbi ruajtjen e sigurisë së të dhënave dhe konfidencialitetit.

Rrjedhimisht vihet re angazhimi i institucioneve për të dërguar p/akte për mendim pranë KMDP-së e për këtë në krahasim me një vit më parë është bërë progres. Sigurisht pas seminarit të organizuar me institucionet që kanë nismën ligjore për të draftuar akte, me qëllim ndërgjegjësimin maksimal të tyre për rëndësinë që ka dërgimi i p/akteve për mendim, si dhe pas dërgimit të një shkrese nga Sekretari i Përgjithshëm i KM, Z. Lezhja të gjithë institucioneve për të dërguar pranë KMDP-së p/akte që kanë lidhje me fushën e të dhënave personale përpara dërgimit të tyre për miratim në KM, shprehim bindjen se viti në vazhdim do të ketë tregues edhe me të lartë e si rrjedhojë ndërgjegjësimi dhe përshtatja e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale do të kthehet në domosdoshmëri.

● **Dhënie informacioni, opinione, mendime ligjore për kërkesa të kontrolluesve, të subjekteve, etj.**

1. Është kërkuar nga Ministria e Financave, mendimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të përcjellë të dhëna tatimore pranë autoriteteve tatimore të shteteve të huaja. Në këtë përgjigje është orientuar kontrolluesi që mund të dërgojë të dhëna në vende me nivel të mjaftueshëm (sikurse ka qenë rasti për në shtetin Belg) të mbrojtjes së tyre pa pasur nevojë për autorizim të Komisionerit dhe në të kundërt për transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes duhet ti drejtohet Komisionerit për autorizim me qëllim lejimin e transferimit.
2. Është trajtuar informacioni i dhënë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit lidhur me aktivitetin në vazhdim të këtij të fundit në kuadër projekti për monitorimin e vendimeve të prokurorive të rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës. Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave është verifikuar formulari i njoftimit i këtij subjekti, bashkëlidhur me korrespondencën përkatëse në Drejtorinë e Regjistrimit, janë studiuar informacionet shpesh të ardhura nga ana e kontrolluesit, si dhe dy pyetësorët së bashku standartin e kontratës. Komisioneri në këtë rast sugjeroi kontrolluesin që të përfshihen në kontratë parashikime lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit për personat që do të merreshin me plotësimet e pyetësorëve, të merreshin masat e duhura të sigurisë për të koduar të dhënat e mbledhura kur ato të përpunoheshin, megjithëse një pjesë e mirë e tyre mbledheshin si të dhëna statistikore, etj.
3. Është dhënë mendim lidhur me “Kërkesën për interpretim” me anën e së cilës Vodafone Albania kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mendim për sa i përket kohës së mbajtjes së të dhënave të detajuara të komunikimeve elektronike të pajtimtarëve në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke e trajtuar në këndvështrimin e ligjit për “Komunikimet elektronike” dhe atë të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”. Në këtë kontekst kontrolluesi është orientuar ti kushtojë vëmendje maksimale **Direktivës 2006/24 EC të Parlamentit** të Evropës dhe Këshillit, datë 15 mars 2006 “Mbi ruajtjen e të dhënave të gjeneruara apo përpunuara në lidhje me dispozitën e ofrimit publikisht të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion apo të rrjeteve të komunikimeve

elkronike dhe amendimit të **Direktivës 2002/58 EC e Parlamentit** të Evropës dhe Këshillit në datë 12 korrik 2002”, në **nenin 6** të të cilës parashikohet perioda e mbajtjes së të dhënave jo më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se 2 vjet.

4. Është dhënë mendim lidhur me kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë sa i përket mundësimit të instalimit të pajisjeve për mbledhjen e të dhënave biometrike, që EUCOM-i do ti japë hua Policisë së Shtetit, e më pas transferimin dhe vlerësimin e këtyre të dhënave në SHBA.

Duke marrë parasysh edhe veçantinë e këtij rasti, KMDP ka kërkuar informacion shtesë i cili konsistonte: në faktin nëse ekzistonte ndonjë marrëveshje bashkëpunimi (në nivel të lartë institucional), midis Policisë së Shtetit dhe EUCOM-IT (Komanda e Forcave të Armatosura Amerikane në Evropë), në të cilën të përcaktohej transferimi i të dhënave personale, të qartësohej qëllimi i transferimit, kategoria e personave që do ti merren të dhënat biometrike, masat e sigurisë që do të përdoren gjatë transferimit por edhe gjatë përpunimit të tyre/vlerësimit, ruajtja e konfidencialitetit gjatë dhe pas përpunimit/vlerësimit të të dhënave nga personat që do të kryenin këtë veprim deri edhe në shkatërrimin e këtyre të dhënave, si dhe rregulla të tjera të vlerësuara nga të dy palët.

5. Është dhënë mendim lidhur me “Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” përgatitur nga Kontrolluesi Universiteti Fan S. Noli, Korçë. Është orientuar kontrolluesi të parashikojë ruajtur konfidencialitetin kur është e nevojshme gjatë përpunimit të të dhënave, të parashikojë rregulla për rastet e transferimit apo transmetimit të të dhënave, marrjen e pëlqimit me shkrim nga subjekti i të dhënave kur është e domosdoshme, etj.
6. Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm mes institucioneve me qëllim që këto të fundit të plotësojnë detyrimin e parashikuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale për të pasur të miratuar rregulloren e posaçme të mbrojtjes së të dhënave personale përfshirë në të edhe masat e sigurisë, është përcjellë pranë Prokurorisë së Përgjithshme Projekt-Rregullore tip për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, me qëllim përpunimin e mëtejshëm dhe miratimin e saj.
7. Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me mbështetjen e projektit dhe në bashkëpunim me përfaqësues të organit të Prokurorisë së Përgjithshme kanë hartuar “Udhëzuesin Praktik për Prokurorët për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Ky udhëzues përmban rregulla për mbrojtjen e të dhënave, të cilat do të zbatohen për përpunimin e të dhënave personale tërësisht ose pjesërisht me mjete automatike, si dhe për përpunimin me mjete automatike të sistemeve të arkivimit të të dhënave personale që kryhet nga prokurorët në përmbushje të detyrave të tyre për kryerjen e hetimeve penale ose në procedurat penale në gjykatë ose nga policia gjyqësore, nën drejtimin e prokurorit përgjegjës.

8. Në kuadër të aktiviteteve që shoqërojnë procesin drejt ratifikimit të Konventës së OKB për Personat me Aftësi të Kufizuar nga Parlamenti Shqiptar, është marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që udhëheq këtë proces. Këto takime, kanë konsistuar në prezantimin e projekt aktit tek grupet e interesit dhe në paraqitjen nga ekspertë ndërkombëtar të një analize krahasuese ndërmjet projekt/ligjit të hartuar dhe Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Gjatë vitit 2011 autoriteti i Komisionerit, ka dhënë mendim mbi projekt/ligjin dhe propozimi i dhënë është marrë në konsideratë nga grupi i punës.

9. Në kuadër të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë në Londër, të paraqitur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë është dhënë informacion i përgjithshëm lidhur me ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe Autoritetin e ngritur në zbatim të ligjit. Ky informacion kërkohej në kuadër të implementimit nga Mbretëria e Bashkuar në datën 1 Nëntor 2012, të Konventës së Hagës 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjet, zbatimin dhe bashkëpunimin në respekt të përgjegjësisë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve.
10. Është dhënë mendim në hartimin e “Rregullores së brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin”, për kontrolluesin Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 1.

Në zbatim të kërkesës së bërë më parë nga kontrolluesi si dhe në zbatim të detyrimit të parashikuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale për të pasur të miratuar rregulloren e posaçme të mbrojtjes së të dhënave personale përfshirë në të edhe masat e sigurisë, është përcjellë pranë kontrolluesit, rregullorja “tip” dhe është orientuar për plotësimin dhe miratimin e aktit.

11. Është trajtuar shkresa dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank Albania. Në kuadër të ngritjes së sistemit global të performancës së punonjësve të saj është kërkuar dhënie mendimi për “Marrëveshjen për ruajtjen e konfidencialitetit dhe deklaratën e pëlqimit”. Për këtë marrëveshje është dhënë mendimi përkatës dhe gjithashtu është sugjeruar edhe shtimi i një paragrafi në kontratën që do të lidhet me punonjësit “Për përpunimin e të dhënave personale” që të përshkruhet natyra e të dhënave që do të përpunohen dhe për çfarë qëllimi do të përpunohen të dhënat. Gjithashtu, janë propozuar të shtohen nene të cilat të trajtojnë marrjen e pëlqimit për të dhënat që do të përpunohen dhe sigurimin që secili prej punonjësve të saj, sipërmarrësve dhe nënkontraktorëve të jenë njohur me përgjegjësitë e tyre në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe detyrimeve në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.
12. Është dhënë përgjigje për “Memorandumin e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm”, drejtuar Ministrisë së Brendshme.
13. Është trajtuar kërkesa e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar. Kërkesa synonte në mbledhjen e një informacioni të detajuar mbi legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim nënshkrimin e një marrëveshje mirëkuptimi bilateral ndërmjet Ambasadës Britanike, Agjencisë Kufitare, Agjencisë së organizatave të krimeve të rënda dhe Ministrisë së Brendshme. Informacioni i dhënë konsistonte në; paraqitjen e një panorame të autoritetit të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, procedurat që ndiqen gjatë paraqitjes së një ankese si dhe pasqyrimin e marrëdhënies ndërmjet kontrolluesve dhe autoritetit të Komisionerit.
14. Është dhënë opinion ligjor ndaj kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në përputhje me Udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 për “Përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.

Komisioneri ka interpretuar zbatimin e udhëzimit nr. 15 në rastin e afishimit të listës së gjykimeve civile (në ambientet e gjykatës). Komisioneri në opinionin e dhënë ka vlerësuar se:

- Publikimi i shërben zhvillimit normal të procedurave gjyqësore. Publikimi i të dhënave personale si emri dhe mbiemri i palëve apo personave të tretë nuk përbën rrezik serioz për shkeljen e parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale, duke patur parasysh se ato (të dhënat) mund të aksesohen në ambientet e gjykatës për një periudhë kohore të kufizuar;
- Është i rëndësishëm informimi paraprak dhe marrja e pëlqimit të palëve dhe personave të tretë, mbi publikimin e të dhënave të tyre në ambientet e gjykatës që ka në gjykim çështjen konkrete; Mënyra e informimit dhe marrjes së pëlqimit mbetet në vlerësimin e gjykatës;
- Në rastin kur palë në gjykim ose person i tretë është një minoren, atëherë publikimi i emrit dhe mbiemrit të tij do të bëhet me initiale;
- Gjatë gjithë procesit gjyqësor duhet të respektohen parimet dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave, parashikuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Udhëzimin nr. 15 dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga Komisioneri.

- 15.** Është trajtuar kërkesa e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Kërkesa konsistonte në interpretimin zyrtar të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për të dhënat personale”, lidhur me kërkesat që janë paraqitur pranë këtij Institucioni nga subjekte të ndryshme mbi përpunimin e të dhënave sensitive që merren gjatë dhurimit të gjakut. Është synuar që opinioni të qartësojë kontrolluesin në dhënien e informacionit vetëm subjekteve që i përkasin të dhënat apo përfaqësuesve të tyre ligjore si dhe përpunimi i të dhënave sensitive të kryhet me pëlqimin e subjekteve të të dhënave.
- 16.** Në kuadër të implementimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe detyrimit ligjor të parashikuar në ligj, KMDP ka përgatitur dhe dërguar disa propozime në “Kodin e etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat”, akt i miratuar nga MASH.

Dërgimi i këtij opinioni do të përbënte dhe përmbushjen e detyrimit ligjor të parashikuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit që Autoritet Tona kanë nënshkruar në datën 24.01.2011. Me propozimet e dërguara, është parashikuar të përfshihet parimi i përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, mbi bazën e të cilit përcaktohet se përpunimi i të dhënave nga ana e mësuesve dhe personelit drejtues të bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Gjithashtu është parashikuar që, specialistët e shërbimit psikologjik në ciklin shkollor detyrohen që gjatë ushtrimit të detyrës së tyre të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Së fundi, është parashikuar detyrimi i fshirjes/anomatizmit të të dhënave ose marrjen e pëlqimit të nxënësve në rast të publikimit të anketave të ndryshme që zhvillohen në mjediset arsimore.

- 17.** Është trajtuar kërkesa për bashkëpunim dërguar nga Qendra Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QK-CSA) dhe Komisioneri ka shprehur dakortësinë në lidhje me realizimin e këtij bashkëpunimi. Kërkesa e bashkëpunimit ka konsistuar në dërgimin e ndërsjellë të projekt/akteve me qëllim kontribuimin në dhënien e mendimeve për to.

18. Është marrë pjesë në takimin e organizuar nga Biznes Albania, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësi dhe nga Policia e Shtetit mbi diskutimin e projektligjit për “Veprimtarinë e Shërbimit të Ruajtjes dhe të Sigurisë Fizike”. Qëllimi i takimit ishte diskutimi dhe prezantimi i projektligjit i përgatitur nga Policia e Shtetit. Në këtë takim gjithashtu ishin prezent dhe përfaqësues të kompanive të ruajtjes dhe sigurisë fizike, të cilët paraqitën propozimet e tyre. Propozimet e paraqitura do të shqyrtoheshin me tej nga Policia e Shtetit.
19. Është dhënë mendim mbi Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të hartuar nga shoqëria “Zyra Përmbartimore Zig” sh.p.k. Lidhur me draftin e rregullores, Komisioneri ka propozuar që të shtohet një dispozitë në të cilën të përcaktohen llojet (kategoritë) e të dhënave personale që përpunon shoqëria ZIG.
20. Është dhënë konsulencë ligjore Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, Shkodër për hartimin e Rregullores së brendshme për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
21. Është dhënë konsulencë ligjore për Bankën Emporiki- Sh.A lidhur me implementimin e një sistemi të ri të telefonisë për regjistrimin e telefonatave të stafit të bankës me të tretë. Kontrolluesi në fjalë është orientuar mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për të realizuar njoftimin përkatës përpara se të fillojë implementimi i këtij sistemi. Sa i përket pyetjes lidhur mbi kohën e ruajtjes së dokumentacionit të të dhënave, është informuar se afati duhet të jetë në zbatim të nenit 27 pika 4 të ligjit nr.48/2012 datë 26.04.2012.
22. Është dhënë asistencë ligjore subjekteve edhe me anë të e-maileve (siç edhe është kërkuar nga këta të fundit) lidhur me dhënien e pëlqimit në rastet kur transmetohen të dhëna personale për qëllime shkencore dhe statistikore. Subjektet janë informuar se për të dhënat personale që mund të jetë mbledhur më parë nga kontrolluesi (marrësi i të dhënave) për çfarëdo qëllimi mund ti përpunojë më tej për qëllime shkencore dhe statistikore për të përmbushur një detyrim ligjor. Në këtë rast marrja e pëlqimit nuk është e nevojshme pasi për përpunimin për qëllime shkencore ose statistikore është sqaruar se të dhënat e mbledhura anonimizohen duke fshirë çdo të dhënë personale, duke mos lejuar identifikimin e personit në asnjë rast. Gjithashtu, në raste studimore psh, përpara mbledhjes së të dhënave, duhet të jepet një informacion për pjesëmarrësit ku detajohet natyra dhe qëllimi i studimit, identiteti i studiuesit dhe çfarë do të ndodhë me të dhënat e mbledhura.
23. Është dhënë mendim mbi informacionin e dërguar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me faktin e mos ofrimit të informacionit që ky i fundit i ka kërkuar operatorit telefonik AMC. Në përgjigje, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i është bërë me dije që në referim të ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe më konkretisht në nenin 5 të këtij Ligji, në kërkesën e parashtruar operatorit telefonik AMC, është shumë e domosdoshme të përcaktohet qartë qëllimi i marrjes së të dhënave. Gjithashtu i është kërkuar të përcaktojë në kërkesë dhe masat konkrete të sigurisë që do të ndërmerren për sigurinë e të dhënave. Në këtë mënyrë edhe operatori telefonik AMC (apo ndonjë kontrollues tjetër sipas rastit) sigurohet se të dhënat e kërkuara do të mbahen të sigurt dhe nën detyrimin e konfidencialitetit.
24. Është dërguar pranë Ministrisë së Integritetit evidentimi i fushave në të cilat kërkohet asistencë e TAIEX lidhur me përfitimin e workshopeve, vizitave studimore dhe misionëve të ekspertëve.

25. Janë studiuar aktet e miratuara gjatë vitit 2012 në Fletoret Zyrtare (punë kjo e kryer rregullisht për të bërë të mundur evidentimin e miratimit të akteve të reja apo ndryshimeve që mund të kenë pësuar aktet ligjore ose nënligjore) me qëllim përputhshmërinë e tyre me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe janë përgatitur memo javore.

III.IV Dhënie informacioni dhe raporte periodike.

- ~ Është ndjekur rregullisht detyrimi institucional për të dërguar “*Raportet periodike mujore mbi veprimtarinë e KMDP-së*”, drejtuar Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura pranë Kuvendit të Shqipërisë.
- ~ Është përgatitur raport lidhur me aplikimin e parimeve të Konventës 108 në lidhje me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave biometrike, i kërkuar nga Komiteti Konsultativ i Konventës 108 (T-PD) për shkak të pjesëmarrjes dhe diskutimeve që zhvillohen në këtë komitet e në të cilin Komisioneri merr pjesë me të drejtë vote.

Me anë të këtij raporti kërkohej informacion i detajuar mbi të dhënat biometrike dhe sistemet biometrie në legjislacionin kombëtar, problemet apo vështirësitë që ka sektori publik dhe privat në lidhje me biometrinë apo me legjislacionin përkatës dhe nëse ka një bazë të dhënash qendrore të të dhënave biometrike. Përsa i përket legjislacionit për biometrinë vendi ynë ende nuk ka të miratuar një ligj specifik mbi të dhënat biometrike. Për përgatitjen e këtij raporti ka kontribuar edhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi në bazë të “Kontratës konçesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve” me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, ky institucion është përgjegjës për mbajtjen dhe lëshimin e këtyre dokumentave. Gjithashtu, kontribut në hartimin e këtij raporti ka dhënë dhe Policia e Shtetit, lidhur me informacionin që dispononte për sistemin TIMS.

- ~ Është bërë raportim periodik pranë Komitetit Konsultativ të Konventës nr. 108, datë 28.01.1981 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (T-PD).
- ~ Në kuadër të takimit të 3-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri (datë 20 mars 2012), mbi bazën e kërkesës së Ministrisë së Integrimit, është dhënë informacion mbi fushat që mbulon institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (për periudhën Mars 2011-Janar 2012) si dhe janë konfirmuar përfaqësuesit e KMDP-së në këtë takim.
- ~ Është dhënë informacion mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të përgatitjes së Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së (periudha 2012-2015) për Kriterin Politik dhe Kapitullin 23 “Bashkëpunimi në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore”.
- ~ Është përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Brendshme, raportimi për veprimtarinë e KMDP-së gjatë periudhës Mars-Prill 2012, në kuadër të Planit të Veprimit për Rekomandimin 9 – “Lufta kundër krimit të organizuar”.

Në këtë kuadër dy ishin detyrimet e Autoritetit të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat u përmbyllën me sukses:

- Udhëzimi Nr. 17, datë 11.05.2012 mbi "Përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e policisë së shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale", i miratuar nga Komisioneri.
Për përgatitjen e këtij akti Komisioneri bashkëpunoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ekspertët e huaj të Projektit EU-IPA 2009 "Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Nënshkrimi i "Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme". Bashkëpunimi konsiston në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, në parandalimin dhe shmangien e rasteve të shkeljeve të ligjit, etj.
- ~ Është dërguar në Ministrinë e Drejtësisë, "Informacioni mbi veprimtarinë e Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (periudha Maj 2012- 20 Gusht 2012) në kuadër të paraqitjes së kontributit të dytë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Raportin e Progresit 2012".
- ~ Është përgatitur e dërguar Raporti mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën Shtator-Nëntor 2012, në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2012-2015), për Kriterin Politik dhe Kapitullin 23 "Bashkëpunimi në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore".
 - Në këtë kuadër është raportuar mbi aktet e miratuara nga Komisioneri, aktet e parashikuara për tu miratuar në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, bashkëpunimet me institucionet e tjera, raportimet e kryera, aktivitetet në kuadër të sensibilizimit, regjistrimi i kontrolluesve publikë e privatë, trajtimi i ankesave dhe inspektimet dhe aktivitetet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

III.V Transferimi ndërkombëtar dhe hartimi i Manualit.

Një nga kompetencat më të rëndësishme të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dhënia e autorizimit për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në vendet pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo është parashikuar në shkronjën c) të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Në fushën e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale në vendet e treta, vështirësitë e para janë hasur në drejtim të hartimit dhe plotësimit të kuadrit ligjor të përafëruar me Direktivën 95/46, të përgatitjes së dokumentacionit ndihmës për zbatimin e akteve ligjore, trajnimin e stafit i cili do trajtonte rastet konkrete të kërkesave të kontrolluesve, ndërveprimi i veprimtarisë së drejtorive brenda KMDP-së dhe ndërgjegjësimi i kontrolluesve mbi detyrimet e tyre në rastet e transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale që përpunonin, në kuadër të rritjes së numrit të kërkesave për transferim ndërkombëtar.

Këto vështirësi kanë ardhur duke u zbehur në raport të drejtë me plotësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Projektin EU-IPA 2009 “Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Miratimi i formularit të njoftimit nisi të evidentonte kontrolluesit që kryenin transferime ndërkombëtare të cilët nisen bashkëpunimin me KMDP për të kërkuar autorizim mbi lejimin e transferimeve.

Po ashtu KMDP hartoi e miratoi Formularin për plotësimin e të dhënave mbi kërkesën për autorizim të transferimit ndërkombëtar të të dhënave.

Ekspertët e ardhur nga projekti kanë ofruar eksperiencat më të mira të autoriteteve të vendeve të tyre duke ndihmuar kështu në një kuptim më të gjerë trajtimin e procesit të transferimit. Në këtë kuadër kemi bashkëpunuar me ekspert për hartimin e “**Manualit për Vlerësimin e Kërkesave për Miratimin e Transferimit të të Dhënave në Shtete të Huaja**” i cili ishte mjaft i nevojshëm për trajtimin sa më profesional dhe të plotë të kërkesave nga ana e punonjësve përgjegjës të KMDP-së.

Duhet të pranojmë se është punuar intensivisht në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor, i cili aktualisht rezulton si më poshtë:

- ~ Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (nenet 8, 9, c) 31/1 dhe a) 39/1);
- ~ Vendimi **nr. 3**, datë 20.11.2012 për “Përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” dhe Aneksi 1 i tij, i cili parashikon shtetet me nivel të mjaftueshëm sipas kategorive të përcaktuara në Vendim;
- ~ Udhëzimi **nr. 1**, datë 19.02.2010 për “Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Sot KMDP mbart një set të plotë të akteve që rregullojnë këtë detyrim të kontrolluesit. Duke qenë detyrim tepër specifik dhe i lidhur ngushtësisht edhe me akte të miratuara në KiE ekspertët kanë preferuar që të zhvillojnë seminare në drejtim të rolit që duhet të ndjekë KMDP në rast të depozitimit të kërkesës për transferim nga kontrolluesi por edhe mbi ecurinë dhe zhvillimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar apo edhe të praktikave me të mira për këtë rast në Evropë.

Evidentojmë faktin se këtë vit kemi patur një numër të pakët të kërkesave për transferim ndërkombëtar. Kjo ka ndodhur për disa arsye të renditura më poshtë:

- ~ Pjesa më e madhe e kontrolluesve kanë deklaruar që i transferojnë të dhënat në vendet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe në këtë kuadër nuk nevojitet autorizimi;
- ~ Një pjesë e kontrolluesve kanë plotësuar kushtet ligjore që i përjashtojnë nga autorizimi, të parashikuara në pikën 2 të nenit 8 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ~ Një numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë njoftuar kanë qenë institucione shtetërore të cilat ose nuk kryenin transferim ndërkombëtar të dhënash ose kryenin në zbatim të nenit 8/2 duke e pasur detyrim ligjor për përmbushje të detyrës së tyre edhe transferimin.

Gjatë këtij viti janë trajtuar kërkesat si më poshtë:

1. Është trajtuar kërkesa për transferim ndërkombëtar i të dhënave personale e paraqitur nga kontrolluesi **NOVO NORDISK Albania** (Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri) për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale drejt Indisë. Autoritetit i Komisionerit me Vendimin nr.02, datë 13.07.2012, “Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale”, ka autorizuar kontrolluesin **NOVO NORDISK Albania** (Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri), të

transferojë të dhënat personale në marrësin **Satyam Computer Services Limited** në shtetin e Indisë, duke parashikuar edhe disa kufizime.

2. Është trajtuar kërkesa për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale e paraqitur nga kontrolluesi **Procter & Gamble Albania Sh.p.k** (Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri) për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale drejt **SuccessFactors Australia Pty Ltd** dhe **SuccessFactors Inc, USA**. Komisioneri në këtë rast ka dërguar një përgjigje zyrtare, në të cilën janë paraqitur të gjitha paqartësitë në kërkesën e paraqitur dhe dokumentacionin shoqërues, dhe janë përcaktuar detyrimet konkrete për kontrolluesin, me qëllim që Komisioneri të krijonte bindjen për dhënien ose jo të autorizimit. Aktualisht praktika do të trajtohet nga DHI.

III.VI Bashkëpunimi me kontrolluesit e Republikës së Shqipërisë dhe me Autoritete Ndërkombëtare.

- Në datën 18 Maj 2012, në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Kjo marrëveshje do të kontribuojë në bashkëpunimin reciprok duke hedhur bazat për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e drejtësisë, për të respektuar parimet e privatësisë të vendosura nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe për të bashkëpunuar me Autoritetin e Komisionerit për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore që do të harmonizojnë ligjet organike të fushës me parimet e mbrojtjes së privatësisë dhe të përpunimit të të dhënave personale.



Kjo marrëveshje ka si qëllim të sigurojë përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit në gjyq nga ana e prokurorëve përmes shkëmbimit të praktikave, opinioneve, etj me KMDP si dhe parashikon ndërmarrjen e organizimeve për trajnim të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Nga ana e tij, Autoriteti i Komisionerit angazhohet t'i ofrojë asistencë Prokurorisë për hartimin e Rregullores së Brendshme "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe për akte të tjera nënligjore, veprim të cilin tashmë e ka kryer. Gjithashtu, palët angazhohen për komunikim të vazhdueshëm nëpërmjet personave të ngarkuar për këtë qëllim në mënyrë të ndërsjellë.

- Në datën 11 Korrik 2012, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Znj. Flora Çabej (Pogaçe) dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Znj. Irma Baraku.

Znj. Çabej, pasi falenderoi mediat prezente në këtë ceremoni, theksoi rëndësinë e të dy fushave që kanë në fokusin e tyre mbrojtjen e të drejtave të individit, ndërsa Znj. Baraku gjatë fjalës së saj u shpreh për rëndësinë që ka mbrojtja e të Dhënave Personale gjatë aktivitetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi pasi në shumë raste ka përpunim të dhënash sensitive.

Palët u shprehën që do të bashkëpunojnë me qëllim zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", dhe Ligjit Nr.10221, datë 4.2.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të të dy palëve.



Kjo marrëveshje do të kontribuojë gjithashtu në bashkëpunimin reciprok duke hedhur bazat për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale duke u alternuar me një të drejtë tjetër themelore të njeriut siç është ajo e mbrojtjes nga diskriminimi. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në kuadrin e grupit të punës për hartimin e akteve administrative dhe ligjore dhe për zbatimin e tyre, të marrin pjesë në grupet e punës për hartimin e udhëzimeve apo rekomandimeve të posaçme të palëve, për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbrojtjes nga diskriminimi, të kërkojnë informacione për shkëmbim eksperience të veprimtarisë së palës tjetër, si dhe të bashkëpunojnë për sa i përket organizimit të seminareve, trajnimeve për kategori të veçanta subjektsh.

Bashkëpunimi ndërkombëtar.

- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Kosovës nënshkroi në datë 26.09.2012 një Marrëveshje Bashkëpunimi me autoritetin tonë shqiptar, atë të Bullgarisë dhe të Malit të Zi. Kjo marrëveshje shumëpalëshe në themel të saj, ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve në rajon gjatë përpunimit të të dhënave të tyre personale.




Mbikëqyrësi kryesor i Autoritetit Kosovar Z.Ruzhdi Jashari pas ceremonisë së nënshkrimit të kësaj marrëveshje me homologët e tij u shpreh se, nënshkrimi i këtij dokumenti është në funksion të zhvillimit të legjislacioneve në këtë fushë tepër sensitive për individin por edhe të marrjes së masave të rëndësishme mbi zhvillimet e teknologjisë së informacionit e pa anashkaluar këmbimin në vazhdimësi të praktikave më të mira të vendeve nënshkruese në funksion të qytetarëve të rajonit.

Në këtë event të rëndësishëm mbajtën fjalën e tyre Znj. Flora Çabej Komisionere për Mbrojtjen e të dhënave personale në Autoritetin shqiptar, Kryetari i Këshillit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Malit të Zi, Z.Shefko Crnovrshanin si dhe Presidentja e Komisionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Bullgarisë Znj.Veneta Shopova.

Në fjalën e saj Znj.Çabej por edhe homologët e tjerë theksuan faktin se nënshkrimi i memorandumit është i një rëndësie të veçantë dhe që sigurisht që është në interesin e të gjithë qytetarëve. Znj.Çabej përgëzoi nismën e Autoritetit kosovar për nënshkrimin dhe organizimin e këtij eventi si shteti më i ri në rajon e që për hir të vërtetës po merr përmasa nga dita në ditë duke ngjallur vëmendjen e vendeve të tjera për të bashkëpunuar reciprokisht në shumë fusha siç është edhe mbrojtja e privatësisë.

Evenimenti u pasua nga një takim i rëndësishëm me Komisionin e Sigurisë në Kuvendin e Kosovës tek i cili autoriteti Kosovar edhe raporton mbi punën e tij e po ashtu u pasua edhe nga tryeza diskutimesh mes të gjithë përfaqësuesve të delegacioneve dhe diskutimeve mjaft frytdhënëse me medien e RTKosovës. Vizita dy ditore u shoqërua edhe me vizita në monumente kulture, etj dhe që sigurisht jo vetëm ka lënë e do të lërë gjurmë për rëndësinë që përcolli por edhe për faktin se tanimë do të ketë zhvillime të rëndësishme mes këtyre vendeve nënshkruese duke u konsoliduar e shkuar më tej në ndërmarrjen e nismës për krijimin e një forumi më të gjerë mes shumë vendeve në këtë drejtim duke e fuqizuar maksimalisht këtë fushë në shumë drejtime, por kryesisht në krijimin e standarteve të unifikuara.

- Më datë 27.07.2012 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe autoritetit homolog të Ukrainës. Ky bashkëpunim nënkupton realizimin e mundësive të shumta për sa i përket shkëmbimit të informacionit mbi legjislacionin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, shkëmbimi i përvojës në përmirësimin e sistemit ekzistues të mbrojtjes së të dhënave personale në të dy vendet si dhe aktivitete të tjera të përbashkëta që kanë vendosur palët.



- Me dëshirën e mirë dhe të përbashkët për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë me datë 26 Dhjetor 2012 nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi mes tyre. Në emër të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale marrëveshja u nënshkrua nga Znj. Flora Çabej (Pogaçe) Komisionere, ndërsa për Dhomën Kombëtare të Noterisë nënshkroi Znj. Mimoza Sadushaj, Presidente e Dhomës.



Palët me anë të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi kanë për qëllim të vendosin një bashkëpunim të ndërsjellët e të frytshëm ndërmjet tyre në zbatim të legjislacioneve respektive si dhe përcaktimin e standardeve ndërkombëtare që lidhen me respektimin dhe garantimin e ruajtjes së jetës private.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj marrëveshjeje palët angazhohen që të bashkëpunojnë në drejtime të tilla si:

- të shkëmbejnë në mënyre reciproke akte, literaturë juridike, materiale të ndryshme që kanë të bëjnë me ligje të reja, rregullore e udhëzime të kësaj fushe;
- të organizojnë shkëmbime profesionale nëpërmjet formimit tekniko–juridik e profesional, për të realizuar një mbrojtje sa me efikase të të dhënave personale, ku noteret janë njëkohësisht subjekt, kontrollues dhe përpunues i këtyre të dhënave;
- të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve, që burojnë nga legjislacioni në fuqi në vendin tonë dhe ligjet përkatëse;

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të vazhdojë edhe në të ardhmen bashkëpunimin me institucione të tjera në kuadër të një zbatimi sa më të efektshëm të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Në kuadër të ndryshimeve legjislative që kanë ndodhur në vendin tonë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, janë kërkuar të bëhen ndryshimet përkatëse në faqen zyrtare të Këshillit të Evropës me qëllim përditësimin e informacionit për Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave. Ndryshimet konsistojnë në plotësimin e rubrikve lidhur me procedurat e regjistrimit e të njoftimit të të dhënave personale si dhe mbi procedurën e autorizimit të veçantë mbi transferimin e të dhënave personale në shtete që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, pranë Këshillit të Evropës është dërguar dhe ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Me qëllim prezantimin në arenën ndërkombëtare të ndryshimeve ligjore që ka pësuar ligji 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale në bashkëpunim me Projektin IPA 2009 kanë përgatitur një artikull për tu botuar në revistën “Privacy Laws & Business”. Në këtë artikull “Dialogu Qeveri – Donatorë”, Buletini 2012 (Botimi nr.62) u bë një panoramë e aktivitetit të Komisionerit dhe u prezantuan amendimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Është marrë pjesë në dy takimet e mbledhjeve plenare të Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (T-PD), të Këshillit të Evropës, të organizuara në datat 19-22 Qershor dhe 27-30 Nëntor 2012, në Strasburg. Në këto mbledhje si anëtar me të drejtë vote, mori pjesë Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Znj. Flora ÇABEJ (POGAÇE). Në fokus të këtyre takimeve ka qenë modernizimi i Konventës 108 të vitit 1981 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”, nga Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale të cilat kanë ratifikuar këtë konventë është diskutuar nen për nen propozimet e reja të dërguara. Në takimin e muajit nëntor, pas diskutimeve të shumta u miratuan në parim propozimet mbi modernizimin e Konventës 108. Miratimi i këtyre propozimeve lejon procedurën e kalimit për miratim pranë Komitetit të Ministrave. T-PD do t’i propozonte Komitetit të Ministrave që t’ia besonte finalizimin e propozimeve një komiteti "ad hoc". Gjithashtu gjatë takimeve janë prezantuar zhvillimet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të dhënave në vendet anëtare.

Më herët, gjatë vitit 2011, autoriteti i Komisionerit ka paraqitur disa propozime për tu përfshirë në ndryshimet e Konventës 108. Këto propozime kanë konsistuar në shtimin e disa definicioneve, përfshirjen e një dispozite mbi “Mbrotjen e të dhënave personale të personave të vdekur”, vendosjen në konventë të një dispozite sa i përket balancimit të të drejtës së informimit dhe të drejtës për privatësi, gjithashtu është propozuar që Konventa të lejojë ende aplikimin e përpunimit joautomatik (manual) si për sektorin publik dhe atë privat; etj.

Gjatë diskutimeve të bëra përgjatë vitit 2012, konkretisht në të dy takimet e organizuara nga T-PD, propozimet e dërguara nga autoriteti i Komisionerit janë diskutuar dhe disa prej tyre janë marrë në konsideratë. Shkurtimisht, po përmenden disa nga propozimet që janë marrë në konsideratë: riformulimi i termit “kontrollues”; shtimi i dy definicioneve “Përpunues” dhe “Marrës”; parimi i legjitimitetit është përfshirë më qartazi në nenet që i përkasin përpunimit të të dhënave; sanksionimin se Konventa nuk do të zbatohet për përpunimin e të dhënave të kryera nga një person fizik për ushtrimin e veprimtarive thjesht personale apo të aktiviteteve familjare; është marrë në konsideratë propozimi sa i përket aplikimit të përpunimit joautomatik (manual); gjithashtu është parashikuar e drejta e aksesit për informacionet që i jepen subjektit të të dhënave në lidhje me kategorinë e të dhënave që i përpunohen si dhe për burimin e marrjes të dhënave; etj.

- Komisioneri për Mbrotjen e të Dhënave Personale Znj. Flora Çabej (Pogaçe) ka marrë pjesë në Konferencën e Pranverës të Autoriteteve Evropiane të Mbrotjes së të Dhënave, që u mbajt në Luksemburg në datat 3 dhe 4 Maj 2012. Në Konferencë ishin të pranishëm përfaqësues nga të gjitha Autoritetet e Mbrotjes së të Dhënave në shtetet anëtare në Bashkimin Evropian dhe përfaqësues të shumë shteteve jo anëtare. Konferenca Evropiane krijoi mundësinë për të diskutuar mbi modernizimin e kuadrit ligjor të BE-së dhe ndikimin e tij në rritjen e mbrotjes efikase të të dhënave personale dhe privatësisë së qytetarëve në moshën dixhitale dhe një botë të globalizuar, dhe masat që duhet të merren për të përgatitur këto ndryshime. Në të u diskutua gjithashtu, paketa e fundit legjislative e Komisionit Evropian që synon modernizimin e rregullave të BE-së për mbrotjen e të dhënave si **dhe u mbajt një fjale ne këtë kuadër nga znj, Viviane Reding**. U theksua rëndësia e punës së bërë nga Grupi i Punës për Policinë dhe Drejtësinë dhe rezultatet e arritura. Autoritetet e Mbrotjes së të Dhënave shprehën gatishmërinë për të kontribuar në mënyrë aktive në suksesin e një kuadri modern dhe efektiv të mbrotjes së të dhënave për Evropën. Konferenca gjithashtu inkurajoi edhe Këshillin e Evropës për të kryer rishikimin ambicioz të Konventës nr. 108 dhe Parlamentin Evropian dhe Këshillin për të ruajtur progresin aktual në procesin legjislativ. Konferenca pati si konkluzion të saj, Rezolutën për reformën në mbrotjen e të dhënave në Evropë.
- Që prej vitit 2010 për Ministrinë e Drejtësisë janë dhënë informacione të vazhdueshme lidhur me zhvillimin e veprimtarisë së punës sonë në kuadër të veprimtarisë së EUROJUST pasi Ministria e Drejtësisë merrte pjesë në takimet me EUROJUST dhe referonte edhe për institucionin e KMDP-së.

Në mënyre graduale erdhi edhe bashkëpunimi i frytshëm midis Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe KMDP-së. Kjo arritje u iniciua nga projekti IPA -2009 që asistoi KMDP dhe projekti i Binjakëzimit “Mbështetje ndaj Strukturave të Hetimit kundër

Pastrimit të Parave dhe Krimeve Financiare” që asiston organin e Prokurorisë. Në këtë kuadër u zhvilluan një sërë takimesh të përbashkëta të cilat u finalizuan me një Vizitë Studimore në agjencinë e BE-së Eurojust, në Hagë (Hollandë) në datat 25-26 Qershor 2012.

Në këtë Vizitë Studimore morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria, Policia e Shtetit dhe nga Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte njohja me strukturat organizative, funksionale dhe veprimtarinë e Eurojust, si dhe forcimi i bashkëpunimit me të. Në takimet e zhvilluara u theksua rëndësia e bashkëpunimit duke vendosur kontakte të drejtpërdrejta midis Eurojust dhe Institucioneve pjesëmarrëse, dhe u diskutua mbi mundësinë e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi me Eurojust.

Përfaqësuesit e KMDP-së patën mundësinë të referojnë në EUROJUST mbi rëndësinë e autoritetit tonë, zhvillimet e rëndësishme të ligjit, pavarësinë e autoritetit, hapat progresive të tij, bashkëpunimin me projektin, etj.

Po ashtu EUROJUST u informua qartësisht mbi zhvillimet e kuadrit ligjor në sistemin e drejtësisë e me konkretisht në drejtim të hartimit e miratimit të Udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 për “Përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” apo edhe Udhëzimit nr. 17 datë 11.05.2012 mbi “Përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e policisë së shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale”, etj.

Interesimi i EUROJUST për të bërë të mundur sa me parë nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis tyre dhe organeve tona thuajse është drejt finalizimit falë angazhimit maksimal të KMDP-së në punën pozitive të bërë e të treguar në mbrojtje të privatësisë.

Tanimë për EUROJUST është caktuar edhe personi i kontaktit me KMDP-së, i cili informon mbi ecurinë e punës së përbashkët dhe bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Ministrinë e Drejtësisë.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Tetor 2012, mori pjesë në Konferencën Rajonale Ballkanike të Komisionerëve të vendeve të rajonit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, organizuar nga Komisioneri i Malit të Zi në qytetin e Budvës. Tema kryesore e axhendës së Konferencës Ballkanike ishte **“Qasja në Informata dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale”**. Kjo Konferencë Ballkanike synonte shkëmbimin e eksperiencës rajonale në fushën e të drejtës për qasjen në informata (**te drejten e informimit**) dhe të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në këtë fushë dhe bashkimi i këtyre të drejtave në një autoritet të vetëm. Në lidhje me këtë temë, mbajtën prezantimet e tyre përfaqësuesit e Komisionerëve të Kroacisë, Bosnjë Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë duke shkëmbyer me njëri-tjetrin eksperiencat kombëtare. Prezantimi i mbajtur nga Komisioneri Shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kishte të bënte konkretisht mbi gjetjen e balancës së duhur midis së drejtës për informim dhe së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në epokën e re dixhitale. Në vëmendje të autoriteteve homologe u soll eksperiencia e Autoritetit Shqiptar në lidhje me gjetjen e kësaj balance delikate

e pasqyruar kjo me shembuj të zbatimit të ligjit shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky aktivitet u përshëndet edhe nga përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Malin e Zi.

- Autoriteti i Komisionerit mori pjesë në muajin nëntor në Konferencën e 6-të të Shoqatës së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të vendeve Frankofone, antare e se skiles është dhe autoriteti yne, e cila u organizua në Monako. Konferenca në çeljen e saj u përshëndet nga Princi i Monakos Alberti i II-të, i cili theksoi rëndësinë e madhe që ka mbrojtja e të dhënave personale në Principatën e Monakos që kur vendi ka miratuar në 2008-tën Ligjin e ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe rëndësinë e shkëmbimit të eksperiencave, përballimin e sfidave dhe vështirësive në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në hapësirën frankofone. Princi Albert i II-të, ishte i shoqëruar në këtë konferencë edhe nga Ministri i Shtetit të Monakos Z. Michel Roger. Gjatë kësaj periudhe, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka përfaqësuar autoritetin në disa konferenca vjetore të shoqatës dhe ka marrë pjesë në kurse trajnuese në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë Konferencës u paraqitën një sërë tematikash të mprehta të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale të cilat ndeshen në veprimtarinë e autoriteteve frankofone të mbrojtjes së të dhënave.

Më parë në muajin Tetor, në kuadër të Bashkëpunimit frankofon, Autoriteti shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me kërkesë të Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale u përfaqësua në Konferencën e shoqatës se Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të vendeve Frankofone (AOMF) mbi të drejtat e fëmijëve e cila u mbajt në Tiranë më 23 dhe 24 Tetor 2012. Në këtë Konferencë, KMDP-ja, prezantoi punimet e Shoqatës Frankofone si dhe të Autoritetit Shqiptar në lidhje me masat që janë marrë për mbrojtjen e jetës private të fëmijëve gjatë përdorimit të Internetit. Konferenca e shoqatës se Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të vendeve Frankofone (AOMF) mbi të drejtat e fëmijëve u përshëndet edhe nga Kryeministri i Shqipërisë i cili vuri dhe një herë theksin mbi nevojën e domosdoshme për të ngritur në prioritet absolut mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

- Drejtoria e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Maqedoni në bashkëpunim me projektin TAIEX organizuan në datat 17 dhe 18 Dhjetor Workshopin me temë “Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave të Rajonit të Ballkanit, Aspiratat e përbashkëta dhe bashkëpunimi reciprok (i ndërsjellë) në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”. Pjesëmarrës në këtë event ishin Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE-së, KiE, Eurojust, Autoriteti ynë, autoritetet homologe të Kosovës, Sllovenisë, Çekisë, Malit të Zi, Kroacisë, Bosnje Hercegovinës, si dhe nga autoritetet respektive të Avokatit të Popullit në këto vende.

Ndërthurja e pjesëmarrësve në këtë organizim mes autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe atyre të Avokatit të Popullit ishte mjaft rezultative në referime, shkëmbime eksperiencash, diskutime, bashkëpunime për të ardhmen, kryesisht për balancën mes dy të drejtave themelore, asaj për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së privatësisë. Edhe në këtë event Komisioneri Shqipëtar referoi punën disa vjeçare të autoritetit, veprimtaritë progresive, bashkëpunimet dhe pritshmëritë e tyre, etj.

III.VII Botime dhe Publikime.

~ Në bashkëpunim me ekspertët e Projektit IPA 2009 është hartuar dhe miratuar nga Komisioneri;

1. Manuali "Për Vlerësimin e Kërkesave për Miratimin e Transferimit të të Dhënave në Shtete të Huaja".
2. Manuali i "Procedurave të Njoftimit"

Ky manual jep informacion dhe orientime për stafin e Drejtorisë në lidhje me hapat që duhet të merren në procedurën e njoftimit, për përfundimin e saj me sukses. Manuali përmban gjithashtu informacion shtesë për disa çështje dhe/ose probleme në lidhje me procedurën e njoftimit.

3. Manuali i Hetimit- Administrativ të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky manual përcakton rregulla të hollësishme për zhvillimin e hetimit administrativ, që nga kuptimi i hetimit administrativ, forma e hetimit, fazat e hetimit, fillimi i hetimit, përfundimi i tij, raporti përfundimtar deri tek shqyrtimi i raportit dhe relacionit nga Komisioneri dhe marrjen e vendimeve përfundimtare nga ana e tij.

4. Manuali "Për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale".

Qëllimi i këtij Manuali është të shërbejë si një mjet referimi për punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ai do të shërbejë për lehtësimin e punës së përditshme dhe shkëmbimin e informacionit për përmirësimin e punës brenda dhe jashtë këtij institucioni, por gjithashtu do të shërbejë si një urë komunikimi ndërmjet institucionit dhe aktorëve të jashtëm.

~ Ndërsa, nga KMDP;

5. Është miratuar Rregullorja për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Objekti i kësaj Rregullore është përcaktimi i procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen, sigurinë, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave personale nga strukturat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe përpunimin e të dhënave në përputhje me Kushtetutën, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut
6. Është hartuar dhe Botuar "Përmbledhëse Ligjore e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", e cila përmban gjithë rendin juridik të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të hartuar që nga ngritja e këtij autoriteti.
7. Është hartuar "Përmbledhëse sipas fushave" në të cilën parashikohen raste të ndryshme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, duke iu referuar fushave në të cilat të dhënat përpunohen më së shumti Kjo përmbledhëse do të ndihmojë punonjësit e Komisionerit për të trajtuar dhe reflektuar në çështje analoge.

8. Është hartuar Udhëzues “Mbrojtja e të dhënave personale për kompanitë call center” Ky Udhëzues jep informacion në lidhje parimet e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë telefonatave të marketingut nga një kompani Call Centre, disa të drejta të subjekteve të të dhënave dhe detyrime të kontrolluesve Call Centre.
9. Është hartuar dhe botuar Fletëpalosja “Kujdes nga vjedhja e identitetit Tuaj”. Kjo fletëpalosje parashikon disa këshilla për t’u mbrojtur nga dhjetë raste në të cilat çdo subjekt mund të rrezikohet nga vjedhja e identitetit apo e të dhënave personale
10. Është hartuar Fletëpalosja “Mbrojtja e të dhënave personale për shërbimet sociale publike”. Kjo fletëpalosje ndihmon si subjektin e të dhënave dhe kontrolluesin e shërbimeve sociale për të pasur një informacion të përgjithshëm në lidhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
11. Është botuar Fletëpalosja “Mbrojtja e të dhënave të konsumatorëve” për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Kjo fletëpalosje parashikon marrjen e masave nga agjencia për të përmbushur angazhimin e ASD për mbrojtjen e të dhënave personale të konsumatorëve.

KAPITULLI IV.

HETIM-INSPEKTIMI

IV.I Ankesat e paraqitura pranë KMDP.

Pranë Autoritetit të Komisionerit përgjatë vitit 2012, janë paraqitur **mbi 70 raste kërkesash** për informacion dhe shqetësime për shkelje të mundshme, por **vetëm 22 prej** tyre kanë qenë ankesa të mirëfillta me shkrim nga subjekte të ndryshëm të të dhënave, për të cilat në të gjitha raste është ushtruar inspektim administrativ për të verifikuar në terren situatën e parashtruar në ankesë, verifikimin e shkeljes, marrjen e provave dhe shqyrtimin e tyre, si dhe daljen në konkluzion për gjetjet dhe dhënien e përgjigjes për subjektin/tet që janë ankuar. Vetëm në një rast është tërhequr ankesa nga një shtetase.

Përsa i përket ankesave të tjera, ato janë shqyrtuar nga inspektorët dhe subjekteve ju është dhënë orientimi i duhur për të ezauruar të drejtat e tyre, kur në thelb të ankesave ka qenë:

- ~ Saktësia dhe informimi mbi të dhënat që përpunohen si dhe marrja e pëlqimit për marketingun direkt;
- ~ Lidhur me publikimin dhe përhapjen e të dhënave personale në faqen zyrtare të gjykatave dhe media;
- ~ Lidhur me përpunim e të dhënave imazhe nëpërmjet CCTV;
- ~ Lidhur me përhapjen e të dhënave nga disa institucione publike.

● Rastet Konkrete:

1. Është trajtuar ankesa e shtetasve M.Z, K.P, Th.B, me të cilën kërkonin një mendim të të Komisionerit, lidhur me informacionet që kishin kërkuar para kontrolluesit **Agjencia e**

Legalizimit dhe Integritetit të Zonave Informale (ALUIZNI) Tiranë. Kërkuesve ju dha një përgjigje e bazuar në dispozitat e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale”(nenin 28), nenit 28 ligjit nr.9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.411 datë 19.05.2010 pika 3/a lidhur me publikimin e listës së përfituesve nga procesi i legalizimit të ndërtimeve. Kërkuesve ju dha orientim që t’i drejtohen organeve gjyqësore për zgjidhjen e problemit të tyre;

2. Ankesa e depozituar pranë Autoritetit të Komisionerit, me nr.436/12. prot., datë 09.12.20011, “Shoqëria ROFIX” Sh.p.k.ndaj **Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**, Tiranë. Objekti i ankesës: Përhapja, pa dijeninë e Shoqërisë Rofix, të listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore. Tatimi mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e kësaj shoqërie tek të tretët. Pretendimi i parashtruar në këtë ankesë, qëndron në faktin që, sipas shoqërisë, përhapja e këtyre të dhënave është realizuar pa patur një mbështetje ligjore dhe si e tillë pretendohet se, ka cënuar rëndë privatësinë e punëmarrësve të shoqërisë. Kjo shoqëri thekson se, bërja me dije e listës emërore të tretëve, me të dhënat e punëmarrësve është realizuar pa një vendim të ndërmjetëm gjykatë dhe pa përmbushur një sërë procedurash dhe kriteresh ligjore.

Mbi bazë ankesë të Shoqërisë Rofix nga Komisioneri janë ushtruar kontrollat administrative në kontrolluesit e mëposhtëm: Zyra avokatie, person fizik Av. Luan Merlika. Sipas Rekomandimit të Komisionerit, subjektit i është rekomanduar: Të heqë nëse ekzistojnë të gjitha të dhënat që e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë tërhequr nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore dhe që nuk kanë lidhje me subjektin që ai përfaqëson. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore. Këtij subjekti i është rekomanduar nga Komisioneri:

Të merren masa që të mos jepen të dhëna të personave të regjistruar në regjistrat e kontrolluesit, pa marrë pëlqimin paraprak nga ana e tyre dhe hartimi i një rregulloreje për mbrojtjen e të dhënave personale sipas kërkesave të nenit 27, 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

3. Është trajtuar ankesa e shtetas V. Z (H) me objekt “kërkesë për ndërhyrje të Komisionerit **në 6 (gjashtë) forume dhe gazeta elektronike**, të temave më përmbajtje fyese”. Nga grupi i inspektimit janë bërë verifikimet përkatëse në rrugë elektronike në lidhje me këto publikime, nëse ato janë ose jo akoma në rrugë elektronike të disponueshme. Janë verifikuar ankesat e bëra nga shtetasja (ankuesja) tek kontrolluesit e mësipërm për fshirjen e informacionit dhe në përfundim, si masë paraprake për zgjidhjen e çështjes janë dërguar shkresa tek të gjashtë kontrolluesit për tu kërkuar informacion me autoritetin e Komisionerit, në lidhje me mbajtjen ende të të dhënave të shtetasës në forume dhe në lidhje me bazën ligjore ku mbështeten për mbajtjen ende të këtij informacioni edhe pse shtetësia është deklaruar e pafajshme me vendim gjykatë për akuzën e korrupsionit që flitet në forumet elektronike. Zgjidhja e ankesës është ende në proces pasi, pas përgjigjes së këtyre kontrolluesve do të bëhen verifikimet e duhura nëse ka bazë ligjore për mbajtjen ende të këtyre të dhënave ose jo;
4. Është trajtuar gjithashtu, një ankesë e ardhur me postë elektronikë në adresë të KMDP-së. Shtetasi R, i cili ka nisur këtë ankesë, i është kërkuar disa herë nëpërmjet komunikimit elektronik, bashkëpunimi, por nuk ka patur reagim nga ana e tij. Autoriteti i Komisionerit nuk mund të vijonte më tej me trajtimin e kësaj ankese pasi pa patur provat e nevojshme dhe informacionet sqaruese të vetë ankuesit.
5. Trajtimi i ankesës së RTV “Ora News” lidhur me kërkesën për lëshimin e autorizimit në zbatim të ligjit nr. 9367 datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, që ju është bërë disa pedagogëve të “**Universitetit Bujqësor**” Tiranë, ku kërkohej që Komisioneri të investigojë rastin në fjalë si ankesë e depozituar në emisionin “Alarm”

nga një grup pedagogësh të “Universitetit Bujqësor” Tiranë”. Lidhur me këtë ankese ju dërgua përgjigja ankuesit, është komunikuar me Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (ILDKP) si dhe u shkëmbyen informacione me “Universiteti Bujqësor” Tiranë. Në përfundim Komisioneri ka dale me Rekomandim për kontrolluesin “Universiteti Bujqësor” Tiranë ku kërkon marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 9367 datë, 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave, në ushtrimin e funksioneve publike”.

6. Inspektimi pranë kontrolluesit “**Fakulteti Mjekësisë**” (Universiteti i Tiranës). Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin, pas ankesës të paraqitur nga një grup studentësh të këtij kontrolluesi. Objekt i inspektimit ishte zbatimi i kërkesave të parashikuara në nenet 12-18 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, për subjektet e të dhënave personale të kategorisë “studentë”. U konstatua që në shpalljen e listës të notave të studentëve duke mos bere anonime emrat dhe të dhëna tjera personale të studentëve kontrolluesi është ne shkelje te nenit 27/1 duke lejuar akses dhe për persona te trete duke lejuar kështu përhapjen e te dhënave. Nga ky inspektim u dha Rekomandim për kontrolluesin “Fakulteti Mjekësisë” “Universiteti i Tiranës”, lidhur me hartimin e një rregulloreje të veçantë lidhur me mënyrën e publikimit të listës të notave të studenteve ku të ketë parashikuar bërjen anonime te emrave dhe të dhënave tjera personale të studentëve.
7. Ankesa me objekt publikim të dhënash personale të shtetasit X , i cili ankohet ndaj kontrolluesit **ZRPP- Lezhë**. Ankesa është në trajtim e sipër, mbas plotësimit të dokumenteve shtesë që kam kërkuar do të nxjerr urdhrin për verifikim të kësaj ankese dhe do të shkohet pranë kontrolluesit ZRPP Lezhë. Ankesa me objekt publikim të dhënash personale të shtetasit X i cili ankohet ndaj kontrolluesit ZRPP- Lezhë . Për këtë ankesë në zbatim të urdhrin për verifikim është shkuar pranë kontrolluesit ZRPP-Lezhë, janë marrë informacione, përpiluar procesverbale dhe në kuadër të trajtimit të kësaj ankese mendoj se: rezulton i provuar fakti i përhapjes së të dhënave personale të shtetasit X tek disa subjekte të tjera të të dhënave, prej kontrolluesit ZRPP- Lezhë. Përhapja e të dhënave konsiston në faktin se nga ana e këtij Kontrolluesi është përpiluar një shkresë ku janë radhitur në listë emërore të dhënat personale (emër, mbiemër, adresë, nr pasurie) të mbi njëqind subjekte të të dhënave dhe kjo listë i është dërguar për njoftim në këtë mënyrë gjithsecilit prej tyre. Në përfundim të trajtimit të kësaj ankese u dërgua Rekomandim ZRPP-Lezhë me detyra specifike për të respektuar ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale veçanërisht nenin 6 (marrjen e pëlqimit).
8. Është trajtuar ankesa e B K nëpërmjet së cilës kërkohej nga Komisioneri “që të ndërhyje pranë AKKP duke i dhënë një autorizim për përdorimin e të dhënave të kërkuara nga unë BK, në mënyre që AKKP të më lëshojë një vërtetim zyrtar se zotërinjtë MB dhe AA kanë qenë emëruar ne Zyrën Rajonale të Komisionit të Kthimit të Pronave në Qarkun Fier, përkatësisht si ish kryetar dhe nën kryetar ne atë Komision dhe kohëzgjatjen në ushtrimin e kësaj detyre”. Lidhur me këtë ankese ju dërgua përgjigja ankueses duke e quajtur të drejtë kërkesën dhe është komunikuar me shkresën e datës 05.06.2012 me AKKP Tiranë që të plotësojë kërkesën e BK.
9. Ankesa e shtetasit Y ndaj kontrolluesit “**Eagle Mobile**”, është vazhduar me trajtimin e saj. Në zbatim të urdhrin të nxjerrë për verifikim të kësaj ankese është shkuar pranë kontrolluesit dhe i janë kërkuar informacione, jemi në pritje këtyre informacioneve, për të krijuar një bindje lidhur me qëndrimet e kontrolluesit në drejtim të eksesis ndaj subjektit të të dhënave Y.
10. Është trajtuar ankesa e shtetas E. M me objekt: “Per akses në të dhenat e saj personale pranë kontrolluesve **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe AKEP** ”. Përgjigja që është kthyer në këtë rast nga Komisioneri është se: vetëm pas ezaurimit të ankimin tek kontrolluesit mund t'i

drejtohet me ankesë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëse mendon që nga kontrolluesit nuk janë përmbushur pretendimet e saj në lidhje me përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

11. Është trajtuar ankesa e B.K nëpërmjet së cilës kërkohej nga Komisioneri “që të ndërhyje pranë AKKP duke i dhënë një autorizim për përdorimin e të dhënave të kërkuara nga unë BK, në mënyrë që AKKP të më lëshojë një vërtetim zyrtar se zotërinjtë MB dhe AA kanë qenë emëruar ne Zyrën Rajonale të Komisionit të Kthimit të Pronave në Qarkun Fier, përkatësisht si ish kryetar dhe nën kryetar ne atë Komision dhe kohëzgjatjen në ushtrimin e kësaj detyre”. Lidhur me këtë ankesë ju dërgua përgjigja ankueses duke e quajtur të drejtë kërkesën dhe është komunikuar me shkresën e datës 05.06.2012 me AKKP Tiranë që të plotësojë kërkesën e BK.
12. Është trajtuar ankesa e N.T, nëpërmjet së cilës kërkohej nga Komisioneri të ndihmohej lidhur me kërkesën që ndryshe nga pretendimi i tij ... “gjyqtarja vendosi që t’i kërkoje shoqërisë celulare AMC nëse ai numër telefoni u përket tre të paditurve apo çdo personi tjetër pa asnjë kufizim edhe pse nuk është palë në gjykim”. Zgjidhja e kësaj kërkesë nuk është në kompetencë të Komisionerit prandaj ju dërgua përgjigja ankuesit duke i rekomanduar t’u drejtohej organeve kompetente gjyqësore që të veprojnë në drejtim të plotësimit të kërkesës së tij.
13. Inspektim mbi bazën e ankesës së A. K. i cili ka si objekt ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me publikimin e artikujve mbi arrestimin e disa pedagogëve në Universitetin Bujqësor të Kamzës, ku ankuesi është përmendur si personi kallëzues janë në proces dhe janë filluar inspektimet administrative pranë këtyre kontrolluesve:

“Gazeta Shqip”

“Gazeta Panorama”

”Gazeta Koha Jonë”

“Gazeta Standard”

“Gazeta Shqiptare”

14. Janë trajtuar ankesat e datës 26.07.2012 dhe 24.08.2012 (anonime) përmes inspektimit administrativ pranë kontrolluesit “*Insig*” Tiranë me objekt zbatimin e ligjit “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” në përpunimin e të dhënave personale “*imazhe*” nëpërmjet kamerave vëzhgim-regjistrimi (CCTV). Në përfundim të inspektimit Komisioneri ka urdhëruar: Ne zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”: Të ndalohej mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të “*Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi*” në zyrat e sekretares së Drejtorit të Përgjithshëm, Auditit të brendshëm, Dëmeve, Financës, Juridike, Degës së Tiranës, shitjes së Tiranës; Te shkatërrohen të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara përmes përdorimit të sistemit të “*Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi*” në zyrat e sekretares së Drejtorit të Përgjithshëm, Auditit të brendshëm, Dëmeve, Financës, Juridike, Degës së Tiranës, shitjes së Tiranës; Në zbatim të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” si dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, brenda një afati kohor prej 45 ditësh, të hartohet rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të “*Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi*”; Në rregulloren e përdorimit të këtij sistemi të parashikohet që akses i këtij sistemi të behet vetëm lokalisht nga personi i autorizuar dhe jo nëpërmjet protokolleve të internetit.

15. Është trajtuar ankesa e datës 24.08.2012 e shtetases H.S përmes inspektimit administrativ pranë kontrolluesit **“Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë**, lidhur me publikimin e vendimit nr. 1060 datë 09.02.2012 në të përditshmen *“Gazeta Shqiptare”*. Ne përfundim të inspektimit Komisioneri ka urdhëruar: Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* dhe Kreut IV të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”*: Të bëhet anonimizimi i të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në Vendimin nr.1060 datë 09.02.2012 të publikuar në faqen e tyre zyrtare në internet, si dhe të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”* për të realizuar anonimizimin e të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në vendimet gjyqësore që publikohen në faqen zyrtare në internet.
16. Është trajtuar ankesa e e datës 24.08.2012 përmes inspektimit administrativ pranë kontrolluesit **“Shyze” sh.p.k** rruga *“Kavajës”*, qendra e biznesit G-Kam,Tiranë, me objekt: zbatimin e ligjit *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* në përpunimin e të dhënave personale *“imazhe”* nëpërmjet kamerave vëzhgim-regjistrimi (CCTV). Ne përfundim të inspektimit Komisioneri ka urdhëruar: Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*: të ndalohe mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”* në: zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm, zyrën e Financës, zyrën Juridike, zyrën e Menaxhimit, arshivës si dhe trotuarin dhe pjesë të rrugës përpara fasadës së godinës ku ushtroni aktivitetin tuaj; Te shkatërrohen të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara përmes përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”* në: zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm, zyrën e Financës, zyrën Juridike, zyrën e Menaxhimit, arshivës si dhe trotuarin dhe pjesë të rrugës përpara fasadës së godinës ku ushtroni aktivitetin tuaj; Në zbatim të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* si dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*, brenda një afati kohor prej 45 ditësh, të hartohet rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”*.
17. Mbi bazën e Urdhrit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale me grup pune është filluar inspektimi administrativ mbi një ankesë pranë kontrolluesit **“Cez shpërndarje”- Tiranë**. Objekti i këtij inspektimi administrativ mori shkas nga disa shqetësime dhe ankesa të subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale të mbërritura pranë zyrës së Komisionerit, lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale prej kontrolluesit *“Cez Shpërndarje” sh.a*, gjatë procesit të plotësimit të *“formularit të saktësimit të të dhënave”*.

Grupi i inspektimit administrativ e konsideroi në shkelje të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* (nenet 5,6) kontrolluesin *“Cez shpërndarje”* për sa i përket *“Formulari i saktësimit të të dhënave”* që kontrolluesi Cez-shpërndarje përdor për mbledhjen e të dhënave personale nga subjektet e të dhënave (klientë), në rrugë elektronike apo manuale. Shkelja konsiston në faktin që ky formular nuk ju krijon mundësinë subjekteve të të dhënave personale të informohen lidhur me të dhënat personale që mblidhen nëpërmjet tij. Vendosja e deklaratës së aplikantit për marrjen e pëlqimit për përdorimin e të dhënave personale për qëllime marketingu në *“formularin e saktësimit të të dhënave”* në fundin e tij dhe nënshkrimi i subjektit të të dhënave menjëherë pas tij, nuk përputhet me qëllimin e kontrolluesit dhe në emërtimin e formularit.

Konstatohet se në “formularin e saktësimit të të dhënave”, në deklaratën e aplikantit, subjektit të të dhënave personale nuk i është dhënë mundësia opsionale e kundërshtimit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për qëllime marketingu.

Bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 30, mbështetur në pikën 6 të urdhrin nr. 174 datë 01/10/2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kontrolluesit Cez-shpërndarje urdhërohet të ndalojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, për subjektet e të dhënave personale (klient), nëpërmjet përdorimit të “formularit të saktësimit të të dhënave” në rrugë elektronike dhe manuale. Ka përfunduar inspektimi administrativ pranë Kontrollusit “Cez Shpërndarje”, mbi bazën e ankesës, duke u konkluduar me gjobë për shkeljet e konstatuara. Janë përpiluar aktet për këtë procedim si dhe vendimi administrativ si më poshtë:

Dënimin e Kontrolluesit, “Cez shpërndarje” sh.a me gjobë, në vlerën gjithsej 400 000 (katërqindmijë) lek, për shkeljet e konstatuar lidhur me mosdeklarimin e qëllimit, mosbërjen e informimit të subjekteve të të dhënave personale, mosmarrjen e pëlqimit dhe mosdeklarimin në formularin e njoftimit, gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave personale nëpërmjet “formularit të saktësimit të të dhënave”, bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

18. Në lidhje me trajtimin e ankesës së Zj. V. H., duke qenë se nuk është kthyer përgjigje nga **Gazeta Shqip** në lidhje me shkresës për informacion nga Komisioneri që kishte lidhje me ankesën e shtetas në lidhje me kohëzgjatjen e publikimit të të dhënave të saj, është marre kontakt me përfaqësuesit e këtij të kontrolluesit dhe ky i fundit ka bërë anonimizimin e të dhënave personale.
19. Inspektimi pranë kontrolluesit “**VELUR**”, vene ne lëvizje nga ankesa e shtetas polake, D. S, në lidhje me dërgimin e mesazheve promocionale (marketing direkt) nëpërmjet postës elektronike. Në datën 19.10.2012, kontrolluesi depozitoi procesin verbalin të firmosur nga ana e vet, si dhe pretendimet e shprehura. Për këtë kontrollues është dhënë urdhëri për ndalimin e shkeljeve dhe marrjen e masave ligjore dhe tekniko-organizative.
20. Ankesa e F. A, marrje mesazhi promocional; Për këtë është mbajtur korrespondencë edhe me Autoritetin Norvegjez të Mbrojtjes së të Dhënave. Është dalë nga Komisioneri me shkresë Kthim-Përgjigje.
21. Ankesa e V.H të dhëna ne **Forume online**- në lidhje me akuzat e bëra ndaj saj gjatë arrestimit për akte korruptive. Është zhvilluar korrespondencë online me një sërë kontrolluesit dhe një pjesë e tyre kanë reaguar duke hequr të dhënat e publikuara, një pjesë tjetër nuk kanë qendër në Republikën e Shqipërisë dhe janë jashtë kompetences së Komisionerit.
22. Është trajtuar ankesa e shtetasit Z.AH lidhur me aksesin në të dhënat personale, është dërguar shkresë **SHISH**, dhe mbi bazën e përgjigjes zyrtare po hartohet shkresa sqaruese për shtetasin. Hetimi administrativ nuk mund të shtrihej më tej në këtë kontrollues pasi inspektorët janë ande në procesin e pajisjes me Çertifikatat e Sigurisë nga ana a DSIK-së.

IV.II Kontrolli dhe Inspektimi Administrativ

- **Kontrolli Kryesisht mbi bazën e Planit.**

Pas hartimit dhe miratimit të planit të përgjithshëm miratuar nga Komisioneri, Drejtoria e Hetim-Inspektimit, për periudhën Janar-Dhjetor 2012, ka ushtruar kontrolle administrative në rreth 27 kontrollues të ndryshëm nga 12 që ishte plani fillestar kjo edhe për shkak të angazhimit të vetë inspektorëve në ideimin dhe ushtrimin e kontrolleve, kjo si një risi për këtë vit.

Fushat ku ky kontroll është fokusuar janë:

një pjesë e **sistemit bankar**, sistemi shëndetësor privat dhe publik, disa institucione shtetërore që ofrojnë shërbime publike por disa të tjera që kanë një përqendrim dhe një përpunim masiv të të dhënave personale për shkak të veçantisë së legjislacionit mbi bazën e të cilit operojnë, si dhe media e shkruar.

Grupet e kontrollit në shumicën e rasteve, bazuar në prova dhe fakte, kanë konkluduar se kanë qenë përpara rasteve të këtyre shkeljeve:

- ~ Hartimi i Rregulloreve të brendshme mbi sigurinë e të dhënave personale që përpunohen, si dhe politikat mbi mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin;
- ~ Mosplotësimi i detyrimit për të njoftuar;
- ~ Mos informimi i subjekteve të të dhënave;
- ~ Mos marrja e pëlqimit nga kategori të caktuara subjektësh të dhënash për disa përpunime specifike, kryesisht marketing direkt;
- ~ Përpunimi i të dhënave të tepërta në tejkallim të qëllimit dhe jo në proporcionalitet;
- ~ Mos parashikimi dhe moszbatimi i kriterëve për sigurinë e të dhënave;
- ~ Bërja publike e disa të dhënave specifike, në tejkallim të qëllimit për të informuar publikun dhe vetë subjektin e të dhënave, si dhe mos anonimizimi i të dhënave që janë bërë publike;
- ~ Transferimi dhe përhapja e të dhënave në kundërshtim me ligjin dhe aktet administrative të Komisionerit; etj.

Në disa raste Komisioneri ka inspektuar kontrolluesit pa i njoftuar paraprakisht, në vijim të informacionit të ardhur nga Drejtoria e Regjistrimit, pasi për disa lloje përpunimesh të njoftuara duhet të bëhej verifikim i mëtejshëm, veçanërisht në rastet e përpunimit të të dhënave sensitive, përpunimit me anën e kamerave CCTV, si dhe në rastet e transferimeve ndërkombëtare.

Për të gjitha këto shkelje Komisioneri ka dalë me Rekomandime, me qëllim shuarjen e shkeljes, krijimin e hapësirës ligjore nga vetë kontrolluesi për të garantuar mbrojtjen e të dhënave që përpunon, përputhshmërinë e veprimeve të përpunimit me parimet e Ligjit dhe akteve të Komisionerit.

● Rastet konkrete.

1. Përsa i përket kontrollit të planifikuar në sektorin bankar është përfunduar kontrolli në **“Pro Credit Bank”**. Zyra e Komisionerit nëpërmjet grupit të inspektimit konstatoi shkelje e cila rezultoi të ishte e së njëjtës natyrë në këta kontrollues. Përpunimi i të dhënave (imazheve) nëpërmjet kamerave vëzhgim-regjistrimi, përsa i përket monitorimit të ambienteve jashtë godinës së këtij kontrolluesi, ishte jo proporcional dhe e tejkalonte qëllimin për të cilin ky përpunim realizohet. Këto kamera nuk kishin këndin e duhur për monitorimin vetëm të fasadave të godinave të kontrolluesve, duke përpunuar imazhet e kalimtarëve. Për këtë kontrollues u dha Rekomandim për marrjen e masave ligjore dhe tekniko-organizative.
2. Përsa i përket kontrollit të planifikuar në sektorin shëndetësor u përfundua kontrolli në kontrolluesin **“Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr. 1”, Tiranë**. Grupi i kontrollit

konstatoi shkelje edhe në këtë kontrollues, pasi nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe nuk është shprehur në një rregullore të brendshme të hartuar prej tij, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe sidomos për sensitivitetin e këtyre të dhënave. Në përfundim Komisioneri me anën e Vendimit i dha gjobë këtij kontrolluesi për mospërmblidhjen së detyrimit për të njoftuar përpunimet, si dhe rekomandimin për të hartuar një Rregullore të Brendshme për mbrojtjen e të dhënave dhe veçanërisht atyre sensitive. Gjithashtu, ju rekomandoi, në rast nxjerrje jashtë përdorimi të kompjuterëve, të shkatërrojnë njësitë hard-disk të PC-ve, për të mos bërë të mundur rikuperimin e çdo informacioni që mund të gjendet në to.

3. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“INSTAT”** Tiranë me objekt zbatimin e ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ne përpunimin e të dhënave personale gjatë Censurit 2011 lidhur me informimin e publikut, qëllimin, proporcionalitetin, cilësinë e të dhënave, te dhënat sensitive, përhapjen e të dhënave personale, transferimin ndërkombëtar, procedurat për bërjen anonime të të dhënave, ruajtjen, konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale te mbledhura gjatë këtij procesi. Në këtë kontroll aktualisht jemi ne vazhdim të tij dhe do të vijohet sipas planit të kontrollit dhe në ditët ne vijim. Ky kontroll administrativ është realizuar në bashkëpunim edhe me ekspertët e huaj në kuadrin e Projektit IPA 2009 pranë Zyrës së Komisionerit. Ky kontroll u ushtrua në dy faza pasi procesi i anonimizimit kërkonte kohë. Në përfundim të të dy inspektimeve udha Rekomandim nga Komisioneri.

Rekomandim 1:

Në zbatim të Rekomandimeve *“Për Censurin e popullsisë dhe banesave të vitit 2010 “* të dhëna nga Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me EUROSTAT-in, para zhvillimit të procesit të Censurit, në projektet pilot të përfshihet një pyetje për faktin se si reagojnë subjektet e të dhënave personale lidhur me te dhënat sensitive që kërkohej nga Censuri.

Në zbatim të Rekomandimeve *“Për Censurin e popullsisë dhe banesave të vitit 2010 “* të dhëna nga Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me EUROSTAT-in, në censurin e ardhshëm:

- ~ Shtetasve si subjekte të të dhënave personale t’u krijohen kushte që të plotësojnë vetë *“Pyetësorin e Censurit”*.
- ~ Të zbatohen mënyra të reja alternative për të mbledhur të dhënat e kërkuara për Censurin, përveç mënyrës aktuale (*pyetësorit aktual në letër*), sikurse mund të jetë mbledhja e tyre nëpërmjet internetit.

Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartohen procedura të brendshme dhe dokumente të shkruara ku të parashikohet në mënyrë specifike siguria, respektimi i konfidencialiteti dhe privatësia e subjekteve të të dhënave personale.

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi të pajiset me çertifikata sigurie ndërkombëtare (si ISO 27000 etj..) në mënyrë që të garantojë në mënyrë maksimale sigurinë e të dhënave personale që mbledh dhe përpunon gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Rekomandim 2:

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*:

- ~ Të realizohen në një mënyrë transparente ndryshimet e kuadrit ligjor që të shërbejnë për procesin e anonimizimit të të dhënave personale që janë mbledhur gjatë Censurit-2011.
 - ~ Të përcaktohen dhe miratohen procedurat e brendshme për procesin e anonimizimit, në pajtim me ligjin për Statistikat Zyrtare dhe ligjin për Censurin , të përfshihet një dispozitë se çfarë do të bëhet me kopjen “virtuale” të pyetësorit .
 - ~ Të identifikohet me anë të një inventari çdo bazë të dhënash duke përfshirë një klasifikim të informacionit që përmbajnë: të dhëna personale, të dhëna jo personale dhe informacion statistikor, informacion publik, informacion që mund të përhapet tek organet publike/private etj, duke pasur parasysh bazën ligjore që zbatohen për çdo rast.
 - ~ Të përcaktohen dhe miratohen procedura të brendshme në pajtim me ligjin për Statistikat Zyrtare dhe ligjin për Censurin , për të parandaluar përhapjen e çdo të dhëne personale tek subjekte privatë apo publike në kundërshtim me ligjin.
- Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:
- ~ Të zbatohen detyrat e lëna në Rekomandimin nr.13 datë 04.06.2012, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Inspektimi pranë kontrolluesit Kompania telefonisë “**Abcom**”, Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I.Ky inspektim lidhet me masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale. Nga inspektimi nuk janë gjetur shkelje të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, përse i përket sigurisë së të dhënave.

5. Sipas planit të kontrollit të Zyrës së Komisionerit për vitin 2012, gjatë këtij muaji u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Universiteti Luarasi**”. Kontrolli në këtë kontrollues ishte tematik dhe ishte si objekt ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e përpunimit të të dhënave të kategorisë “student”, në lidhje me proporcionalitetin, saktësinë e të dhënave, kohën e ruajtjes së të dhënave, përhapjen dhe transferimin ndërkombëtar; ezaurimi i të drejtave të kësaj kategorie nga kontrolluesi, si dhe siguria e të dhënave. Në përfundim të këtij kontrolli, Komisioneri dha Rekomandim për këtë kontrollues mbi bazën e problematikave që hasi, në lidhje me:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 18 pika 1 germa “c”, Udhëzimit nr. 4 datë 16/03/2010 “ *Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit*” pika 2 dhe Vendimit nr. 2 atë 10/03/2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre, kreu II pika 2, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditë të marrë masat e duhura që në “formularin e aplikimit” për pranim të studentëve dhe në “kontratën e regjistrimit”, të realizojë informimin e subjekteve të të dhënave personale “studentët”, për qëllimin e përpunimit të të dhënave personale dhe me çdo informacion tjetër të nevojshme që garanton përpunimin e drejtë të të dhënave personale.

Në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenit 27 pika 1, brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të veçantë lidhur me mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave dhe konfidencialitetit.

6. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit Agjenci udhëtimi “**Albania Explorer**” Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua me njoftim paraprak për kontrolluesin. Objekt i kontrollit lidhet me

të dhënat personale që i përkasin kategorisë “Klientë” në lidhje me proporcionalitetin, ligjshmërinë si dhe procedurat e realizimit të mesazheve promocionale, mënyra e marrjes së pëlqimit nga subjektet. Rekomandimi i dhënë këtij kontrolluesi lidhet me masat që duhet të marrë kontrolluesi për marrjen e pëlqimit specifik të subjekteve të të dhënave personale (klientë) për dërgimin e mesazheve promocionale në adresat e tyre elektronike.

7. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Drejtoria e Përgjithshme - UKT” Tiranë**. Ky kontroll administrativ u fillua me njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I nisur ankesa e një qytetari (anonim). Objekti i kontrollit lidhej me përpunimin e të dhënave personale për subjektet e kategorisë “Konsumatorë”, procedurat e prodhimit dhe shpërndarjes së faturave të konsumit mujor të ujit për subjektet e kategorisë “konsumatorë”, si dhe masave që ka marrë kontrolluesi lidhur me sigurinë e të dhënave personale të kategorisë “konsumatorë”. Nga ky kontroll u konstatua që faturat e konsumit shpërndahen të pa mbyllura, lihen pranë banesave dhe janë të aksesueshme nga kushdo. Për këtë kontrollues u dha Rekomandim duke kërkuar marrjen e masave të sigurisë (zarfimi) në procedurat e shpërndarjes së faturave të konsumit mujor të ujit për subjektet e kategorisë “konsumatorë” në zbatim të kërkesave të nenit 27/1.
8. Sipas Planit të kontrollit të Zyrës së Komisioneri është realizuar kontrolli administrativ pranë Kontrolluesit **“ On time Concept “ sh.a** pas realizimit të kontrollit nga grupi i inspektimit dhe provave të mbledhura, konstatimet e bëra tek kontrolluesi u hartua Rekomandimi përkatës për kontrolluesin.
9. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Tirana Bank” dega “Vlora 1”** me adresë, bulevardi “Vlorë – Skelë”, Vlorë Ky kontroll administrativ u fillua me njoftim paraprak për kontrolluesin. Objekt i kontrollit është zbatimi i ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në përpunimin e të dhënave personale që i përkasin kategorisë “Klientë” në lidhje me: proporcionalitetin, ligjshmërinë, kohen e mbajtjes, informimin, marrjen e pëlqimit, sigurinë, konfidencialitetin, detyrimin për të njoftuar. Nga ky kontroll u konstatua që kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale (imazhe) nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera (CCTV) jashtë ambienteve të kontrolluesit (pjesë të trotuarit përpara fasadës) si dhe një kamera nuk ka regjistrime të qarta. Këto fakte janë konsideruar shkelje dhe është përgatitur e dërguar Rekomandim nga ana Komisionerit për këtë kontrollues. Në këtë Rekomandim është kërkuar ndalimi i marrjes së të dhënave personale nga sistemi CCTV nga këto dy kamera dhe shkatërrimi i të dhënave që janë regjistruar nga këto dy kamera.
10. Është ndërmarrë kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Raiffeisen Bank, Tiranë** me objekt: *Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Raiffeisen sh.a të klientëve dhe punonjësve, Parimi i Proporcionalitetit (neni 5/1/c), Koha e mbajtjes së të dhënave (neni 5/1/d) Informimi dhe marrja e Pëlqimit (nenet 6/1/a dhe 18) Politikat e Sigurisë dhe Konfidencialiteti (nenet 27-28), Detyrimi për të Njoftuar Zyrën e Komisionerit (nenet 21-26.*

Grupi i kontrollit administrativ ka përmbyllur pjesën më të madhe të kontrollit dhe është në pritje të firmosje së procesverbalit të konstatimit të shkeljeve dhe sjelljes së observacioneve nga ana e këtij kontrolluesi. Deri në këtë moment grupi i kontrollit administrativ ka konstatuar si shkelje nga ana e këtij kontrolluesi: *mbledhjen e të dhënës personale sensitive kombësinë për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale, klient, punonjës etj.; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera CCTV, jashtë ambienteve të kontrolluesit, duke monitoruar dhe pjesën e trotuarit dhe rrugës ngjitur me godinën e tij, për kalimtarë të rastësishëm të cilët nuk kanë lidhje me këtë kontrollues. Për këto shkelje është dërguar Rekomandim për shuarjen e tyre.*

- 11.** Është ndërmarrë kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Spitali Rajonal Vlorë** me objekt: *Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Spitali Rajonal Vlorë, për kategorinë e subjekteve të të dhënave “Pacient”;* Siguria e të dhënave personale, masat e marra nga kontrolluesi Spitali Rajonal Vlorë për sigurinë e të dhënave personale (neni 27); Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21). U zhvillua kontrolli administrativ, në të cilin u konstatuan shkelje nga ky kontrollues në drejtim të sigurisë së të dhënave personale për kategorinë “pacient”, si gjatë mbledhjes së tyre në rrugë manuale (nëpërmjet kartelave klinike të pacientëve) por dhe në rruge elektronike (sistemi i kartotekës). Gjithashtu u konstatuan shkelje për sa i përket konfidencialitetit të të dhënave personale dhe mos njoftimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave pranë zyrës së Komisionerit. Është kërkuar marrja e masave nëpërmjet Rekomandimit.

Rekomandimi për këtë kontrollues kërkon: të merren masa për sigurinë fizike të kartelave klinike të pacientëve (të cilat mbartin të dhëna personale dhe sensitive si dhe informacion konfidencial lidhur me shëndetin e pacientit, analiza, diagnoza etj.), duke u vendosur në dollapë apo kasaforta dhe zyra të siguruara me çelës. Ju kërkua këtij kontrolluesi që të merren masa që në kontratat e lidhura me ofruesit e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, të vendosen, parashikohen klauzola standarde për konfidencialitetin, si dhe të hartojë rregullore për qëllimin dhe mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV.

Gjithashtu ju rekomandua kufizimi i aksesit në kompjuterët dhe aplikacionin “CISP” duke vendosur fjalëkalimet e punonjësve të autorizuar për të patur akses; Të marrë masa teknike dhe organizative duke i shoqëruar specialistët e jashtëm gjatë kohës që janë duke shërbyer për programet (sistemet softëare) apo pajisjet fizike të kompjuterit (sistemet hardëare); Të shmangë nxjerrjen kompjuterëve jashtë ambienteve të kontrolluesit; Të dokumentojë shërbimet apo ndërhyrjet në pajisjet kompjuterike; të marrë masat e përshtatshme për ruajtjen e programit dhe të dhënave të këtij aplikacioni (Backup të sistemit dhe të dhënave të tij).

- 12.** Sipas planit të kontrollit të Autoritetit të Komisionerit për vitin 2012, gjatë këtij muaji u realizua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Universiteti F.S. Noli, Korçë**. Është dërguar Rekomandimi përkatës për shkeljet e evidentuara që përkonin edhe me ato të gjetura në kontrollues të arsimit të lartë (universitete të tjera).
- 13.** Sipas planit të kontrollit të Zyrës së Komisionerit për vitin 2012, gjatë këtij muaji u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Medical Clinic-Kristi” Korçë**. Kontrolli në këtë kontrollues ishte tematik dhe ishte si objekt ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me proporcionalitetin, saktësinë e të dhënave, kohën e ruajtjes së të dhënave, përhapjen dhe transferimin ndërkombëtar; ezaurimi i të drejtave të kësaj kategorie nga kontrolluesi, si dhe siguria e të dhënave, përgjatë procesit të censusit. Komisioneri lëshoi Rekomandimin përkatës edhe për këtë kontrollues.

Me anën e Rekomandimit këtij kontrolluesi ju kërkua: të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të përfshihet siguria e të dhënave dhe konfidencialiteti; të lidhë një kontratë me kompaninë apo individin që ka instaluar dhe mirëmban sistemin e të dhënave në rrugë elektronike, ku të parashikohen të drejtat dhe detyrimet që palët kanë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale; të konkretizojë në praktikat e veta të punës, dhe mekanizmin e “Pëlqimit”. Aplikimi i rubrikës së “Pëlqimit”, të shoqërohet me “Detyrimi për informim”.

- 14.** Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”** me adresë bulevardi “Bajram Curri” Tiranë, me objekt zbatimin e ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në përpunimin e të dhënave personale “imazhe” nëpërmjet kamerave vëzhgim-

regjistrimi (CCTV) që po instalohet në qytetin e Tiranës. Ky kontroll administrativ është filluar me njoftim paraprak për kontrolluesin. Grupi kontrollit administrativ u asistua nga Andrej Tomšič, Zëvendës Komisioner për Informacionin, pranë Komisionerit për Informacionin i Republikës së Sllovenisë. Rekomandimi për këtë kontroll kërkon të bëhen propozime konkrete ligjore për përdorimin e CCTV-ve, të përfundohet puna e grupit të punës për hartimin e rregullave për përdorimin e CCTV-ve. Në përfundim të kontrollit administrativ Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka rekomanduar këtij kontrolluesi:

Të ndërmerren veprimet e duhura për të realizuar propozimet ligjore ku të bazohet përdorimi i sistemit të CCTV-ve përmes amendimeve në ligjin nr 8972 datë 10.05.2001 “Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave” ose në ligjin “ *Për Policinë e Shtetit*”. Të përfundojë hartimi i përshkrimeve të detyrave funksionale, procedurave standarde të punës për përdorimin e sistemit të CCTV-ve, rregullave për aksesin, informimin, të drejtat e subjekteve, kohen e ruajtjes, sigurinë, përhapjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunohen brenda një afati kohor prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Në kontratën ndërmjet Kontrolluesit dhe kompanisë “*First*” sh.p.k të përcaktohen kriteret lidhur me kohen e ruajtjes, sigurinë, përhapjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunohen nga sistemi i CCTV-ve të cilat duhet të zbatohen deri në përfundimin e projektit. Të sillen për mendim në Autoritetin e Komisionerit vendimet e marra nga grupi i punës së Kontrolluesit pas përfundimit të hartimit të përshkrimeve të detyrave funksionale dhe procedurave standarde të punës për përdorimin e sistemit të CCTV-ve, rregullave për aksesin, informimin, të drejtat e subjekteve si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

15. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Banka Intesa Sanpaolo**” me adresë rruga “*Ismail Qemali*” nr 27 Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua me njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt zbatim i ligjit “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” në përpunimin e të dhënave personale që i përkasin kategorisë “*klientë*” dhe “*punonjës*” në lidhje me: proporcionalitetin, ligjshmërinë, kohen e mbajtjes, informimin, marrjen e pëlqimit, sigurinë, konfidencialitetin, detyrimin për të njoftuar, përdorimi i CCTV-ve.

Nga ky kontroll u konstatuan disa shkelje në: kërkesat dhe kontratat për hapje llogarie bankare lidhur me marrjen e pëlqimit; formularin “*informacion standard për kredikërkuuesin*” për mbledhje të dhënave personale dhe informacioneve të tepërta për klientët që kërkojnë të marrin kredi financiare si dhe mbajtjen e këtij formulari edhe kur klientit nuk i aprovohet kredia; përdorimi i sistemit të CCTV-ve jashtë ambienteve të kontrolluesit (pjesë të trotuarit përpara fasadës). Këto fakte u pranuan nga Kontrolluesi dhe në përgjigjen e tij konfirmon eliminimin e këtyre shkeljeve duke e shoqëruar dhe me provat përkatëse. Grupi i kontrollit pasi bëri verifikimin e provave të afuara dhe parashtroi mendimin se nuk është e nevojshme të përgatitet Rekomandim për këtë kontroll, pas shuarjes së shkeljeve dhe marrjes së masave të menjëhershme nga ky kontrollues.

16. Është përmbyllur kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Raiffaisen Bank**” dhe është nxjerrë rekomandimi: “*Raiffaisen Bank*” Tiranë të mos mbledhë të dhënën personale sensitive mbi “*kombësinë*” për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale klient, punonjës etj, si dhe “*Raiffaisen Bank*” Tiranë të ndalojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare.
17. Mbi bazën e Urdhrit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale me grup pune është filluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Bashkia Kukës**. Paraprakisht për këtë kontroll administrativ mund të themi që është gjendur në shkelje të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” për sa i përket: Mbajtjes së dosjeve me të dhëna dhe

informacion personal tej qëllimit për të cilin këto të dhëna i ka mbledhur, grumbulluar dhe përpunuar (neni 5/d); Informimit lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave për qëllimin për të cilin të dhënat personale mbledhen dhe përpunohen dhe për më tepër ky informacion mungon në formularët e të dhënave personale qofshin formularë tip të miratuar apo ata të hartuar nga kontrolluesi si dhe në kontratat e punës që kontrolluesi lidh me punëmarrësin (neni 18/1, 2); Marrjes së pëlqimit të shkruar (të prindit si kujdestar ligjor), lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sensitive të shëndetit për subjektet e të dhënave që trajtohen kontrolluesi në një qendër të shërbimit social (neni 7/2/a); Mungesa e rregullave të shkruara lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale (në rrugë manuale dhe elektronike) sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* Si dhe mungesa e masave teknike në përpunimin e të dhënave në mënyrë manuale. (neni 27). Kontrolluesit Bashkia Kukës iu lanë për zbatim disa detyra emergjente, si dhe ju dërgua Rekomandimi përkatës;

18. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Bashkia Lushnjë”**. Ky kontroll administrativ u fillua me njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: zbatimi i ligjit *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* në përpunimin e të dhënave personale në lidhje me: ligjshmërinë, informimin, qëllimin, sigurinë, konfidencialitetin, gjatë ushtrimit të detyrave dhe përmbushjes së tyre, në fushat e Tatim Taksave, Shëndetësi/Asistence, Menaxhimi dhe Survejimi. Është konstatuar se: dosjet mbahen në dollapë të cilat janë të pa siguruara me kyç; aksesit në dokumente nuk është i kontrolluar pasi kushdo që punon në këto zyra ka mundësinë të ndërhyjë në dosjet e punonjësve të tjerë; në këto ambiente realizohen dhe takimet me qytetarët që kane nevojë për asistencë nga kontrolluesi; Nuk ka një ambient të veçantë për te pritur qytetarët me probleme sociale dhe shoqërore si dhe ato të tatimeve; Raftet janë të pamjaftueshëm për të mbajtur numrin e madh të dosjeve; Shume dosje janë të vendosura edhe në krah të rafteve në dysheme; Distanca midis tavolinave të punës të punonjësve të drejtorisë të tatim-taksave shërbimeve sociale dhe në zyrat rajonale është shumë e vogël; Ambienti ku janë vendosur inspektorët e tatim-taksave është i papërshtatshëm për aktivitet administrativ, është shumë i lartë dhe shumë i gjatë, ka vetëm një derë, ka dritare të pasigurta; si dhe nuk janë hartuar rregulla të veçanta lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Ka shkelje në zbatimin e neneve 27-28 të ligjit, aktualisht është mbajtur dhe firmosur proces-verbali dhe po përgatitet relacioni për këtë kontroll.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka rekomanduar për këtë kontrollues: Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, brenda një periudhe 2 (dy) mujore të merren masa për mbrojtjen, aksesin dhe sigurinë fizike të dosjeve me dokumente të cilat mbartin të dhëna personale në zyrat e tatim-taksave dhe shërbimeve sociale; Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, brenda një periudhe prej 45 (dyzetë e pesë) ditësh të hartohen rregulla lidhur me: Mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Konfidencialitetin e të dhënave personale; Përdorimin dhe aksesin e pajisjeve kompjuterike nga personeli, si dhe sigurinë e të dhënave gjatë përpunimit automatik.

19. Mbi bazën e Urdhrit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me grup pune u krye kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Dhoma kombëtare e Noterisë” Tiranë**. Objekti i kontrollit administrativ ishte ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Noterisë, për subjektet e të dhënave personale si dhe siguria e të dhënave personale, konfidencialiteti, masat e marra nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Noterisë për sigurinë e të dhënave personale.

Nga të dhënat e këtij kontrolli administrative rezulton se Kontrolluesi, *“Dhoma Kombëtare e Noterisë”*, gjendet në shkelje të ligjit nr. Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të*

Dhënave Personale” (neni 27 dhe 21) lidhur me: Mungesën e rregullave të shkruara dhe të përcaktuara qartë për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike për subjektet e të dhënave personale “*noter*”; si dhe plotësimin në mënyrë të gabuar të rubrikave të formularit të njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar pranë kontrolluesit Dhoma Kombëtare e Noterisë Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale doli me Rekomandim, duke i kërkuar kontrolluesit: Në zbatim të nenit 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Noterisë*”, brenda 45 ditëve të marrë masa për hartimin e rregullave ose përfshirjen në rregulloren e përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Noterëve, të klauzolave dhe dispozitave që rregullojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në këtë ligj; Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, brenda 10-ditëve të rishikojë njoftimin e bërë pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke deklaruar saktë, veprimtarinë, qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, si kategoria e subjekteve të të dhënave personale.

20. Mbi bazën e Urdhrit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me grup pune u krye kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Dhoma Kombëtare e Avokatisë” Tiranë**. Objekti i kontrollit administrativ ishte ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Avokatisë, për subjektet e të dhënave personale si dhe siguria e të dhënave personale, kofidencialiteti, masat e marra nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Avokatisë për sigurinë e të dhënave personale. Edhe ky kontrollues u gjendet në shkelje të ligjit nr. Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” (neni 27 dhe 21) lidhur me: Mungesën e rregullave të shkruara dhe të përcaktuara qartë për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike për subjektet e të dhënave personale “*Avokat*”; Mosplotësimi i detyrimit ligjor për njoftim pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këtij kontrolluesi iu la detyrë emergjente për zbatim plotësimi i detyrimit ligjor për njoftim. Rekomandimi përkatës ju dërgua duke i kërkuar kontrolluesit: Në zbatim të nenit 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” kontrolluesi të marrë masa brenda 45 ditëve, për hartimin e rregullave ose përfshirjen në rregulloren e përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Avokatisë që është duke u hartuar, të klauzolave dhe dispozitave që rregullojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në këtë ligj.

21. Kontroll administrativ pranë **ZRPP, Tiranë Qendra**. Në përfundim, për tu nënshkruar procesverbali përkatës. Ky kontroll ka zgjatur në kohë për shkak të sasisë së madhe të informacionit që përpunohej nëpërmjet sistemit elektronik i cili është i llojit One-stop-shop, një projekt voluminoz dhe i zhvilluar nga ZRPP në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Në përfundim të kontrollit administrativ nga Komisioneri është dalë me Rekomandim ku kontrolluesit i është kërkuar: në zbatim të neneve 27/2”c”, 28 dhe 5 pika 1 germa ‘c’ të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, të hartojë Rregulloren e Posacme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose të përfshijë në Rregulloren në proces hartimi Seksionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të reflekohen dispozitat mbi mbrojtjen e të dhënave personale, cilat janë palët e treta që kanë akses dhe kanë të drejtën për t’u informuar në lidhje me këto të dhëna, duke përfshirë këtu subjektet e të dhënave personale, Institucione të tjera si ILDKP, avokatët, noterët etj duke reflektuar edhe parashikimet e ligjeve specifike me të cilat këto institucione veprojnë.

22. Është përfunduar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Viktor Hygo**”, dhe grupi i inspektimit është duke punuar për Relacionin dhe më pas do i paraqitet Komisionerit për vendimin përfundimtar dhe hartimin e aktit administrativ; Pas përfundimit të kontrollit administrativ pranë kontrolluesit “Viktor Hygo” shkolla franko-shqiptare, është hartuar dhe është përfunduar relacioni dhe rekomandimi përkatës për kontrolluesin “Viktor Hygo”. Për kontrolluesin është rekomanduar : Në zbatim të nenit 6 pika 1 germa ‘a’ të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar të merret pëlqimi i klientëve që paraqiten në zyrat e kontrolluesit për pranimin e mesazheve promociionale në adresën e tyre elektronike. Në rast se shërbimi i marketingut me e-mail ofrohet nga një subjekt i jashtëm, nga kontrolluesi dhe pala tjetër të hartohet një kontratë e qartë ku të përcaktohen rregulla në lidhje me konfidencialitetin dhe mbrotjtjen e të dhënave personale, të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me realizimin e marketingut nëpërmjet postës elektronike.
23. Në zbatim të Urdhërit për kontroll administrativ pranë kontrolluesit “**Urban Publicity**” u morën masa për ushtrimin e kontrollit. Nuk u gjetën zyrat sepse kontrolluesi ishte duke mbyllur aktivitetin, pavarësisht se në QKR rezultoi aktiv. U kontaktua në rrugë telefonike me përfaqësuesen e subjektit dhe u mbajt procesverbali përkatës me këtë të fundit. Në këtë takim u informuam se kontrolluesi është në proces likuidimi. Nga grupi i kontrollit u verifikua pranë QKR ky fakt dhe është nxjerrë ekstrakti përkatës i kontrolluesit ku ky i fundit rezultoi në proces likuidimi pranë QKR.
24. Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Gjykata e Apelit Tiranë**”. Ky kontroll administrativ u fillua me njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në publikimin e vendimeve gjyqësore. Aktualisht është hartuar proces-verbali i kontrollit administrativ si dhe Relacioni dhe së shpejti do të përfundojë hartimi i Rekomandimit përkatës për këtë kontrollues ashtu sikurse do veprohet me të gjitha gjykatat e kontrolluara dhe të tjerat me qëllim unifikimin;
25. Është përfunduar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Gjykata e Apelit, Durrës**”. Nga kontrolli rezultoi se: publikimi në faqe për publikun nuk kishte filluar ende dhe portali nuk ishte aktiv. Ndërkohë nuk kishte rregulla dhe rregullore për mënyrën e publikimit të vendimeve pra kishte vakum në këtë drejtim. Aktualisht është hartuar proces-verbali i kontrollit administrativ si dhe Relacioni dhe së shpejti do të përfundojë hartimi i Rekomandimit përkatës për këtë kontrollues ashtu sikurse do veprohet me të gjitha gjykatat e kontrolluara dhe të tjerat me qëllim unifikimin;
26. Është përfunduar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë**”. Nga inspektimi administrativ u konstatua se ky kontrolluesi bën publikim dhe përhapje të paligjshme të të dhënave personale të subjekteve të ndryshme të të dhënave. Aktualisht është hartuar proces-verbali i kontrollit administrativ si dhe Relacioni dhe së shpejti do të përfundojë hartimi i Rekomandimit përkatës për këtë kontrollues ashtu sikurse do veprohet me të gjitha gjykatat e kontrolluara dhe të tjerat me qëllim unifikimin;
27. Është përfunduar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**”. Nga inspektimi administrativ u konstatua se ky kontrolluesi bën publikim dhe përhapje të paligjshme të të dhënave personale të subjekteve të ndryshme të të dhënave. Aktualisht është hartuar proces-verbali i kontrollit administrativ si dhe Relacioni dhe së shpejti do të përfundojë hartimi i Rekomandimit përkatës për këtë kontrollues ashtu sikurse do veprohet me të gjitha gjykatat e kontrolluara dhe të tjerat me qëllim unifikimin;

28. Është përfunduar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë”. Nga inspektimi administrativ u konstatua se ky kontrolluesi bën publikim dhe përhapje të paligjshme të dhenave personale të subjekteve të ndryshme të të dhënave. Aktualisht është hartuar proces-verbali i kontrollit administrativ si dhe Relacioni dhe së shpejti do të përfundojë hartimi i Rekomandimit përkatës për këtë kontrollues ashtu sikurse do veprohet me të gjitha gjykatat e kontrolluara dhe të tjerat me qëllim unifikimin;

● **Inspektimi mbi zbatueshmërinë e Rekomandimeve, Urdhrave dhe Vendimeve të Komisionerit.**

Përgjatë vitit 2012 Zyra e Komisionerit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit ka ushtruar kontrole për të verifikuar zbatueshmërinë e Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri në vijim të kontroleve të mëparshme ushtruar në disa kontrollues. Në këtë kuadër janë verifikuar 35 kontrollues dhe në përfundim rezultuan se shumica i kishte plotësuar detyrimet e përcaktuara nga Komisioneri dhe për 3 prej tyre u vendos masa gjobë.

● **Rastet Konkrete**

1. **“Connex” sh.p.k.** Grupi i inspektimit verifikoi që Rekomandimi i Komisionerit ishte plotësuar tërësisht ka shkatërruar databasen me numra të telefonave celularë të përdoruesve që nuk ju është marrë pëlqimi. Marrja e pëlqimit tashmë kryhet nga kompanitë e interesuara për promocion përmes përdorimit të sms-ve të cilat kanë databasen e krijuar për klientët e tyre dhe “Connex” sh.p.k u afron këtyre kompanive portalin në faqen e internetit për dërgimin e këtyre sms-ve.
2. **“Banka Emporiki-Shqipëri S.A”.** Grupi i inspektimit verifikoi që Kontrolluesi e ka plotësuar pjesërisht Rekomandimin përse i përket hartimit të Rregullores së Brendshme për mbrojtjen e të dhënave, ndërsa pikën tjetër e ka plotësuar duke përfshirë në Urdhër-pagesat e transfertave për jashtë, pëlqimin e shkruar të klientit. Këtij kontrolluesi ju dha Rekomandim për plotësimin dhe saktësimin e Rregullores së Brendshme brenda një afati 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.
3. Në kuadrin e planifikimit të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrollues të ndryshëm, këtë muaj u ushtrua Inspektimi pranë kontrolluesit **“Qendra Shëndetësore Nr. 1 Tiranë”**. Gjatë këtij inspektimi të panjoftuar administrativ u konstatua se kontrolluesi nuk i kishte respektuar pikat e Rekomandimit të dhënë një vit më parë nga Komisioneri. Shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit konsistojnë në: Nuk është hartuar rregullorja “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Përgjigjet e analizave nuk janë të pajisura me zarfe, për të garantuar konfidencialitetin; Janë marrë pjesërisht masa në lidhje me sigurinë fizike, me anë të investimit në kartoteka të reja; Nuk ka afate kohore të mirëpërcaktuara për ruajtjen e dokumentacionit.

Pasi shqyrtoi dosjen e inspektimit, Komisioneri me Vendim vendosi dënimin e këtij kontrolluesi me masën administrative “gjobë” prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë, pra dënimin maksimal sipas nenit 39/1/dh të Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pasi nuk janë marrë masat e duhura për sigurinë e të dhënave gjatë përpunimit (neni 27), si dhe nuk janë marrë parasysh pikat e Rekomandimit të Komisionerit, si një prej formave që u vjen në ndihmë kontrolluesve për t’i vënë në dijeni në lidhje me detyrimet e papërmbushura nga ana e tyre në zbatim të Ligjit (neni 30/2). Ky vendim ju bë me dije edhe organin epror, Autoritetit Shëndetësor Rajonal, Tiranë, me qëllim marrjen e masave në qendrat e tjera shëndetësore.

4. Inspektim administrativ pranë kontrolluesit **“Eagle Mobile” sh.a Tiranë**. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin. Inspektimi pranë këtij kontrolluesi u realizua lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale për kategorinë “Pajtimtarë” bazuar në nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe VKM nr 934 datë 02.09.2009 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” në vende me dhe pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, informimin, marrjen e pëlqimit nga “pajtimtarët” dhe transferimet ndërkombëtare të realizuara për periudhën 20.12.2010-01.10.2011 dhe në vazhdim. Grupi inspektimit përfundoi verifikimet sipas objektit të urdhrat dhe u konstatua që ky kontrollues aktualisht nuk kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale jashtë Shqipërisë. Fakt tjetër i rëndësishëm është procesi në vazhdim i shkrirjes së këtij kontrolluesi me kontrolluesin “Albtelekom” nisur nga fakti që pronësia është e përbashkët për të dy këta kontrollues;
5. Inspektimi pranë kontrolluesit **“Agjencia e Legalizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale” (ALUIZNI) Tiranë**. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin. Inspektimi pranë këtij kontrolluesi lidhet me hartimi i një Rregullore të Brendshme “Për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë rregulla për sigurinë e të dhënave dhe konfidencialitetin dhe aplikimi i metodologjisë për kodim, shifrim dhe publikim për emrat e përfituesve nga procesi i legalizimit të ndërtimeve.

Nga inspektimi është konstatuar zbatimi i Rekomandimit lidhur me Formularin e Njoftimit dhe publikimit vetëm të dhënave të rekomanduara nga Komisioneri. Lidhur me hartimin e një Rregulloreje nga grupi i inspektimit i është lënë një afat 30 ditësh që të plotësohet kjo detyrë. Kjo detyrë u la nisur nga fakti që ky kontrollues ka reaguar pozitivisht ndaj Rekomandimit të Komisionerit dhe aktualisht për Rregulloren ka pasur vonesë pasi është në fazë rikonstruktive dhe akoma nuk është hartuar rregullorja e kërkuar. Po ashtu ky kontrollues ka një rregullore të brendshme në të cilën ka disa rregulla lidhur me sigurinë, procedurat dhe konfidencialitetin. Pas afatit të përcaktuar nga Komisioneri, kontrolluesi i plotësoi të gjitha pikat e rekomandimit.

6. Fillimi kryesisht të inspektimit administrativ pa njoftim paraprak pranë kontrolluesit **“Albtelekom” sh.a**, në vijim të kontrollit të ushtruar më parë ndaj këtij kontrolluesi. Inspektimi administrativ pranë këtij kontrolluesi kishte si objekt *“Verifikimin e zbatimit të Rekomandimit nr. 14/2 datë 18/05/2011”* të Komisionerit, dhënë ndaj kontrolluesit “Albtelekom” sh.a. Grupi i Inspektimit është në faqen e hartimit të relacionit përfundimtar, por pjesa më e madhe e zbatueshmërisë së pikave të Rekomandimit nr.14/2 datë 18/05/2011 të Komisionerit është verifikuar dhe inspektuar, nga ku rezulton se:

Kontrolluesi “Albtelekom sh.a” ka marrë masa teknike dhe organizative për të zbatuar pikat e Rekomandimit kështu: Kontrolluesi Albtelekom sh.a në kontratat që lidh me klientët mbas daljes së Rekomandimit, nuk mbledh më të dhëna personale për klientët, përtej atyre të dhënave që janë parashikuar në formularin tip të AKEP-it; Kontrolluesi Albtelekom sh.a ka hequr nga përdorimi sistemin e vjetër të faturimit, në momentin e verifikimit ai përdor një sistem të ri faturimi (*billing*) dhe të dhënat personale që mbarten në skedarë (tablatet e komunikimeve telefonike) tashmë i ruan për 2 vjet; Kontrolluesi Albtelekom sh.a ka marrë masat dhe ka pastruar arshivën fizike duke djegur të gjithë dokumentacionet me të dhëna personale për klientët që nuk janë më abonentë të tij; Kontrolluesi Albtelekom sh.a ka hartuar një kontratë të re tip, ku ka përfshirë në të rregulla të qarta mbi të drejtat dhe detyrat e përpunuesit për garantimin e përdorimit të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale të klientëve të tij, sipas parashikimeve në rekomandimin e Komisionerit, kontrata këto që do të nënshkruhen në të ardhmen me të tretët; Kontrolluesi Albtelekom sh.a ka saktësuar formularin e njoftimit të plotësuar pranë Zyrës së komisionerit duke shtuar kategorinë e subjekteve për të cilat mbledh dhe përpunon të dhëna personale; Kontrolluesin

Albtelecom sh.a. ka hartuar rregulloren për qëllimin, mënyrat e mbledhjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit CCTV si dhe rregullore për mënyrën e arkivimit dhe kohën e ruajtjes të dosjeve me dokumente që mbartin të dhëna personale të klientëve dhe punonjësve të tij.

7. Në kuadrin e planifikimit të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrollues të ndryshëm, këtë muaj u ushtrua Inspektimi pranë **kontrolluesit Univers-Alb sh.a, (Spitali Amerikan)** në zbatim të urdhrit nr.25, datë 05.03.2012 të Komisionerit. Gjatë këtij inspektimi të panjoftuar administrativ u konstatua se kontrolluesi nuk i kishte respektuar pikat e Rekomandimit të dhënë më parë nga Komisioneri.

Shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit konsistojnë në: nuk është hartuar rregullorja “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; kontrolluesi nuk ka plotësuar mangësitë e konstatuara në Formularin e Njoftimit sipas Rekomandimit; kontrolluesi nuk ka bërë korrigjimet e nevojshme në Formularin e Aplikimit për Punë, ku sipas rekomandimit një pjesë e madhe e të dhënave të mbledhura nga ky formular ishin të tepërta dhe jo-proporcionale. Ndaj këtij kontrolluesi u dha masa administrative gjobë.

8. Në kuadrin e planifikimit të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrollues të ndryshëm, këtë muaj u ushtrua Inspektimi pranë kontrolluesit “**Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë**”. Gjatë këtij inspektimi të panjoftuar administrativ u konstatua se, kontrolluesi nuk i kishte respektuar pikat e Rekomandimit të dhënë një vit më parë nga Komisioneri.

Shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit konsistojnë në: nuk ka informuar subjektet e të dhënave; nuk ka marrë pëlqimin paraprak të subjekteve të të dhënave; nuk ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, si dhe nuk ka marrë masat e kërkuara për sigurinë e të dhënave personale që përpunon. Pas përfundimit të dosjes së inspektimit, Komisioneri ka dalë me vendim për dënimin e këtij kontrolluesi me vendosjen e masës administrative gjobë.

9. Inspektimit administrativ pranë kontrolluesit **Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë** me objekt verifikimin e zbatimit të Rekomandimit nr. 27/2 datë 03/08/2011 të nxjerrë nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ndaj këtij kontrolluesi, Inspektimi administrativ ka filluar në datën 16/04/2012 dhe deri në momentin e përpilimit të këtij informacioni nuk ka përfunduar ende me një relacion përfundimtar, kjo për shkak se verifikimi i zbatimit të Rekomandimit u shtri si pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë ashtu dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për arsye se Rekomandimi i dhënë përmbante detyra për të dy këta kontrollues. Konkluzioni i grupit të inspektimit mbas përfundimit është: Kontrolluesi Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, ka përmbushur detyrat e lëna në Rekomandimit nr. 27/2 datë 03/08/2011 të nxjerrë nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kontrolluesi Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë ka hartuar projekt udhëzim për “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave personale*” si dhe një projekt udhëzim “*Mbi përdorimin e kamerave vëzhgues CCTV*”, ku ka konceptuar dhe formatin e tabelave informuese për video survejimin CCTV sipas modelit të vendosur në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe i ka përcjellë për mendim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të cilat janë protokolluar datën 24/04/2012 me nr. 5027 prot, ku më pas këto akte do t’i përcillen të gjitha Drejtorive Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor në Shqipëri. Kontrollusi Drejtoria Rajonale e Shërbimit të

Transportit Rrugor Tiranë, në rrugë elektronike ka përcjellë formularin e njoftimit i cili është protokolluar me datën 04/05/2012 nga Zyra e Komisionerit.

10. Në kuadrin e planifikimit të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrollues të ndryshëm, këtë muaj u ushtrua inspektimi pranë kontrolluesit **Gjinnazi “Qemal Stafa”**. Pasi shqyrtoi dosjen e inspektimit, Komisioneri me Vendim vendosi dënimin e këtij kontrolluesi me masën administrative “gjobë” prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë, sipas nenit 39/1/, germa “d” dhe “dh” të Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pasi nuk janë marrë masat e duhura për sigurinë e të dhënave gjatë përpunimit (neni 27), si dhe nuk janë marrë parasysh pikat e Rekomandimit të Komisionerit, si një prej formave që u vjen në ndihmë kontrolluesve për t’i vënë në dijeni në lidhje me detyrimet e papërbushura nga ana e tyre në zbatim të Ligjit (neni 30/2). Këtij kontrolluesi ju dha vendim për gjobë, por më pasi kërkesa e vetë subjektit u paraqit pranë Komisionerit për të rishikuar vendimin, kërkesë e cila u mor në konsideratë dhe vendimi u revokua, pasi nga ana e titullares së emëruari rishtazi, nëpërmjet një reagimi të menjëhershëm, u morrën menjëherë masat e duhura.
11. Kontrolluesi “**Albtelekom sh.a**” mbledh të dhëna personale për klientët e rinj vetëm në bazë të formularit tim të miratuar nga AKEP-i dhe jo të dhëna të tjera shtesë që nuk parashikohen në këtë formular. Kontrolluesi “Albtelekom sh.a” në sistemin aktual të faturimit “billing” ruan të dhënat personale për një periudhë jo më shumë se dy vjet. Kontrolluesi “Albtelekom sh.a” ka shkatërruar nga arkiva e tij fizike dosjet e klientëve që nuk kanë kontratë aktive me të. Kontrolluesi Albtelekom sh.a, mbas inspektimit, ka hartuar kontrata tip ku ka përfshirë Rekomandimin e Komisionerit (konceptet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave) të cilat do të zbatohen për kontratat që do të nënshkruhen në të ardhmen me të tretët. Kontrolluesi Albtelekom sh.a, ka shtuar në formularin e njoftimit pranë Komisionerit edhe kategorinë “furnizues” sipas Rekomandimit të dhënë. Kontrolluesi Albtelekom sh.a ka përpiluar draft “Rregullore për Sistemin e Survejit në ambientet e Albtelekom sh.a.” brenda afatit të lënë në Procesverbalin e inspektimit administrativ.
12. Është bërë inspektimi administrativ për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna për kontrolluesin “Grand Hotel Evropa “ Shkodër, vazhdon puna për përpilimin e akteve të këtij inspektimi;
13. Është realizuar kontrolli administrativ pranë **Gjinnazit “ Ismail Qemali” Tiranë**, në lidhje me verifikimin e përmbushjes së detyrimeve sipas rekomandimit nr. 3/2, datë 10.03.2011 të Komisionerit. Nga kontrolli rezultoi që ky kontrollues ka marrë masat e duhura për përmbushjen e rekomandimit.
14. Në kuadrin e planifikimit të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për kontrollues të ndryshëm është përfunduar relacioni mbi Inspektimin pranë **kontrolluesit, Shtëpia Shkollore e Fëmijës, Shkodër** në zbatim të urdhërit të Komisionerit. Ky kontroll ka përfunduar dhe nga Komisioneri është dalë me një Rekomandim të dytë në lidhje me këtë kontrollues pasi nga ana e tij, ishin plotësuar vetëm pjesërisht rekomandimet e para.
15. Sipas planit të kontrollit të Zyrës së Komisionerit për vitin 2012 u realizua verifikimi mbi zbatimin e rekomandimit, pranë **Universitetit “ Ismail Qemali “ Vlorë**. Nga inspektimi rezultoi se kontrolluesi i ka plotësuar pikat e Rekomandimit të Komisionerit.
16. U ushtrua inspektim administrativ pranë kontrolluesit Porti Detar sh.a Vlorë me objekt verifikimin e zbatimit të Rekomandimit të Komisionerit nr. 18/2 datë 02/06/2011 dhënë ndaj kontrolluesit Porti Detar sh.a Vlorë, nga ky inspektim rezultoi se Kontrolluesi “Porti Detar” sh.a Vlorë ka përmbushur detyrat e lëna nga Komisioneri.

17. Inspektim administrativ pranë kontrolluesit **“ALPHA - MED”sh.p.k,** , Qendra e Biznesit EDIL-AL-IT, nr. 213 Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Detyrimi për të Njoftuar Zyrën e Komisionerit (nenet 21-26). U konstatua që kontrolluesi nuk kishte realizuar detyrimin për njoftim, prandaj nga grupi inspektimit u la një afat prej 2 ditësh që kontrolluesi të kryente këtë detyrim. Këtë detyrim kontrolluesi e plotësoi brenda afatit te caktuar;
18. Verifikimi i përmbushjes së detyrimit për njoftim pranë subjektit kontrollues **INC Management sh.p.k,** me qëllim verifikimin për plotësimin e detyrimit për njoftim, por nuk u arrit të lokalizohet qendra e aktivitetit të këtij kontrolluesi edhe pas informacionit te kërkuar nga Drejtoria e Tatim – Taksave për identifikimin e adresës të subjektit;
19. Verifikimi i përmbushjes së detyrimit për njoftim pranë subjektit kontrollues **ACCESS Credit Management” sh.p.k.** me qëllim verifikimin për plotësimin e detyrimit për njoftim, por nuk u arrit të lokalizohet vendodhja edhe pas informacionit te kërkuar nga Drejtoria e Tatim –Taksave për identifikimin e adresës të subjektit;
20. Eshtë realizuar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“ Baits “ Sh.p.k** në lidhje me realizimin ose jo nga ana e tij e “marketingut direkt”. Një kontroll ky i iniciuar me indicie të Drejtorisë së Regjistrimit pasi ky kontrollues kishte plotësuar Formularin e Njoftimit. U plotësua detyrimi për njoftim;
21. Po procedohet me inspektimin e kontrolluesit **“Vjosa Gas” SH.A** me qëllim verifikimin për plotësimin e detyrimit për njoftim, por nuk u arrit të lokalizohet vendodhja edhe pas informacionit te kërkuar nga Drejtoria e Tatim –Taksave për identifikimin e adresës të subjektit;
22. Inspektimin i kontrolluesit **“Vukaj Trans” SHPK** me qëllim verifikimin për plotësimin e detyrimit për njoftim, por nuk u arrit të lokalizohet vendodhja edhe pas informacionit te kërkuar nga Drejtoria e Tatim –Taksave për identifikimin e adresës të subjektit;
23. Mbi bazën e Urdhërit të Komisionerit filloi inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Union Bank”** me objekt verifikimi i zbatueshmërine së rekomandimit dhenë ndaj këtij kontrolluesi. Kontrolluesi ka përmbushur rekomandimin;
24. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Çelësi” sh.p.k** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kontrolluesi ka përmbushur rekomandimin;
25. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Çelësi Desing & Publicity” sh.p.k** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kontrolluesi ka përmbushur rekomandimin;
26. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Conad Shqipëria” sh.p.k** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga inspektimi u konstatua se ky kontrollues i ka plotësuar pikat e Rekomandimit;

27. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Credins Bank” sh.a** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky inspektim nuk ka përfunduar dhe do të vazhdohet me fazat e tjera të tij;
28. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Fibank”sh.a** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky inspektim ka përfunduar dhe u konstatua që kontrolluesi ka zbatuar Rekomandimin;
29. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **Banka “Emporiki”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kontrolluesi ka përmbushur rekomandimin;
30. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **Klinika “Intermedica”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri vendosi t’i drejtohet këtij kontrolluesi me një Urdhër për masa që duhen marrë brenda një afati të përcaktuar, pasi Rekomandimi ishte plotësuar pjesërisht;
31. Është përfunduar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **“Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës**. Është përfunduar relacioni, nga Kontrolli rezultoi se : Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës janë përmbushur pjesërisht kërkesat e Rekomandimit Nr. 16/2, datë 14/12/2010 të Komisionerit, se ka nevojë për marrje masash të mëtejshme nga ana e tij, për të përmbushur këto kërkesa, deri në hartimin përfundimtar të Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Këtij kontrolluesi ju drejtua me Urdhër për plotësimin e mangësive të konstatuara;
32. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Klinika Neo-Style”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky inspektim nuk ka përfunduar dhe do të vazhdohet me fazat e tjera të tij;
33. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Klinika Ursula”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky inspektim është ende në proces;
34. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Kompania Coca-Cola”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Verifikimi i masave të marra për zbatimin e Rekomandimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky inspektim është ende në proces;

● **Inspektimet për verifikimin e plotësimit të detyrimit për njoftim.**

Në këtë kuadër janë verifikuar **mbi 30 kontrollues publik dhe privat**. Për këtë lloj mbikëqyrje është ndjekur strategjia që nëse kontrolluesi brenda 48 orëve të fillimit të inspektimit plotëson këtë

detyrim ndaj tij nuk do të merret masa administrative gjorbë. Kjo praktikë ka funksionuar dhe në shumicën e rasteve subjekti ka njoftuar dhe vetëm **në 6 raste** është aplikuar masa gjorbë.

● Rastet Konkrete

1. Marrë shkak nga procedurat e njoftimit të përpunimeve pranë Komisionerit, u ndërmor inspektim administrativ pranë kontrolluesit **“Fondacioni për Zhvillim Humanizëm dhe Demokraci” Tiranë**. Grupi i inspektimit konkludoi se nuk mund të arrihen konkluzione konkrete lidhur me përpunimin e të dhënave sensitive nga kontrolluesi “Fondacioni për Zhvillim Humanizëm dhe Demokraci”, pasi akoma nuk kemi fillim të aktivitetit të këtij kontrolluesi ku të mblidhen dhe përpunohen të dhëna personale, duke përfshirë edhe ato sensitive. Për këtë u verifikuan ambientet ku zhvillon aktivitetin ky kontrollues si dhe baza e të dhënave që mbahej në rrugë elektronike. Këtij kontrolluesi ju la porosi të rinjoftonte sapo të fillonte aktivitetin dhe mbledhjen e të dhënave.
2. Me qëllim verifikimin e përpunimeve të njoftuara pranë Zyrës së Komisionerit, u ushtrua inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Agjencia e Sigurimit të Depozitave”**. Ky inspektim i panjoftuar kishte për qëllim të verifikonte gjendjen reale të përpunimit të të dhënave personale nga ky kontrollues, krahasuar me përpunimin e njoftuar nga vete kontrolluesi, si dhe sigurinë e të dhënave në praktikë. Në përfundim të inspektimit, grupi i kontrollit konstatoi disa mangësi në procesin e njoftimit të përpunimit nga ky kontrollues, si dhe disa problematika në sigurinë e të dhënave. **Pasi shqyrtoi dosjen e inspektimit, Komisioneri vendosi t’i japë Rekomandim këtij kontrolluesi.**
 - ~ Plotësimin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave për kategorinë “Anëtarë” (5 ditë);
 - ~ Pavarësisht disa klauzolave të akteve të brendshme, duhet të hartojë një rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave që përpunon dhe politikat e konfidencialitetit (30 ditë);
 - ~ Duhet të informojë subjektet të cilëve ju përpunohen imazhet me anën e kamerave CCTV, me anën e tabelave informuese që duhen vendosur në ambjentet e këtij kontrolluesi (menjëherë);
 - ~ Hartimin dhe nënshkrimin e një kontrate me kompaninë që menaxhon përpunimin me CCTV, ku të garantohet mbrojtja e të dhënave personale dhe siguria e tyre në veçanti (20 ditë).
3. Inspektimi pranë kontrolluesit **Tirana-Urban-Trans**. Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se ky kontrollues nuk e kanë përmbushur detyrimin për njoftim sipas ligjit edhe pse iu ishte dërguar paraprakisht një shkresë sensibilizuese nga Komisioneri, ku shpjegohej detyrimi ligjor dhe procedura për plotësimin e Formularit të Njoftimit dhe si pasojë **Komisioneri vendosi gjobitjen e tij;**
4. Inspektimi pranë kontrolluesit **“Mercator-A” sh.p.k** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I. Ky inspektim kishte për objekt plotësimin e detyrimit për njoftim dhe zbatimin e udhëzimit nr 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”. Në përfundim u konkluduar se ky kontrollues nuk ka shkelur ligjin.
5. Me qëllim verifikimin e përpunimeve të njoftuara pranë Autoritetit të Komisionerit, u ushtrua inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“TREAL” SH.A.** Në përfundim të inspektimit, grupi i kontrollit konstatoi se ky kontrollues nuk kishte përmbushur detyrimin ligjor mbi plotësimin e formularit të Njoftimit. **Pasi shqyrtoi dosjen e inspektimit, Komisioneri vendosi dënimin e këtij kontrolluesi me gjobë;**

6. Inspektimi pranë kontrolluesit **Universiteti “ Elite “**. Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se ky kontrollues nuk e kanë përmbushur detyrimin për njoftim sipas ligjit edhe pse iu ishte dërguar paraprakisht një shkresë sensibilizuese nga Komisioneri, ku shpjegohej detyrimi ligjor dhe procedura për plotësimin e Formularit të Njoftimit dhe si pasojë **Komisioneri vendosi gjobitjen e tij;**
7. Inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Hotel De Paris”**. Në përfundim të inspektimit, grupi i kontrollit konstatoi se ky kontrollues nuk kishte përmbushur detyrimin ligjor mbi plotësimin e formularit të Njoftimit. **Pasi shqyrtoi dosjen e inspektimit, Komisioneri vendosi dënimin e këtij kontrolluesi me gjobë;**
8. Është kryer mbi bazën e urdhërave kryesisht të Komisionerit, inspektimet administrative në fushën e arsimit, pranë kontrolluesve:
9. **Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Sami Frashëri”**
10. **Liceu artistik “Jordan Misja”,**
11. **Shkolla e mesme “Petro Nini” dhe**
12. **Shkolla e Mesme “Abdulla Keta”,** Tiranë. Për këtë kontrollues u vendos masa administrative gjobë, por më pas urdhëri u revokua, pasi me verifikimet e mëtejshme rezultoi se e kishte plotësuar detyrimin për njoftim.

Këta kontrollues plotësuan detyrimin për njoftim detyrimin për njoftim.

13. Inspektimi pranë kontrolluesit **“ Holiday Travel Agency”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I. Inspektimi pranë këtij kontrolluesi (Agjenci udhëtimi) kishte si objekt plotësimin e detyrimit për njoftim dhe masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale. U konstatua që deri me datën 17.04.2012 kontrolluesi nuk kishte realizuar detyrimin për njoftim ,prandaj nga grupi inspektimit u la një afat prej 2 ditësh që kontrolluesi të kryente këtë detyrim. Këtë detyrim kontrolluesi e plotësoi brenda afatit të caktuar. Nga inspektimi nuk janë gjetur shkelje të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
14. Inspektimi pranë kontrolluesit **“ Italia Travel & Tours”** Tiranë (agjenci udhëtimi). Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I. Ky inspektim lidhet me plotësimin e formularit të njoftimit dhe përhapjen e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave të kategorisë “udhëtarë”. U konstatua që deri me datën 23.04.2012 kontrolluesi nuk kishte realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit ,prandaj nga grupi inspektimit u la një afat prej 2 ditësh që kontrolluesi të kryente këtë detyrim. Këtë detyrim kontrolluesi e plotësoi brenda afatit të caktuar. Nuk u konstatuan shkelje lidhur me përhapjen e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave të kategorisë “udhëtarë”.
15. Inspektimi pranë kontrolluesit Agjenci udhëtimi **“Delta Tour”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I.

Ky inspektim lidhet me plotësimin e formularit të njoftimit dhe transferimin ndërkombëtar të dhënave personale për kategorinë “udhëtarë”. Ky inspektim nuk u realizua për faktin që ky kontrollues rezultoi në dy adresa, gjithashtu nuk u arrit të lokalizohet vendodhja edhe pas informacionit të kërkuar nga Drejtoria e Tatim –Taksave për identifikimin e adresës të subjektit;

16. Është kryer mbi bazën e urdhrit kryesisht të Komisionerit, inspektimi administrativ më datë 12/04/2012 pranë kontrolluesit **Shkolla 9-vjeçare publike “1 Maji”** Tiranë. Nga inspektimi rezultoi se ky kontrollues nuk ka realizuar plotësimin e detyrimit për njoftim, iu la afat kohor për plotësimin e detyrimit për njoftim dhe ky detyrim u plotësua brenda afatit nga ky kontrollues.
17. Inspektimi administrativ më datë 23/04/2012 pranë kontrolluesit **“Shërbimi Përmbarimor Zig”**, me objekt: Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21). Kushtet dhe kriteret ligjore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave (nenet 5, 6). Nga inspektimi rezultoi se ky kontrollues nuk ka realizuar plotësimin e detyrimit për njoftim, iu la afat kohor për plotësimin e detyrimit për njoftim deri datën 30/04/2012, i cili u respektua nga ky kontrolluesi i cili e realizoi njoftimin pranë Autoritetit të Komisionerit.
18. Inspektimi administrativ më datë 26/04/2012 pranë kontrolluesit **Shkolla private “Ëillson” në Tiranë** me objekt: Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21); Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale (neni 8). Nga inspektimi rezultoi se ky kontrollues ka plotësuar formularin e njoftimit në datën 19/04/2012 në rrugë elektronike. Nuk u konstatua transferim ndërkombëtar i të dhënave personale.
19. Me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit ligjor për njoftim (neni 21) në zbatim të urdhrave të Komisionerit është ushtruar pa paralajmërim inspektimi administrative pranë këtyre **kontrolluesit Sulaj Progres Grop sh.a.** Ky kontrollues nuk kishte plotësuar detyrimin për njoftim. Megjithatë pas sensibilizimit të grupit të inspektimit dhe vënies me dije të afatit prej 48 orësh për plotësimin e tij, ky kontrollues ka reaguar menjëherë për plotësimin e detyrimit për njoftim duke e plotësuar brenda ditës së firmosje së procesverbalit.
20. Inspektimi pranë kontrolluesit **“ Hotel Stela”** Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin dhe u planifikua nga Drejtoria e H-I. Inspektimi pranë këtij kontrolluesi kishte si objekt plotësimin e detyrimit për njoftim dhe masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale. U konstatua që kontrolluesi “Hotel Stela” ka realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit me datë 21.12.2011 dhe ne regjistrin e subjekteve kontrollues njoftimi i këtij kontrolluesi ka nr. 1870. Nga inspektimi nuk janë gjetur shkelje të nenit 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
21. Me qëllim verifikimin e njoftimeve pranë Zyrës së Komisionerit, u ushtrua inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Transoilgroup”, SH.A.** Ky inspektim i panjoftuar kishte për qëllim të verifikonte në vend, nëse kontrolluesi kishte njoftuar apo jo, pasi nga kontrolli i regjistrit fizik dhe atij elektronik, rezultonte, se ky kontrollues nuk kishte njoftuar. Gjatë komunikimit me përfaqësues të këtij kontrolluesi, ju bë e qartë se nëse ky detyrim përmbushej brenda 48 orëve, penaliteti nuk do të konkretizohej. Në po të njëjtën ditë, sipas sensibilizimit që ju bë kontrolluesit

nga grupi i punës, si dhe nga vullneti që kontrolluesi kishte, ky i fundit përmbushi detyrimin sipas nenit 21 të ligjit.

22. Me qëllim verifikimin e njoftimeve pranë Zyrës së Komisionerit, u ushtrua inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“Nycols Avio Balkans”, SH.A.**, Tiranë. Ky inspektim i panjohur kishte për qëllim të verifikonte në vend, nëse kontrolluesi kishte njoftuar apo jo, pasi nga kontrolli i regjistrimit fizik dhe atij elektronik, rezultonte, se ky kontrollues nuk kishte njoftuar. Në përfundim të inspektimit, grupi i kontrollit konstatoi se: Kontrolluesi **“Nycols Avio Balkans”, SH.A.**, në fjalë është çregjistruar, verifikuar kjo sipas QKR-së.

23. Me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit ligjor për njoftim (neni 21) në zbatim të urdhrave të Komisionerit është ushtruar pa paralajmërim inspektimi administrativ pranë këtyre kontrolluesit **Reinassance sh.pk**. Ky kontrollues kishte plotësuar detyrimin për njoftim, duke dërguar një shkresë ku sqaronte se përjashtohet nga detyrimi për njoftim, pasi përpunonte vetëm të dhënat e punonjësve. Grupi i inspektimit bëri verifikimet e nevojshme dhe konstatoi se ky kontrollues ende nuk kishte filluar aktivitetin e tij, dhe në dosjet e personelit nuk administrohej dëshmia e penalitetit, çfarë e përjashtonte nga detyrimi për njoftim.

24. Me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit ligjor për njoftim (neni 21) në zbatim të urdhrave të Komisionerit është ushtruar pa paralajmërim inspektimi administrativ pranë këtyre kontrolluesit **Urban Publicity sh.p.k**. Grupi i inspektimit doli në terren për të verifikuar dhe gjetur vendndodhjen e kontrolluesit sipas adresës së nxjerrë nga ekstrakti i QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit). Nga verifikimet e realizuara nga grupi i inspektimit rezultoi se Urban Publicity sh.p.k rezultoi në proces likuidimi.

25. U krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit klinike mjekësore private **“Hamdi Sulçebe”**, Rruga “Hoxha Tasim” Tiranë, me objekt *“Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21)”*. Nga inspektimi administrativ rezultoi se ky kontrollues nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Grupi i inspektimit mbajti procesverbalin e inspektimit administrativ dhe i la detyre kontrolluesit për një afat të caktuar të plotësojë këtë detyrim ligjor. Në përfundim kontrolluesi e ezauroi këtë detyrim.

26. Është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **Qendra argëtuese “Blur” Lundër Tiranë**, me objekt *“Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21)”*. Nga inspektimi administrativ në vend rezultoi se ky kontrollues nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kontrolluesi ishte në restaurim e sipër të ambienteve dhe një ristrukturim të aktivitetit të tij, për këtë shkak nuk u bë e mundur komunikimi me përfaqësuesin e kontrolluesit, por vetëm me një anëtar të stafit të tij. Në përfundim kontrolluesi e ezauroi këtë detyrim.

27. Inspektim administrativ pranë kontrolluesit **“ALPHA - MED” sh.p.k**, rruga e **“Elbasanit”**, Qendra e Biznesit EDIL-AL-IT, nr.213 Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Detyrimi për të Njoftuar Zyrën e Komisionerit (nenet 21-26). Ky inspektim vazhdon.

- 28.** Inspektim administrativ pranë kontrolluesit “**ALBAMEDIKAL**” sh.p.k, Komuna Vaqarr, fshati Prush Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Detyrimi për të Njoftuar Zyrën e Komisionerit (nenet 21-26). Nga ky inspektim u konstatuan që kontrolluesi “**ALBAMEDIKAL**” sh.p.k ka mbyllur aktivitetin e tij.
- 29.** Inspektim administrativ pranë kontrolluesit “**ALBGAS**”sh.a, me adresë bulevardi “Zogu i Parë” Tiranë. Ky inspektim administrativ u fillua pa njoftim paraprak për kontrolluesin me objekt: Detyrimi për të Njoftuar Zyrën e Komisionerit (nenet 21-26). Nga ky inspektim u konstatuan që kontrolluesi “**ALBGAS**”sh.a ka mbyllur aktivitetin e tij.

IV.III Masat Administrative, Gjobat.

Në zbatim të kompetencave të Komisionerit, pas mbylljes të procedurave të kontrollit dhe inspektimit administrative, janë vendosur 10 gjoba për kontrollues të ndryshëm ku kryesisht kanë qenë kontrollues që nuk kanë plotësuar detyrimin për njoftim (7) dhe pjesa tjetër nuk kanë janë gjetur në shkelje të përsëritur ose nuk kanë plotësuar rekomandimin e mëparshëm të komisionerit si dhe inspektimi ka qenë si pasojë e një ankese dhe kontrolluesi ka qenë në përsëritje dhe nuk mund të justifikohet më.

● Vendimi me gjobë u dha për këta kontrollues:

- 1. Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 1, Tiranë.** Dënuar me gjobë prej 20 000 (njëzetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim”;
- 2. Qendra Shëndetësore Nr. 1, Tiranë.** Dënuar me gjobë prej 15 000 (pesëmbëdhjetëmijë) Lek për “moshartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave; përgjigjet e analizave nuk futen në zarfe më qëllim sigurinë dhe konfidencialitetin, si dhe nuk janë përcaktuar afatet e ruajtjes së të dhënave”.
- 3. TREAL Sh.A.** Dënuar me gjobë prej 10 000 (dhjetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim”;
- 4. Tirana Urban Trans.** Dënuar me gjobë prej 20 000 (njëzetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim”;
- 5. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.** Dënuar me gjobë prej 60 000 (gjashtëdhjetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim; moshartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave; mosmarrja e pëlqimit nga pacientët si dhurues të gjakut; si dhe mosinformimi i subjekteve të të dhënave”.
- 6. Universiteti Elite.** Dënuar me gjobë prej 40 000 (dyzetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim”.
- 7. Univers-Alb Sh.A.** Dënuar me gjobë prej 25 000 (njëzetëepesëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim; moshartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave”;

8. **Shkolla e Mesme Qemal Stafa.** Dënuar me gjobë prej 30 000 (tridhjetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim; moshartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave, si dhe moshartimin e një kontrate me përpunuesin e të dhënave”; **Revokuar.**
9. **Shkolla e Mesme Abdulla Keta.** Dënuar me gjobë prej 20 000 (njëzetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim”; **Revokuar**
10. **XH & L CONSTRUCTION.** Dënuar me gjobë prej 30 000 (tridhjetëmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim”;
11. **Cez Shpërndarje Sh. A.** Dënuar me gjobë prej 400 000 (katërqindmijë) Lek për “mos përmbushje e detyrimit për njoftim; përpunim i paligjshëm i të dhënave, si dhe mos informimi dhe marrja e pëlqimit”;

● Lëshimi i Titujve Ekzekutiv nga Gjykata

- ~ Janë formuluar dhe dërguar kërkesat dhe autorizimet për përfaqësimin, në lidhje me lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për 22 kontrollues për të cilët Komisioneri me Vendim ka vendosur masën administrative “gjobë”. Gjithashtu, inspektorët e Zyrës së Komisionerit kanë marrë pjesë rregullisht në seancat gjyqësore me këtë objekt, sipas Fletë-Thirrjeve respektive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Lëshimi i këtyre urdhrave është në proces.
- ~ Janë formuluar dhe dërguar kërkesat dhe autorizimet për përfaqësimin, në lidhje me lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vendimet e gjobave të vendosura nga Komisioneri, të cilat nuk janë përmbushur vullnetarisht nga ana e kontrolluesve. Është marrë pjesë rregullisht në seancat përkatëse dhe Gjykata ka pranuar kërkesat për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit për kontrolluesit si më poshtë 6 (gjashtë) kontrollues:

- *Agjencia “Key Intenational”;*
- *Spitali Obstetrik “Nëna Geraldinë”*
- *Klinika Obstetrike dhe Okulistike “Gjergji Cepa”;*
- *Explorer Travel & Tours Bengasi sh.p.k;*
- *Klinika “Amavita “*
- *Royal & Diagnostic Center*

● Konkluzione

Për ta përmbledhur mund të themi se veprimtaria mbikëqyrëse e Komisionerit ka konsistuar në rreth **100 veprime dhe aktivitete ligjore të mbikëqyrjes** dhe vëmendje e veçantë i është kushtuar trajtimit të ankesave që ka ardhur në rritje. Kjo veprimtari është shtrirë në disa rrethe të vendit si Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Kukës, Sarandë, Gjirokastrë etj.

Me rëndësi është se tashmë subjektet e të dhënave janë ndërgjegjësuar dhe kanë filluar të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre dhe mënyrën sesi duhet të ndjekin procedurat dhe të ankohen pranë Zyrës së Komisionerit.

Përsa i përket kontrolleve dhe inspektimeve **vërehet një rritje, më shumë se dyfishin, për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011**, pra më shumë rekomandime në drejtim të kontrolluesve, si dhe një rritje e lehtë e formave urdhëruese nga Komisioneri, si dhe masat e gjobës nuk kanë synuar vetëm mospërmbushjen e detyrimit për njoftim por edhe shkelje të rënda dhe të përsëritura. Për

shkeljet e tjera Komisioneri ka vazhduar edhe për vitin 2012 të ndjekë të njëjtën strategji dhe politikë, pra të mos gjobitjes së menjëhershme, por dhënien e rekomandimeve për tu zbatuar nga kontrolluesit publik ose privat dhe si pasojë numri i gjobave është më i ulët ashtu sikurse e theksuam në fillim por ka influencuar në një numër më të madh kontrolluesish për çështje thelbësore, ka unifikuar masat për disa fusha të rëndësishme, si dhe nëpërmjet inspektimeve iniciuar nga ankesat i ka shuar ato me autoritetin e vet.

KAPITULLI V

PROJEKTI EU IPA-2009, KONTRIBUTI GJATË VITIT 2012.

Edhe gjatë vitit 2012 KMPD bashkëpunoi me ekspertët e huaj për realizimin e Planit të Punës të Projektit IPA 2009 “Përforcimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për harmonizimin me Standardet e Bashkimit Evropian” projekt ky në kuadrin e asistencës teknike dhe i financuar nga Komisioni i BE. Vlen për tu përmendur bashkëpunimi me ekspertët ndërkombëtar të cilët ishin nga më të njohurit në fushën e mbrojtjes së të dhënave (20 ekspertë nga 10 Shtete Anëtare) për të gjithë komponentët e tij por ne veçanti ai për zhvillimin e kuadrit ligjor i cili u kururëzua me amendimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Po ashtu bashkëpunimi për komponentin e proceseve operuese hetim-inspektim dhe ai lidhur me ndërgjegjësimin që mjaft rezultativ dhe i dobishëm. Një vlerësim maksimal për implementimin e tij dha dhe misioni monitorues **Results Oriented Monitoring** për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë i kryer nga data 15 deri 19 tetor 2012. Ky projekt zgjati 25 muaj dhe u mbyll në 6 dhjetor 2012 me një aktivitet të organizuar në Hotel Tirana International ku përshëndetën Znj. Flora Çabej-Kimisionere për MDP, Luigi Brusa Shef i Operimeve në Delegacionin BE në Tiranë, znj. Silvia Prada Drejtore e Projektit pranë konsulentit FIIAPP si dhe znj. Dorota Skolimowska Udhëheqëse e Ekipit të asistencës.

KAPITULLI VI

VEPRIMTARI TË TJERA TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

VI.I Menaxhim i burimeve njerëzore, performanca financiare, etj.

● Struktura organizative

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale realizon aktivitetin e tij nëpërmjet veprimtarisë së 29 punonjësve nga të cilët 17 janë staf teknik me drejtim juridik, e pjesa tjetër me profesione të ndryshme , kryesisht ekonomik dhe IT.

Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale nuk ka patur ndryshime gjatë vitit 2012 dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit Nr.225 datë, 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pagave të pozicioneve të punës së

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, përveç një rasti të parashikuar në ligjin dhe vendimet përkatëse “Për rregullimin e Shërbimit të Transportit të Funkionarëve politikë”, suprimimin e pozicionit të shoferit.

Struktura aktuale organizative për periudhën e raportuar, ka mundësuar ruajtjen e një shkalle hierarkike të përshtatshme për punonjësit dhe mbulimin e funksioneve të KMDP-së.

~ Menaxhimi i burimeve njerëzore

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është struktura mbështetëse e funksionimit të KMDP-së në realizimin e misionit të tij: **“Garantimi dhe mbrojtja e të dhënave Personale”**.

Kjo drejtori menaxhon dhe realizon :

Ofrimin e shërbimeve cilësore, efektive, transparente me anë të një administrate funksionale, të paanshme, të aftë dhe përgjegjëse për t’iu përgjigjur sfidave dhe rreziqeve ndaj shkeljeve abuzive të privatësisë, dhënien e një garancie të plotë në mbrojtje të të dhënave personale të shtetasve.

Drejtimi i burimeve njerëzore në KMDP realizohet në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të tij. Në planin afatshkurtër vëmendja e burimeve njerëzore u përqëndrua në;

- 1) Rekrutimin e punonjësve gjithnjë e më cilësor;
- 2) Trajnimin e mëtejshëm e sa më të plotë të punonjësve;
- 3) Nxitjen dhe motivimin e tyre.

~ Rekrutimi

Jemi angazhuar dhe kemi ndjekur në vijimësi procedurat e rekrutimit të punonjësve për vendet vakante të evidentuara, në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, neni 10 “Për institucione të pavarura”, në të gjitha etapat e parashikuara nga ligji.

Gjatë vitit 2012, në zbatim të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.2003 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, Kodit të Punës, për stafin civil si dhe punonjësit mbështetës janë ndjekur procedurat e lëvizjes; lirime nga detyra si dhe emërimet të përhershme e të përkohshme në detyrë kundrejt kontratave të lidhura me personat e emëruar. Rastet dhe arsyet janë të ndryshme të cilat kanë patur arsyen e mbushjes së moshës për përfitim të pensionit të pleqërisë dhe plotësimit të vendit e pozicionit vakant, si dhe emërimet e përkohshme në periudha nga 3-6 muaj, si pasojë e paaftësisë së përkohshme në punë.

~ Zhvillimi i burimeve njerëzore

Në kuadër të zhvillimit dhe ngritjes së aftësive profesionale të kapaciteteve njerëzore e në vijim të strategjisë së trajnimeve për vitin 2011-2012, është miratuar plani i trajnimeve për vitin 2012.

Në zbatim të strategjisë “Për trajnimin e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën 2011-2012”, miratimit të planit të trajnimeve për vitin 2012, referuar

moduleve dhe përcaktimit të personave pjesëmarrës, janë ndjekur me përpikmëri dhe çertifikuar nga Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike (ITAP), të gjithë punonjësit që kanë ndjekur kurset e organizuara për periudhën Janar –Dhjetor 2012, sipas planit të trajnimeve mujore të dërguara nga ITAP. Mund të themi se nga rakordimet me ITAP numri i punonjësve të trajnuar është rreth 20, në 20 programe, me 140 ditë trajnimi, kundrejt 3 punonjësve në vitin 2011.

Stafi i KMDP-së ka marrë pjesë dhe në trajnime e takime të tjera të organizuara nga institucione të tjera shtetërore si AKSHI-, lidhur me trajnimin e stafit të teknologjisë së informacionit apo dhe KSHC, lidhur me trajnimin e përfaqësuesve të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Në vijim të këtij prioriteti theksojmë bashkëpunimin e frytshëm me Projektin EU - IPA 2009. Në kuadër të tij, një nga komponentët ka qenë dhe trajnimi i stafit, marrja e eksperiencës nga vendet e BE dhe implementimi i tyre në institucionin tonë. Pjesa më e madhe e stafit ka ndjekur trajnimet sipas specifikave të ekspertëve të huaj të fushaës së mbrojtjes së të dhënave personale, ashtu edhe trajnime me tema të përgjithshme për ngritjen e aftësive prezantuese, të punuarit në grup, të cilat janë organizuar në ambjentet e KMDP-së. Përveç këtyre janë organizuar edhe vizita studimore në vendet e BE-së, sërish me mbështetjen dhe asistencën e projektit apo dhe organizmave të tjerë të huaj si TAIEEX, etj.

Pjesëmarrja e punonjësve të KMDP-së ka qenë interaktive me prezantime rastesh të vendim-marrjes së Komisionerit si dhe me diskutime e prezantime rreth çështjeve kryesore që përballen Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave personale.

Në kuadër të bashkëpunimit me ITAP, është mundësuar pjesëmarrja e KMDP-së në rolin e trajnuesve, thuajse çdo muaj, për trajtimin e temave dhe kurikulave të ndryshme, në varësi të target grupeve pjesëmarrëse.

~ Motivimi i punonjësve

Në mbështetje të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” si dhe në respektim të shkresave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave, në lidhje me akordimin dhe përdorimin e këtij fondi, për vitin 2012, janë ndjekur procedurat për miratimin dhe përdorimin e tij, me destinacion shpërblime financiare të punonjësve, sipas rasteve të ndodhura.

Janë respektuar dhe zbatuar VKM në fushën e legjislacionit për sigurimet shoqërore e shëndetësore si dhe në fushën e sistemit të pagave, lidhur me aplikimet e shtesave mbi pagë për stafin e punonjësve civil dhe atyre mbështetës.

Ndikim në rritjen e efektivitetit në punë ka dhënë edhe procesi i vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese për ta.

~ Bashkëpunime të tjera

Gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2012 rëndësi e posaçme i është kushtuar shmangies së konfliktit të interesave nëpërmjet mbajtjes së kontakteve të rregullta me ILDKP, për përditësimin e regjistrit të nëpunësve që mbartin detyrimin për deklaram të interesave private e burimin e krijimit të tyre me lëvizjet e ndryshimet e ndodhura.

Në vijim të strategjisë mbi burimet njerëzore, vlen të përmendet bashkëpunimi eficient dhe kontakti i vazhdueshëm me institucionet e trajnimeve për hartimin e programeve të trajnimit mbi bazën e kërkesave të stafit pjesëmarrës.

KMDP ka patur në qendër të vëmendjes ndjekjen dhe plotësimin e dokumentacionit për certifikimin e punonjësve me certifikata të sigurisë nga DSIK, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Ligjin nr.8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar.

● Performanca financiare

KMDP në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligjet organike mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij. Gjithashtu, ka krijuar dhe monitoruar një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në legjislacionin në fuqi konformë dispozitave të Ligjit Nr.10296, datë 8/07/2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin”, si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasitet.

~ Planifikim

Gjatë vitit 2012 janë kryer veprime dhe hapa drejt një menaxhimi efikas financiar e konkretisht:

- ~ Detajimi i shpenzimeve buxhetore korente dhe kapitale për vitin 2012 mbi bazën e fondeve të alokuara nga Ministria e Financave në artikujt për paga, sigurime shoqërore, shpenzime për mallra e shërbime, transferime në buxhete familjare si dhe investime, sipas projekteve të miratuara në nivel mujor e vjetor.
- ~ Rishikimi i planeve të detajuara në muaj për shpenzimet operative dhe investime për vitin 2012 si dhe rishpërndarja e tyre në muajt pasardhës në zbatim të udhëzimit të përhershëm Nr.2, datë 06/02/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe duke respektuar përqindjet e vendosura nga Ministria e Financave.
- ~ Përgatitja, rakordimi i llogarive vjetore si dhe plotësimi i pasqyrave financiare me anekset përkatëse mbi gjendjen e aseteve fikse e qarkulluese dhe gjendjen financiare në fund të vitit 2011, në zbatim të ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, brenda afateve kohore të përcaktuara në to.
- ~ Planifikimi, përgatitja dhe dërgimi pranë Ministrisë së Financave të kërkesave buxhetore të detajuara, të Projekt-Buxhetit afat-mesëm 2013-2015, për programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 29/02/2012 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015”, si dhe të udhëzimit nr.8, datë 29/03/2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmese”, me anekset e tyre përkatëse, gjatë të dy fazave, Prill dhe Gusht 2012.
- ~ Përfaqësimi pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, lidhur me vërejtjet mbi planifikimin e Buxhetit të Vitit 2013 për institucionin, të përgatitur nga Ministria e Financave. U parashtruan rezervat lidhur me këtë buxhet, kërkesat shtesë për plotësimin e zhvillimin e aktivitetit ekonomiko-financiar.

- ~ Është zbatuar akti Normativ nr. 6, datë 12/12/2012 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, detajimi i planit të ndryshuar sipas klasifikimit buxhetor deri në nivel artikulli.
- ~ Janë planifikuar dhe realizuar transferimet e fondeve në zërat e kërkuara për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë për transferime në buxhetet familjare për organizime të aktiviteteve social- kulturore si dhe ndjekja dhe realizimi i tyre
- ~Hartimi dhe dërgimi i raportit Vjetor për vlerësimin e sistemit ekzistues, menaxhimit financiar si dhe cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm, plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 8/07/2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- ~ Përcaktimi i personave përgjegjës të cilët kanë përgjegjësinë mbi menaxhimin me efikasë, ekonomi dhe efektivitet të burimeve financiare dhe jofinanciare në mbështetje të arritjes së objektivave, politikës dhe qëllimeve të institucionit në zbatim të ligjit të mësipërm.
- ~ Ndjekja dhe zbatimi i urdhërave dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave lidhur me hartimin e gjurmëve të auditimit të proceduarve të prokurimeve me vlera të mëdha e të vogla, si dhe të gjurmëve të auditimit të menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.
- ~ Është ngritur struktura dhe miratuar procedura lidhur me përgjegjësitë mbi menaxhimin e aktiveve dhe administrimin e tyre.
- ~ KMDP referuar buxhetit për vitin 2012, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara, përlllogaritjen e shpenzimeve të konsumit të tonerave për printera dhe fotokopje, përlllogaritja e shpenzimeve operative për shërbimet: internet, telefoni, mirëmbajtja e pajisjeve elektronike, menaxhimi i fondit të pajisjeve për autoritetin e komisionerit, për sigurimin e standardeve në lidhje me to.
- ~ Sipas udhëzimeve për hartimin e PBA 2013-2015, hapave dhe procedurave të miratuara në to janë planifikuar nevojat për mbështetje financiare, në funksion të përmbushjes së misionit të KMDP, për realizimin e objektivave afatshkurtra e afatmesme, mbi baza produktesh.

~ Zbatimi i Buxhetit

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të institucionit nëpërmjet strukturave drejtuese, deri në vendimmarrje, në zbatim të ligjit 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, udhëzimeve përkatëse për zbatimin e tij, janë miratuar procedura, veprime të cilat synojnë reduktimin e risqeve me synimin për të arritur objektivat e institucionit si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të titullarit. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, ato janë ingranuar tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen.

Institucioni ynë, konstaton se ka përmbushur kërkesat ligjore minimale dhe ka vënë në zbatim kontrole të përshtatshme në fushat: ekzistencën e rregullave/urdhërave të brendshme për përshkrimin e proceseve kryesore operationale dhe financiare, sistemin e firmës së dyfishtë; ruajtjen e aktivëve dhe ndarjen e detyrave; dokumentimin e të gjitha operationeve, veprimeve dhe transaksioneve financiare si dhe procedura të tjera të miratuara në aktivitetin kryesor deri në vendimmarrje.

Janë ndjekur procedurat e prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, udhëzimit nr.2 “Për procedurën e blerjeve të vogla” si dhe

procedurat me tenderim mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Financave, nga strukturat e ngritura me urdhër për zbatimin e procedurave standarde të miratuara.

Realizimi i kontrollit të vazhdueshëm të dokumentacionit, bazuar në kontrollet para e pas faktit, për rregullshmërinë ligjore dhe dokumentacion justifikues, dhënia e garancive dhe cilësisë së shërbimeve, përmes përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet e ekonomi, garantimin që të gjithë kreditoëet të paguhën në kohë, referuar afateve të përcaktuara në marrëdhëniet kontraktuale.

Pas dërgimit pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, i ndryshuar, sipas formatit të caktuar, në mbështetje të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, Ligjit nr.10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, Udhëzimit nr.2/1, datë 15.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012”, është monitoruar vazhdimisht nga strukturat përkatëse realizimi i tij në çdo zë, duke marrë masat e nevojshme edhe për ndryshime gjatë vitit, në reflektim të kërkesave dhe mundësive të përmbushjes së objektivave të çdo drejtorie duke garantuar përdorimin me efektivitet dhe ekonomi të fondeve publike.

Në mbështetje të udhëzimit Nr.2/1, datë 15.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012”, për sigurimin e një analize të plotë të zbatimit të buxhetit, janë plotësuar kërkesat e organeve monitoruese, lidhur me procedurat e regjistrimit të shpenzimeve të fondeve publike si dhe janë depozituar brenda afateve kohore, informacionet e kërkuara lidhur me shpenzimet e përgjithshme të personelit të punësuar (situacion mujor) .

Në përmbushje të objektivave të KMDP-së për periudhën e raportuar, është miratuar fondi i përgjithshëm, referuar Ligjit nr.10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, i ndryshuar, sipas tabelës dhe zërave të shpenzimeve si dhe paraqitja e realizimit, referuar planeve vjetore.

● Transferimet, ndryshimet e realizimet.

000 / lekë					
Nr	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 mujorë	% realizimi kundrejt planit 6-mujorë
1	Paga	26.831	61	26799	99.8 %
2	Sigurime shoqërore	4.064	9	4058	99.8%
3	Mallra e shërbime të tjera	9.310	21	9097	97.7%
4	Investime	3.000	7	1.972	65.7 %
5	Transferta të buxhetit familjarë.	458	1	458	100 %
6	Kuotizacion	86	0.1	84	97.6%
	Totali	43.750	100	42468	97 %

● PAGA DHE SIGURIME SHOQËRORE

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit për paga dhe sigurime shoqërore, ishte 32685 në mijë lekë. Ky fond përputhej me kërkesën e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e institucionit, sipas strukturës organike të tyre. Si rezultat i mosplotësisimit në kohë të strukturës gjatë vitit, pas ndjekjes së procedurave të rekrutimit, dështimit të tyre, për vlerësim nën nivelin e përshtatshëm të pranimi në shërbimin civil (vlerësim nën 50 pikë) dhe mos shpalljes të asnjë fituesi për vijimin e emërimit nga eprori direkt, pezullimit të rekrutimeve në zbatim të VKM datë 07.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të fondve buxhetore” fondi i pagave në muajin dhjetor është shkurtuar me 1790 (në mijë) (paga e sigurime shoqërore). Realizimi, siç shihet dhe nga tabela e mësipërme , është në masën 99.8 % , pas ndryshimeve në buxhet.

~ Shpenzime Operative

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (602) për vitin 2012, është planifikuar në vlerën 9.322 lekë, me ndryshimet e rialokimeve si dhe ndryshimet e rishikimit të buxheti. Ky fond është ulur në masën 9.310.000 lekë. Për periudhën 12 mujore në total është realizuar në masën 9.096.715 ose 98 % e fondit të planifikuar dhe likujduar .

~ Shpenzime të tjera

Fondi për shpenzime të tjera (kuotizacione+transferime në buxhete familjare (605-606), për vitin 2012, është planifikuar në vlerën 450.000 lekë . Me ndryshimet e rialokimeve si dhe ndryshimet e rishikimit të buxhetit, ky fond është në masën 545.815 lekë. Për periudhën 12 mujore në total është realizuar në masën 543.315 ose 99.5 % e fondit të planifikuar dhe likujduar .

~ Investimet

Shpenzimet për investime janë orientuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike me synim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale por dhe në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës së punonjësve .

Në zbatimin me rigorozitet të Ligjit Nr. 9643 “Për prokurimin Publik” si dhe në zbatim të VKM Nr.1 “Për rregullat e prokurimit publik”, për plotësimin e nevojave të autoritetit të komisionerit janë planifikuar tre projekte:

- ~ “Blerje pajisje kompjuterike-server”;
- ~ “Blerje pajisje të ndryshme zyre”;
- ~ “Konceptimi dhe ndërtimi i “Sistemit Informatik të aplikimit online dhe regjistrimit të kontrolluesve të të dhënave personale dhe procedurat e hetim-inspektimit.

Realizmi i fondit për investime (zëri 231) për periudhën e raportuar është realizuar në masën 65.7 % të planit vjetor. Gjithsej fondi i planifikuar (i ndarë me projekte) për vitin 2012 është 3.000 mijë lekë dhe realizmi për këtë vit është 1.979 mijë lekë.

Diferenca e pa realizuar në dukje, përbën kursimet në buxhetin e shtetit, si rrjedhojë e zbatimit me rigorozitet të procedurave të prokurimeve. Më konkretisht, realizimi për çdo projekt paraqitet si vijon:

- ~ Alokimi i fondit publik të Ministrisë së Financave për projektin e investimit “**Blerje pajisje të ndryshme zyre**” në vlerën 520 (në mijë lekë) është realizuar në masën 517 në mijë lekë ose 99.4% kundrejt planit .
- ~ Alokimi i fondit publik të Ministrisë së Financave për projektin e investimit “**Blerje pajisje kompjuterike –server**” në vlerën 480(në mijë lekë) është realizuar në masën 474 (në mijë lekë) ose 98.4. % kundrejt planit .
- ~ Alokimi i fondit publik të Ministrisë së Financave për projektin e investimit “*“Konceptimi dhe ndërtimi i “Sistemit Informatik të aplikimit online dhe regjistrimit të kontrolluesve të të dhënave personale dhe procedurat e hetim-inspektimit”*” në vlerën 2.000 (në mijë lekë) është realizuar në vlerën 979 (mijë lekë) ose 65.7 % e fondit të planifikuar . Pjesa e mbetur kthehet në buxhet, gjë e cila ndikon, në pamje të parë në % e realizimit të investimeve .
- ~ **Monitorimi**

Një nga komponentët e menaxhimit financiar është dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit vjetor nga organet monitoruese, referuar legjislacionit financiar.

- Në këtë kuadër, vlerësojmë paraqitjen në Ministrinë e Financave(Drejtoritë përkatëse), brenda afateve të raporteve:
- ~ Të Realizimit të investimeve për KMDP;
- ~ Të Realizimit të fondeve buxhetore korrente, për KMDP
- ~ Të monitorimit të shpenzimeve publike, me struktura të veçanta, në lekë e produkte, çdo tre mujor, sipas formateve të miratuara dhe të shoqëruara me relacionet përkatëse mbi performancën e cdo produkti dhe objektivi të realizuar.
- Në kuadër të transparencës së përdorimit të fondeve publike si dhe të detyrimit ligjor të publikimit në faqen e Webit www.kmdp.al, në postin Raportime, publikimin e raporteve të monitorimit të shpenzimeve publike, me struktura të veçanta, në lekë e produkte, çdo tre mujor, sipas formateve të miratuara dhe të shoqëruara me relacionet përkatëse.
- Hartimin dhe dërgimin e Raportit të hollësishëm 12- mujor pranë Agjensisë së Prokurimit Publik, mbi prokurimet publike e procedurat e ndjekura nga KMDP, në zbatim të Ligjit nr. 9643 “Për prokurimet publike” dhe të dispozitave ligjore financiare në fuqi të Prokurimeve Publike çdo 4-mujor si dhe vjetor 2012.
- Përgatitjen dhe dërgimin e raportit periodik për organin monitorues, Kuvendin, mbi veprimtarinë e DSHM.

● Buxheti në vite

Viti	Plan Vjetor	Buxheti i rishikuar	Fakt vjetor	% realizuar
2009	51.000	51.000	30.963	61%
2010	51.000	48.140	43.384	90%
2011	45.900	44.100	41.972	95 %
2012	45.260	43.750	42.468	97. %

~ Të ardhurat e institucionit

Për vitin 2012, të ardhurat nga veprimtaria e KMDP-së janë kryesisht nga :

- Gjobat e vendosura në rastet e shkeljeve të zbatimit të detyrimeve ligjore, nga kontrolluesit, në shumën 55.000 lekë e konkretisht;
 - ✓ Gjoba e vendosur dhe e ekzekutuar vullnetarisht, për kontrolluesin “Spitali Amerikan” në shumën 25.000 lekë.
 - ✓ Gjoba e vendosur dhe e ekzekutuar vullnetarisht, për kontrolluesin “TREAL sh.a”, në shumën 10.000 lekë.
 - ✓ Gjoba e vendosur dhe e ekzekutuar vullnetarisht, për kontrolluesin “Tirana urban trans”, në shumën 20.000 lekë.
- Të ardhura nga kreditorë të tjerë(detyrime për institucionin) e konkretisht:
 - ✓ Kthim tollona karburanti nga kompania “Skënderi G” në shumën 250.200 lekë.

Gjithsej shuma e të ardhurave të lartpërmendura arrin në vlerën 305.200 lekë, të cilat në mbështetje të dispozitave në fuqi janë derdhur 100 % në buxhetin e shtetit.

VI.II Sektori i Teknologjisë së Informacionit.

Gjatë vitit 2012 Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit është angazhuar në veprimtari të ndryshme në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së pajisjeve, sistemeve dhe komunikimeve elektronike, përditësimin e punonjësve të institucionit me zhvillimet e reja dhe rreziqet e shfaqura në fushën e teknologjisë së informacionit, po ashtu specialistët e teknologjisë së informacionit kanë marrë pjesë në trajnime, inspektime etj.

~ Menaxhimi i sistemeve “hardëare” dhe “software”

Gjatë vitit kalendarik 2012, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit bazuar edhe në parashikimin e programit vjetor për të njëjtin vit, ka realizuar administrimin e pajisjeve dhe sistemeve të

komunikimeve elektronike. Janë realizuar kontrole periodike të pajisjeve fizike si kompjuter, printer, server, UPS etj. Janë realizuar përditësimet e sistemeve “Softëare” si Microsoft Eëindoës, antivirus etj. Janë realizuar “ruajtje të dhënash” (backup) për sistemet dhe të dhënat të cilat ndodhen në to.

~ Aplikacioni i ri i Drejtorisë së Regjistrimit

Është marrë në dorëzim sistemi i njoftimit të kontrolluesve. Ky sistem ofron me tepër siguri në lidhje me integritetin e njoftuesve pasi aplikuesit i duhet të kalojë disa faza për t’u identifikuar. Ky aplikacion mundëson nxjerrjen e raporteve të ndryshme në lidhje me statistikën që mund të nevojiten për çështje studimore etj. Sistemi është i vendosur në ambientin fizik të Komisionerit dhe lidhet me portalin e Institucionit për të marrë aplikimet e njoftimeve të subjekteve kontrollues si dhe mundëson publikimin e regjistrimit të hapur për publikun.

~ Serveri i ri.

Është marrë në dorëzim dhe vënë në funksionim një server i cili do të shërbejë si server rezervë në rast dëmtimi të serverit në të cilin janë të vendosur mailserver, sistemi i njoftimit, sistemi i protokollit elektronik dhe sistemi i menaxhimit të dokumentacionit.

~ Menaxhimi i portalit zyrtar (www.kmdp.al) të Institucionit.

Në portalin zyrtar të Institucionit janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e organizuara nga autoriteti i Komisionerit si konferenca të ndryshme, nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, seminare të organizuara për kontrollues të të dhënave personale si publikë ashtu edhe privat, publikimin e informacioneve të reja, aktivitete sensibilizuese për subjektet e të dhënave personale, pasqyrimin e udhëzimeve të Komisionerit për kontrolluesit e të dhënave personale, legjislacionit ndërkombëtar etj.

~ Pjesëmarrja në Inspektime.

Specialistët e teknologjisë dhe informacionit kanë qenë pjesë e grupeve të punës gjatë inspektimeve të organizuara nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit në kontrolluesit publik dhe privat të të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë. Për çdo inspektim janë dhënë rekomandimet përkatëse në lidhje me përdorimin e pajisjeve të teknologjive të informacionit, masat e sigurisë për aksesin në të dhënat personale, hartimin e rregulloreve dhe politikave të sigurisë etj.

~ Pjesëmarrja në trajnime/seminare në kuadër të ndërgjegjësimit

Është marrë pjesë në seminare dhe aktivitetet e tjera ndërgjegjësuëse të realizuara në funksion të kontrolluesve, përpunuesve dhe subjekteve të të dhënave personale. Janë bërë referime në lidhje me teknologjitë e informacionit me të cilat subjektet e të dhënave personale apo kontrolluesit e të dhënave personale përballen në jetë dhe punën e përditshme. Temat në lidhje me përdorimin e teknologjive të informacionit kanë qenë objekt diskutimesh sidomos tek të rinjtë, si shtresa e shoqërisë më tepër e lidhur me përdorimin e këtyre teknologjive.

~ Bashkëpunime

Është marrë pjesë në grupet e punës të ngritura brenda institucionit për hartimin e udhëzimeve të ndryshme sipas sektorëve specifikë si: udhëzimet për kontrolluesit e vegjël, për kontrolluesit e mëdhenj etj.

VI.III Pjesëmarrja në trajnimet e ITAP.

KMDP në bashkëpunim të ngushtë me ITAP kanë arritur rezultate pozitive në vitin 2012 në drejtim të trajnimit të administratës publike në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Falë punës së mirë dhe të përbashkët është mundësuar trajnimi i disa punonjësve të sektorëve të ndryshëm përmes trajnerëve të KMDP-së.

Temat e përçuara kanë qenë të rëndësishme dhe janë pasuar me diskutime e vlerësime të shumta. Interesimi i të pranishmëve ka qenë maksimal dhe ka obliguar tashmë një pjesë të përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrëse në trajnime në drejtim të zhvillimit të punës së tyre në kushte më të qëndrueshme sa i përket përdorimit të legjislacionit në këtë fushë.

Temat e referuara dhe materiale ndërgjegjësuere të ofruara nga KMDP kanë shtuar kërkesën për zhvillimin e trajnimeve në të ardhmen.

Pas çdo trajnimi për punonjësit e administratës publike, pjesëmarrës janë lëshuar Certifikata nga ITAP, për temën e mbrojtjes së të dhënave personale.


KAPITULLI VI

PËRMBAJTJA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE SKICAVE


Paraqitja tabelore për Hetim – Inspektimin. Krahvim 2011-2012

Viti	Ankesat me shkrim	Kontrollet dhe Inspektimet Administrative	Masat Administrative, Gjobat	Rekomandime	Urdhëra
2011	17	37	27	23	-
2012	22	94	11	42	13


- Ankesa, Inspektime dhe Gjoba, krahasim i vitit 2011 dhe 2012.



- Inspektive dhe Gjoha në sektorët publikë dhe privatë për vitin 2012.




- Rastet në lidhje me përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale në 2012 (të dala gjatë inspektiveve) - një krahasim ndërmjet publikut dhe sektorit privat.




**KUADRI
LIGJOR 2012**







- Të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e njoftim/regjistrimit .

	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
Njoftime	37	1199	1038	1364
Regjistrime	30	1012	871	1477
Sensibilizime	290	5867	5586	3511





Tabele krahasuese




Tabela: Plan-Buxhet-Realizim në vite





Tabela e realizimit të buxhetit në vite, shprehur në përqindje (%)



Struktura e llogarive ekonomike në përqindje kundrejt buxhetit total




Tabela e realizimit të buxhetit për vitin 2012

